



SIGURIA, BASHKËPUNIMI RAJONAL DHE REFORMAT

-Kosova dhe Maqedonia-



SIGURIA, BASHKËPUNIMI RAJONAL DHE REFORMAT

- Kosova dhe Maqedonia -

IMPRESSUM

Titulli:

Siguria, bashkëpunimi rajonal dhe reformat
-Kosova dhe Maqedonia-
Forum i sigurisë Kosovë-Maqedoni 2018

Botuesit:

Fondacioni Konrad Adenauer në Republikën e Kosovës
Fakulteti i Sigurisë –Shkup, Universiteti “Sh. Klimenti i Ohrit” - Manastir,
Republika e Maqedonisë
Universiteti AAB –Prishtinë, Republika e Kosovës

Për botuesit:

Johanes D. Rey, Shef i Fondacionit Konrad Adenauer në Republikën e Kosovës
dhe Republikën e Maqedonisë
Prof. Dr. Nikolla Dujovski, Dekan i Fakultetit të Sigurisë - Shkup, , Republika e
Maqedonisë
Prof. Dr. Lulzim Tafa, Rektor i Universitetit AAB - Prishtinë, Republika e Kosovës

Kryeredaktor dhe redaktor përgjegjës:

Dr. Marjan Gjurovski, Prodekan për shkencë dhe zhvillim i Fakulteti të Sigurisë –
Shkup, në Universitetin „Sh. Klimenti” i Ohrit, Republika e Maqedonisë

Përkthim:

Ismet Bitik

Dizajn dhe shtypje:

Vinsent Grafika ShPK Shkup

Tirazhi: 100 ekzemplarë

Libri mund të shkarkohet falas në:

<http://www.kas.de/mazedonien/en/>
<https://www.kas.de/kosovo>

Me vendimin nr.08-893 / të datës 25.10.2018 të Këshillit Mësimor-Profesional të Fakultetit të Sigurisë-Shkup Universitetit “Shën Klimenti” i Ohrit - Manastir, u miratua projekti “Forcimi i sigurisë nëpërmjet bashkëpunimit mes Kosovës dhe Maqedonisë” dhe mbajtja e Forumit Kosovë-Maqedonas të Sigurisë 2018. Të gjitha të drejtat janë të mbrojtura.

Shënim:

Pikëpamjet e shprehura në këtë punim nuk janë pikëpamjet e Fondacionit Konrad Adenauer, por janë pikëpamjet personale të autorëve.

FONDACIONI "KONRAD ADENAUER", PRISHTINË, REPUBLIKA E KOSOVËS
FAKULTETI I SIGURISË – SHKUP, UNIVERSITETI "SH. KLIMENTI" I OHRIT,
REPUBLIKA E MAQEDONISË
UNIVERSITETI "AAB", PRISHTINË, REPUBLIKA E KOSOVËS

SIGURIA, BASHKËPUNIMI RAJONAL DHE REFORMAT

- Kosova dhe Maqedonia -

FORUMI I SIGURISË KOSOVË-MAQEDONI, 2018

Prishtinë, 2018

PËRMBAJTJE

PARATHËNIE.....6

PJESA E PARË
REFORMAT NË SISTEMIN E SIGURISË.....12

Marjan Gjurovski,
Reformat e sistemit të sigurisë të Republikës së Maqedonisë.....13

Mensut Ademi,
Reformat në sektorin e sigurisë në Republikën e Kosovës 2000-2018.....27

PJESA E DYTË
KËRCËNIME NGA TERRORIZMI DHE LUFTËTARËT E HUAJ,
KUNDRUALL RISOCIALIZIMIT DHE DERADIKALIZIMIT.....50

Zllate Dimovski,
Ekstremizmi i dhunshëm si mjet për kryerjen e terrorizmit.....51

Olliver Baçanoviq, Bojan Hristovski,
Deradikalizimi i “luftëtarëve të huaj” si pjesë nga procesi i risocializimit në institucionet penitenciare (ndëshkuese-korrektuese) në Republikën e Maqedonisë.....64

Armin Krzhaliq, Nexhad Korajlliq,
Terrorizmi si kërcënim global i sigurisë.....72

PJESA E TRETË

**DILEMA E SIGURISË: NDRYSHIME TË KUFIVE PËR KRIJIMIN
E SHTETEVE ETNIKISHT TË “PASTRA” OSE MENAXHIMI
ME TË DREJTAT E PAKICAVE.....86**

Zhidas Daskalovski,

Dilema e sigurisë: ndryshimi i kufive për arritjen e shteteve
etnike “të pastra” ose menaxhimi me të drejtat e pakicave.....87

Fatmir Çollakaj,

Re dilema e sigurisë, ndryshimi i kufive për të arritur deri te shtetet
e “pastra” etnike apo menaxhimi me të drejtat e pakicave.....100



PARATHËNIE

Parathënie e publikimit Politikat e Rastit në kuadër të projektit të Forumit të Sigurisë Kosovë-Maqedoni 2018, organizuar nga Fondacioni “Konrad Adenauer”, për Republikën e Kosovës, Fakulteti i Sigurisë - Shkup në Universitetin “Sh. Klimenti” i Ohrit, Republika e Maqedonisë dhe Universiteti “AAB”, Republika e Kosovës.

Siguria e shtetit, duke përfshirë edhe qytetarët, ekonominë dhe institucionet e saj, përfshinë, përveç aktiviteteve të shteteve të tjera, edhe aktivitetet e aktorëve të dhunshëm joshitetorë. Në përgjithësi, termi siguria i referohet sigurisë së një shteti nga kërcënimet, siç janë: terrorizmi, lufta apo spiunazhi.

Shkaqet potenciale të pasigurisë kombëtare përfshijnë aktivitetet e shteteve të tjera (p.sh. sulme ushtarake ose kibernetike), aktorë të dhunshëm joshitetorë (p.sh. sulme terroriste), grupe të krimit të organizuar, siç janë: kartelet e drogës, por edhe pasojat e fatkeqësive natyrore (p.sh. përmbytjet, tërmetet).

Forcimi i sigurisë në Kosovë dhe Maqedoni do të ndikojë pozitivisht në qeverisjen e tyre të mirë dhe do të ketë rëndësi jetike për tejkalimin e pasojave të konflikteve të ndryshme të armatosura në të dy vendet dhe për parandalimin e përsëritjes së incidenteve të dhunshme dhe akteve terroriste. Siguria dhe paqja janë të mirat publike dhe shoqëria në tërësi, si dhe individët në të, përfitojnë nga përmirësimi i sigurisë. Pa të, ata nuk do të arrijnë sukses në vendosjen dhe ruajtjen e sundimit të ligjit, në sigurimin e zhvillimit shoqëror dhe rritjen ekonomike si dhe mbrojtjen e demokracive të tyre të reja.

Maqedonia dhe Kosova fillimisht duhet të kenë siguri funksionale në mënyrë që ata të mund të kenë edhe stabilitet rajonal, të kontribuojnë në operacionet për mbështetjen e paqes dhe të integrohen në institucionet euro-atlantike dhe europiane. Në kuadër të projektit u zhvillua një analizë dhe hulumtim në tri fusha që lidhen me konceptin e sigurisë në të dy vendet, reformën e sektorit të sigurisë, kërcënimeve nga terrorizmi dhe luftëtarëve të huaj, risocializimin, deradikalizimin dhe rritjen e sigurisë përmes politikave për të drejtat e pakicave dhe të rrezikut nga ndryshimi i kufijve në rajon. Analizat tona do të prezantohen në një konferencë të përbashkët brenda kornizës së Forumit Kosovaro-Maqedonas të Sigurisë 2018, i cili, besoj se tradicionalisht do të mbahet çdo vit me mbështetjen e partnerëve tanë, Fondacionit Konrad Adenauer. Në Kosovë do të organizohet një ngjarje ku do të debatohet publiku akademik dhe profesional, dhe në të njëjtën kohë do të bëhet prezentimi i punimeve të mbledhura në kuadër të këtij studimi të rastit në të cilin janë përfshirë profesorë nga Republika e Kosovës, Republika

e Maqedonisë dhe Bosnë e Hercegovina që bashkëpunojnë me institucionet e vendeve të përmendura.

Unë falenderoj Drejtorinë e Fondacionit „Konrad Adenauer“ për Republikën e Kosovës dhe Republikën e Maqedonisë, Johannes D. Rey, dhe bashkëpunëtorët e tij në zyrat në Prishtinë dhe Shkup për mbështetjen e vazhdueshme të të gjitha projekteve dhe aktiviteteve, që kontribuojnë drejtpërdrejtë në forcimin e stabilitetit, zhvillimin dhe prosperitetin e Republikës së Maqedonisë, Republikës së Kosovës, vendeve të rajonit etj.

Tema 1: Reformat në sistemin e sigurisë (RSS)

Udhëheqja demokratike dhe e aftë e sistemit të sigurisë ka rëndësi thelbësore për të ardhmen e Ballkanit Perëndimor. Reforma e sistemit të sigurisë nuk mund të konsiderohet si një aktivitet, por si një numër i caktuar aktivitetesh që kanë për qëllim të krijojnë një rrethim operacional të pranueshëm të sistemit të sigurisë në vend, që të sigurohet stabiliteti i tij, sistemi politik dhe popullata. Qëllimi kryesor i sistemit të sigurisë është ruajtja e paqes dhe stabilitetit konform standardeve demokratike. Kontrolli civil demokratik mbi forcat e sigurisë ka rëndësi vendimtare për mundësimin e sigurisë në interes të popullatës. Përveç kësaj, procesi demokratik i vendimmarrjes kërkon transparencë dhe llogaridhënie. Kjo do të thotë se është e nevojshme të përfshihet publiku i gjerë. Prandaj, reforma e sistemit të sigurisë përfshin zhvillimin e mbikëqyrjes efektive civile dhe krijimin e institucioneve që mund të ofrojnë siguri. Tre kategoritë e gjera të aktiviteteve që lidhen me reformën e sistemit të sigurisë të cilat rekomandohen dhe zbatohen nga aktorët përkatës janë: ristrukturimi i institucioneve të sigurisë, me prioritet kryesor në ndërtimin e forcave të sigurisë transparente, efektive dhe efikase; forcimin e mekanizmave të kontrollit duke promovuar qeverisjen e mirë në sistemin e sigurisë, duke siguruar kështu efektivitetin e forcave të sigurisë; dhe rindërtimin e sistemit të sigurisë duke zgjidhur problemet urgjente që u ngritën në periudhën pas situatave konfliktuoze. Në vitet e fundit, Kosova dhe Maqedonia po përpiqen t'i reformojnë nënsektorët e sistemeve të tyre të sigurisë. Ne i analizuam suksesin e reformave dhe ligjet e reja të propozuara lidhur me tri kategoritë e gjera të reformës të sistemit të sigurisë.

Tema 2: Kërcënimet nga terrorizmi dhe luftëtarët e huaj

Veprimet e të ashtuquajturit Shteti Islamik në Irak dhe Siri e rënduan situatën tashmë shqetësuese globale me migracionin, duke ngritur në të njëjtën kohë shqetësimet nga radikalizmi i dhunshëm dhe terrorizmi. Në kuadër të krizës së paradokohëshme të refugjatëve dhe emigracionit, është konfirmuar se migrantët mund të jenë terroristë, por edhe terroristët mund të jenë emigrantë në një numër mënyrash të ndryshme, të paktën një prej tyre është i rëndësishëm për Maqedoninë dhe Kosovën, përkatësisht, rreziku nga të ashtuquajturit „ri-atdhetarë“ (të kthyerit), respektivisht, luftëtarët e huaj që janë të angazhuar në aktet e terrorizmit, duke përfshirë edhe sulmet terroriste vetëvrasëse pas kthimit në vendet e tyre të origjinës. Të dy vendet e kanë kriminalizuar ndjekjen e aktiviteteve ushtarake në vendet e huaja. Kosova dhe Maqedonia kanë strategji për të parandaluar terrorizmin apo ekstremizmin e dhunshëm, duke u fokusuar kryesisht në atë që mund të bëjnë në zbatimin e ligjit, sistemin gjyqësor dhe organet e tjera zyrtare. Megjithatë, ekziston një kërcënim i qartë nga terrorizmi në të dy vendet. Për shembull, në nëntor të vitit 2016, policia e Kosovës njoftoi se ka penguar një skenar terrorist që kishte për qëllim të sulmojë një fushë futbolli gjatë një ndeshje ekskluzive. Udhëheqësit, sipas policisë, ishin pjesëtarë të ISIL-it nga Siria. Sipas një raporti të publikuar nga Qendra Sufan, prej rreth 900 personave nga Ballkani Perëndimor që kanë shkuar për të luftuar në Siri dhe Irak, rreth 250 veta janë kthyer në vendet e tyre të origjinës. Në Maqedoni u arrestuan persona të dyshuar për përfshirje në ISIL në Irak, Siri apo Afganistan. Në përgjithësi, këta ish luftëtarë të infiltuar në komunitete, në rrethana të vërteta (mungesa e tolerancës etnike, historia e dhunës etnike dhe ekstremizmi, perioda e zgjatur e varfërisë, mungesa e infrastrukturës, mungesa e mbikëqyrjes së qeverisë) mund të jenë burimi i ekstremizmit të dhunshëm vendor. Çfarë duhet të bëjnë Maqedonia dhe Kosova në lidhje me këtë problem? A duhet të ketë një qasje më të gjerë shoqërore? Cilat aktivitete po ndërmerren për risocializimin dhe deradikalizimin e tyre kur do të kthehen në vendin e tyre?

Tema 3: Dilema e sigurisë: ndryshimet e kufijve për krijimin e shteteve etnikisht „të pastra“ ose menaxhimi me të drejtat e pakicave

Një vend që është etnikisht i larmishëm është më legjitim nëse të gjithë qytetarët e tij, dhe jo vetëm ata të shumicës, e konsiderojnë territorin e shtetit si vendlindjen e tyre, e pranojnë sistemin ligjor të shtetit dhe institucionet e tij dhe i respektojnë

simbolet e vendit si simbole të tyre. Këto të mira duhet bashkërisht të shpërndahen me të gjithë qytetarët e tjerë. Komuniteti politikë i një shteti shumëkulturore do të jetë i drejtë nëse është formuar nga grupe etnike të bashkuara që jetojnë së bashku. Simbolet e tij zyrtarë, festat, arritjet kulturore që prezantohen në shkolla dhe kujtimet historike do të thithin diçka nga tradita e të gjitha grupeve etnike që i përkasin atij shteti, që të mundën të gjithë ta ndiejnë shtetin si të tyre: në të njëjtën mënyrë, të gjithë do të mund të shohin se shteti nuk është pronë e tyre ekskluzive, por se e ndajnë me të gjitha grupet e tjera etnike që e përbëjnë. Argumenti i përgjithshëm është se sa më i mirë të jetë integrimi i pakicave, aq më të mira janë marrëdhëniet etnike dhe siguria e brendshme e shtetit. Kosova dhe Maqedonia zbatojnë politika që i përmirësojnë të drejtat e komuniteteve pakicë. Disa nga këto politika me të vërtetë e kanë përmirësuar jetën e anëtarëve të rëndomtë të grupeve minoritare. Politikat e tjera, madje, debatohen (Ligji për Gjuhët dhe Ligji për Asociacione të Komuniteteve në Kosovën Veriore) dhe nxisin ndarje. Një kundër-strategji për arritjen e drejtësisë në shtetet multi-etnike është ndryshimi i kufijve të shteteve fqinje në një mënyrë që pas ndryshimeve të dy shtetet sa më shumë të jenë mono-etnike. Rreziku është që ndryshimet e tilla të kufijve në rajon ose më gjerë të shkaktojnë më shumë kërkesa për autonomi politike dhe ndryshime të mëtejshme të kufijve që do të jenë të vështira për t'u kontrolluar dhe menaxhuar. Duke pasur parasysh historinë e vrullshme të ndryshimeve kufitare ballkanike, madje edhe nëse ndryshimet bashkërisht janë dakorduar, ato do të përbëjnë një rrezik për sigurinë në rajon. Sidoqoftë, është vështirë të fitohen shtete etnike „të pastra“. Pa marrë parasysh sa janë të vogla, disa pakica do të mbeten në vendet që i kanë modifikuar kufijtë e tyre. Historia na mëson se presioni ndaj këtyre pakicave do të jetë i fortë për asimilimin ose thjesht për largimin e tyre. Në vazhdim e analizojmë gjendjen dhe çështjet më urgjente në këtë temë.

Redaktor:
Doc. Dr. Marjan Gjurovski

PJESA E PARË



REFORMAT NË SYSTEMIN E SIGURISË

1.1. REFORMAT E SISTEMIT TË SIGURISË TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Dr.Sc. Marjan Gjurovski

*Fakulteti i sigurisë – Shkup
mgjurovski@fb.uklo.edu.mk*

Hyrje

Ballkani Perëndimor është një term gjeopolitik që i referohet vendeve në vijim: Shqipërisë, Bosnjë e Hercegovinës, Kroacisë, Maqedonisë, Kosovës, Serbisë dhe Malit të Zi. Ky term për të parën herë është përdorur në fillim të viteve të nëntëdhjeta të shekullit të kaluar, me qëllim për të shpjeguar Jugosllavinë minus Slloveninë, plus Shqipërinë. Vendet e Ballkanit Perëndimor në një kontekst politik dhe ekonomik janë përshkruar si „vrina e zezë“ e Evropës, si rezultat i mungesës të bashkëpunimit me pjesën tjetër të Evropës dhe reformave të ngadalta të orientuara drejt modernizimit dhe demokratizimit të këtyre vendeve.

Vendet e Ballkanit Perëndimor zënë një territor prej 196,047 km² me një popullsi prej rreth 21,5 milionë banorë. Përveç luftërave të përgjakshme dhe konflikteve në vitet e '90-ta, si dhe rënies së fuqishme të ekonomisë së tyre, në 5-6 vitet e fundit shënojnë një përparim të rëndësishëm dhe zbatimin e suksesshëm të reformave në shumë fusha.

Menaxhimi me sektorin e sigurisë përfshinë struktura, procese, vlera dhe sjellje që i formësojnë vendimet e sigurisë dhe zbatimin e tyre. Qëllimi për përmirësimin e menaxhimit me sigurinë është që t'u "ofrohet" siguri në mënyrë efikase dhe efektive subjekteve përmes mbikëqyrjes dhe kontrollit demokratik.

Reformat në sektorin e sigurisë në vendet e Ballkanit Perëndimor varen nga ndihma e Bashkimit Evropian dhe NATO-s. Duke pasur parasysh dëshirën e tyre për anëtarësim në të dy institucionet, vendet e Ballkanit Perëndimor kanë filluar të përfshijnë normat dhe standardet e sigurisë euroatlantike. Këto vende janë një pjesë e pandashme e rajonit të Evropës Juglindore, i cili edhe sot, si shtyllë bartëse e komunikimit midis Evropës dhe Azisë, është një peng i fenomeneve kriminale tradicionale dhe bashkëkohore (trafikimi me armë, me njerëz dhe drogë, prania e grupeve terroriste dhe lëvizjeve religjioze ekstremiste). Organizatat

kriminale ndërkombëtare, kadrovikisht dhe teknikisht janë më mirë të pajisura se sa shërbimet ekzistuese të sigurimit shtetëror dhe i shfrytëzojnë rregullativat e pamjaftueshme të rregulluara juridike dhe të sigurisë të vendeve, koordinimin e dobët dhe efikasitetin e pamjaftueshëm të institucioneve të drejtësisë dhe sigurisë. Zhvillimet që shënuan fundin e shekullit të XX-të dhe fillimin e shekullit XXI ndryshuan thelbin e kërcënimeve të sigurisë në rajon dhe në Europë dhe treguan se kërcënimet ndaj vlerave kushtetuese të Ballkanit ende kanë një parashnjë etnike. Ngjarjet lanë pasoja të sigurisë, pasoja ekonomike, sociale, psikologjike dhe të tjera, kurse tejkalimi i tensioneve dhe konflikteve ndëretnike ka mbetur sfida më e rëndësishme për përfaqësuesit e qeverive të vendeve. Një rrethanë e tillë në historinë më të re të Ballkanit u reflektua në kënaqjen e nevojave për përkatësinë kombëtare dhe orekset për krijimin e shteteve të mëdha njëkombëshe. Përpjekjet për autonomi dhe pavarësi të grupeve të caktuara etnike shpesh shoqëroheshin me përdorimin e forcës dhe armës, që kontriboi për komplikimin e gjendjes së sigurisë. Konfliktet lokale, kohëzgjatja, intensiteti dhe eskalimi i mëtejshëm i tyre që vështirë parashikohen, kishin për qëllim përmbushjen e nevojave të identiteteve të ndryshme etnike, kulturore dhe fetare. Megjithëse duket se kanë përfunduar, disa prej tyre edhe sot po digjen fshehtas dhe mund të bëhen kërcënim me karakter rajonal. Përveç kësaj, në disharmoninë e shoqërive, humbja e legjitimitetit të shtetit mbi qytetarët e tij ishte një nga arsyet për orientimet radikale të grupeve të caktuara etnike që u ndjenë të marginalizuara në vendin e tyre. Gjatë kësaj periudhe, liderët në rajon, si pjesë integrale e politikës për zgjidhjen e tensioneve ndëretnike, iu drejtonin luftës dhe dhunës si dhe përdornit të një doze të madhe të retorikës luftarake, madje edhe me koston e humbjes së kredibilitetit të tyre para qytetarëve në demokracitë e reja. Me kalimin e kohës, qasja në zgjidhjen e problemeve ndëretnike ka ndryshuar në mënyrë drastike. Retorika e përdorur, ideologjia dhe praktika treguan mangësi të mjaftueshme në mënyrën intervenuese dhe imponimin e paqes. Madhësia e territorit të shtetit, pozita gjeostrategjike, fuqia ekonomike dhe marrëdhëniet me Bashkimin Europian dhe NATO-n, luajtën një rol të rëndësishëm në integrimin e shteteve në gjendjen e sigurisë në Europë. Megjithatë, asnjë shtet në rajon nuk mund të përcaktojë në mënyrë të pavarur interesat e veta të sigurisë pa u lidhur me sfidat e sigurisë dhe interesat e sigurisë të vendeve të rajonit.

Iniciativat (Nismat) e Sigurisë në Ballkan

Në pjesën më të madhe të së kaluarës europiane, Ballkani nuk përbënte një rajon koherent, përkundrazi, edhe vetë ishte i ndarë. Në shumë prej ndarjeve më të rëndësishme në historinë e kontinentit, disa prej të cilave edhe sot ndikojnë në

politikën e rajonit. Në dekadën e fundit të shekullit të 20-të, Ballkani u trajtua nga komuniteti ndërkombëtar si një rajon i dobët dhe i dështuar që shkaktoi reagime të shteteve dhe organizatave të caktuara që synonin drejtë stabilizimit të tij. Në të njëjtën periudhë, vendet e rajonit që dolën nga komunizmi u përballën me sfida të brendshme të një profili të ndryshëm: në sistemin e mëparshëm shtetet nuk kishin legjitimitet elektoral, por kishin autoritet dhe ishin në gjendje të sundonin, ndërsa në vendet e tranzicionit të dobët, elitat më së shpeshti kishin legjitimitet, por qeveritë nuk kishin autoritet dhe kapacitet për të qeverisur.

Për një periudhë më të gjatë, duke filluar nga shpërbërja e RSFJ-së, për shkak të rrethimit specifik dhe jostabilitetit të vazhdueshëm, vështirësi e veçantë për secilin nga vendet e Ballkanit ishte definimi dhe renditja e prioriteteve të sigurisë, kundruall qëndrimeve të ashpra nacionaliste të autoriteteve vendorë dhe mungesën e komunikimit të ndërsjellë në rajon. Me përfundimin e konflikteve dhe përparimin e proceseve demokratike në rajon, tek krijuesit e politikës së sigurisë shtetërore ngadalë shuheshte frika nga agresioni nga fqinjët. Mundësia e konfliktit të brendshëm ndëretnik në asnjë nga vendet nuk është shuar plotësisht, por u zëvendësua në masë të madhe me mundësinë nga kërcënime të shkaktuara nga format e krimit të organizuar. Krimi i organizuar ka rigjeneruar rrjetin e tij - pjesërisht i shuar gjatë kohës së konflikteve.

Rajoni i Ballkanit pas vitit 1989 kaloi përmes disa ndryshimeve tektonike, prej të cilëve secili ka pasur potencial të mjaftueshëm për të ndryshuar thelbin e sistemit shoqëror që është karakteristik për vendet e Ballkanit deri në atë periudhë. Pas rënies së komunizmit, formalisht u promovua sistemi i ri politik-ekonomik dhe procedurat e demokracisë, kurse ndarja e RSFJ-së dhe vendosja e pesë vendeve në vend të një shteti të mëparshëm ndryshuan tërësisht gjeopolitikën e rajonit dhe raportin e SHBA-ve dhe të Bashkimit Evropian drejt tij.¹

Prandaj, iniciativat e sigurisë kanë dalë si rezultat i ndërvarësisë dhe njohjes së interesave shtetërore të vendeve të Ballkanit Perëndimor, por kanë përfshirë edhe vende të tjera në rajon dhe më gjerë, të cilët në iniciativat u paraqitën si donatorë, partnerë ose vëzhgues. Në vetë fillimet e bashkëpunimit rajonal të sigurisë duhet të përmendim rekomandimet për vendet e rajonit nga anëtarët e Këshillit të Evropës të dhëna në Samitin e Parë dhe të Dytë të Shefave të Shteteve dhe Qeverive.

¹ Pendarovski Stevo, „Siguria ndërkombëtare“, Shkup, viti 2009, fq. 203.

Megjithëse u mbajtën në një kohë kur në hapësirat e Ballkanit zhvillohej luftë, ata u referoheshin përpjekjeve të shteteve evropiane për qetësimin e tensioneve dhe mbrojtjes nga kalimi i konfliktit në pjesë të tjera të Evropës. Por, për shkak të situatës jashtëzakonisht të shqetësuar të sigurisë, askush nuk i pa vendet e Ballkanit si partnerë seriozë në kthimin e paqes. Përkundër përpjekjeve të bashkësisë ndërkombëtare, kufijtë që i përcaktonin grupet në baza etnike, kulturore, fetare dhe të tjera për të përfaqësuar ura të bashkëpunimit, në atë periudhë u dëshmuar se më shpesh janë burim i kërcënimeve dhe rreziqeve për paqen. Me modelin për përfshirjen e Euro-rajoneve u krijua bazë për bashkëpunime në më shumë fusha, e ky ishte fillimi për zhvillimin e bashkëpunimit ndërkufitar të sigurisë që u bë pjesë e politikës rajonale të sigurisë. Megjithëse në këtë rajon vepron Interpoli si shtylla bartëse e bashkëpunimit ndërkombëtar të policisë kriminale, megjithatë, Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, për shkak të specifikës së formave të reja të krimit, kanë instaluar organe të posaçme në formën e iniciativave rajonale të sigurisë (së pari, SECI, Pakti i Stabilitetit në vitin 1999, iniciativa këto që kanë origjinën nga Pakti dhe të tjerë). Nëpërmjet iniciativave të sigurisë, partnerët nga BE, SHBA dhe vendet e treta dërguan një sinjal të qartë për interesat e tyre dhe vullnetin e bashkësisë ndërkombëtare për integrimin dhe stabilizimin e vendeve të Evropës Juglindore. Pikërisht me fillimin e realizimit të tyre, filloi të jetojë koncepti për promovimin e vlerave demokratike, marrëdhënieve të mira fqinjësore dhe bashkëpunimit rajonal në funksion të ruajtjes së përhershme të paqes në hapësirat ballkanike. Te iniciativat e sigurisë, në masë të madhe u përfaqësua siguria si elementi më kritik që i mungonte rajonit. Që nga periudha e shpërbërjes së RSFJ-së, dhe më parë, për shkak të mungesës së strategjisë së sigurisë të Bashkimi Evropian, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dominuan në hapësirën ndërkombëtare të sigurisë. Kështu, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, si forca më e fuqishme brenda NATO-s, dominimin e vet e realizuan edhe në Ballkan. SHBA pretendonin mbrojtje indirekte të vendeve në të cilat ekziston një bazë për arritjen e qëllimeve dhe interesave të tyre shtetërore, dhe veçanërisht të atyre vendeve tek të cilit u imponuan si garanci për sigurinë ose partnerë strategjikë në anëtarësimin në NATO. Ata, duke përdorur fuqinë e tyre dhe diplomacinë intensive, realizuan aksione konkrete për parandalimin dhe ndalimin e konflikteve tashmë të përshkallëzuara. Kjo u dha autoritet të mjaftueshëm në marrëdhëniet me vendet e Ballkanit Perëndimor. Disa nga vendet mbajtën distancë, por disa prej tyre kanë zhvilluar lidhje më të ngushta me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Aleancën, gjë që u mundësoi një pozicion më të favorshëm në integrimet euro-atlantike. Nga këto marrëdhënie, u zhvillua iniciativa për formimin e Grupit të Adriatikut.

Për kompletimin e efekteve mbi stabilitetin dhe sigurinë e rajonit, kanë kontribuar edhe misionet e bashkësisë ndërkombëtare me prezencë politike, humanitare, ushtarake dhe policore, të cilat ende në disa pjesë të rajonit garantojnë stabilitetin dhe zhvillimin shoqëror.

Prioritetet e operacioneve paqësore të zbatuara në Ballkan kishin më shumë për qëllim krijimin e sistemit të një shteti ligjor me formimin e strukturës të sistemit të sigurisë, zbatimin e ligjeve dhe ndihmën gjatë funksionimit të gjyqësorit, sesa për pajtimin dhe ndarjen e palëve ndërluftuese. Efekte të plota dhanë vetëm misionet e NATO-s dhe misionet ushtarake të Bashkimit Europian pas miratimit të Politikës Europiane të Sigurisë dhe Mbrojtjes në vitin 2003. Iniciativat për bashkimin rajonal të kapaciteteve në pjesën e menaxhimit të krizave, mbrojtjes dhe shpëtimit, qendra rajonale e përbashkët kundër terrorizmit, krijimi i bazave për një qendër të përbashkët analitike për shërbimet e inteligjencës në vendet e rajonit dhe të tjera, janë pjesë e iniciativave për ndryshime konkrete në bashkëpunimin e sigurisë.

Nevoja për reforma në sistemin e sigurisë

Tradicionalisht, me sistem të sigurisë nënkuptojmë një grup institucionesh dhe organizatash që janë të autorizuar të përdorin forcën, të urdhërojnë përdorimin e forcës ose të kërcënojnë me përdorimin e forcës për të mbrojtur të drejtat e qytetarëve dhe interesat e shtetit. Sektorin e sigurisë në kuptimin e ngushtë e përbëjnë: ushtria, policia dhe shërbimet e inteligjencës. Në një kuptim më të gjerë, sistemi i sigurisë përbëhet nga strukturat përgjegjëse për mbikëqyrje dhe menaxhimin e forcave të sigurisë, organizatat paraushtarake dhe strukturat private të sigurisë. Në shoqëritë konfliktuoze, sistemi i sigurisë përfshinë edhe faktorin ndërkombëtar. Sistemi i sigurisë është një nga elementet kyçe të shoqërive demokratike, veçanërisht në shtetet post-komuniste dhe post-konfliktuoze në tranzicion, pasi strukturat e sigurisë duhet të jenë plotësisht demokratike dhe përmes kontrollit parlamentar t'i përgjigjen publikut.

Në mënyrë që të institucionalizohet një sistem i sigurisë mbi bazë demokratike dhe të arrihet integrimi euroatlantik, vendet e Ballkanit Perëndimor duhet të ndryshojnë sistemin e tyre të vlerave. Përveç përparimit të tyre legjislativ, të gjitha institucionet e sigurisë në rajon duhet të jenë më transparente dhe të përgjegjshme dhe të përmirësojnë kapacitetet e tyre të zbatimit. Menaxhimi me sistemin e sigurisë përfshinë strukturat, proceset, vlerat dhe sjelljet që i formësojnë vendimet për sigurinë dhe zbatimin e tyre. Qëllimi për përmirësimin

e menaxhimit me sigurinë është që të „ofrohet“ siguria në mënyrë efektive dhe efektive për subjektet përmes monitorimit dhe kontrollit demokratik.

Reformat në sistemin e sigurisë në vendet e Ballkanit Perëndimor janë të varura nga asistencën e Bashkimit Evropian dhe NATO-s. Duke pasur parasysh dëshirën për anëtarësimin e tyre në të dy institucionet, Shqipëria, Bosna dhe Hercegovina, Kroacia, Maqedonia, Kosova, Serbia dhe Mali i Zi kanë filluar të inkoorporojnë normat dhe standardet euroatlantike të sigurisë. Të gjitha këto vende kanë zhvilluar legjislacionin e sigurisë dhe pikat e mëposhtme i referohen përparimit legjislativ, por edhe realitetit të bazuar:

- » **Mbrojtja:** legjislacioni që rregullon mbrojtjen dhe vendos mekanizma të monitorimit është krijuar në të gjitha vendet. Transparenca dhe komunikimi publik për mbrojtjen varion nga relativisht e mbyllur deri te i hapur përkohësisht. Përgjithësisht, reformat e mbrojtjes bazohen në përcaktimin e misionëve të reja, objektivave dhe detyrave të armatave në vendet e rajonit.
- » **Inteligjenca:** vendet i riorganizuan agjencitë e inteligjencës dhe vendosën mekanizma të monitorimit dhe një kornizë të juridiksionit të tyre. Megjithatë, reformat në fushën e inteligjencës po vuajnë nga trashëgimia e qeverive të centralizuara, mungesa e burimeve dhe funksionimit të pamjaftueshëm të institucioneve mbikëqyrëse.
- » **Policia:** shërbimi policor, i përdorur dikur si një ushtri private e regjimeve në pushtet, po përpiqet të zhvillojë një mënyrë të re të menduarit sipas të cilit policia duhet të jetë një shërbim publik. Të gjitha shtetet, me përjashtim të Bosnës dhe Hercegovinës, i përfunduan reformat policore dhe zhvilluan strategji. Disa prej tyre i dhanë përparësi të rëndësishme konceptit **community policing**. Megjithatë, shërbimet e policisë ende janë të centralizuara, përgjegjësi publike akoma nuk është e zhvilluar. Në Republikën e Maqedonisë, koncepti i ndryshimeve në sigurinë publike është në vijim e sipër me prioritet të përcaktuara qartë në strategjinë e miratuar për reformat dhe ndryshimet në Ministrinë e Brendshme.
- » **Menaxhimi kufitar:** objektivat siç janë: decentralizimi, depolitizimi, dekriminalizimi dhe çmilitarizimi i menaxhimit të kufijve, janë inkoorporuar në zgjidhjet legjislative në të gjitha vendet. Megjithatë, ndryshime të

rëndësishme në praktikën e menaxhimit të kufijve, duke përfshirë mungesën e transparencës dhe përgjegjësisë, duhet të ndodhin akoma.

Rënia e Murit të Berlinit dhe bashkimi i Gjermanisë shënoi fundin e ndarjes bipolare të botës. Në Ballkan, një gjë e tillë ishte shpërbërja e Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (RSFJ). Pas tejkalimit të problemeve të shkaktuara nga shpërbërja e federatave dhe qetësimit të nacionalizmit euforik, filluan proceset e tranzicionit në të gjitha sferat e jetës shoqërore. Integrimi në NATO dhe BE ishte qëllimi kulminant politik i shumicës së udhëheqësve të shteteve ish-socialiste. Në pjesën e ekonomisë, madje, tranzicioni nga një ekonomi socialiste, e planifikuar drejt një ekonomie të orientuar drejt tregut ishte transformimi më serioz që duhej përfunduar. Nga mënyra në të cilën u realizuan reformat ekonomike, në masë të madhe vareshin edhe arritjet politike të ish shteteve socialiste. Sot, mund të konkludojmë se një pjesë e shteteve kanë arritur ta kalojnë tranzicionin, të tjerët ende po përballen duke e shikuar fundin, kurse vende të treta ende bredhin nëpër kthesat post-socialiste, duke u përpjekur të kapin ndonjë lidhje me vendet e tjera evropiane. Në lidhje me grupin e fundit, pa asnjë dyshim, mund të konkludojmë se në atë bëjnë pjesë shumica e vendeve të Ballkanit Perëndimor. Kjo tregon për të konkluduar se pikërisht në këto hapësira do të presim fundin e konsolidimit dhe demokratizimit në Europën Lindore. Historia do të japë përgjigje nëse një prishje e tillë radikale e vendeve të Europës Lindore pritej dhe nëse transformimi i domosdoshëm që pasoi ishte i suksesshëm.

Ishin tepër të mëdha pritjet se reformat fillestare në sektorin e sigurisë dhe të mbrojtjes, menjëherë pas ndryshimeve në periudhën 1989-1997, do të ishin të mjaftueshme për të drejtuar sektorin e sigurisë dhe të mbrojtjes dhe aktorët kryesorë të tyre dhe për të siguruar sjelljen e duhur në shoqëritë e tyre formale të sapoformuara demokratike. Procesi i reformimit të sektorit të sigurisë nuk përparoi ashtu sikurse, në shikim të parë, u dukej sikurse reformatorëve ashtu edhe vëzhguesve. Në përgjithësi, shumë pak ka ndryshuar në aspektin praktik, kurse reformat fillestare memzi kanë kontribuar për ndryshime „kozmetike“. Kjo ishte më e dukshme në dominimin e vazhdueshëm të ish-shërbimeve të sigurisë shtetërore dhe agjencive të inteligjencës në sektorin e sigurisë dhe të mbrojtjes, madje edhe pas vitit 1991, problem që vazhdoi të dominonte në axhendën e vendeve të rajonit deri vonë, kur tani më kemi përcaktuar dinamikën e transformimit të Departamentit për siguri shtetërore.²

² Islam Yusufi, “Reform Processes in the Security Sector and their Influence on Security Governance”, artikull i prezentuar në Konferencën e Dytë Vjetore për Sigurinë Njerëzore, organizuar nga HUMSEC projekti në Sarajevë, 2007, fq.5.

Reformat në sistemin e sigurisë të Republikës së Maqedonisë

Koncepti i reformave të sistemit të sigurisë është me rëndësi të jashtëzakonshme në periudhën e pasluftës, ose, siç ishte rasti me Maqedoninë, në shoqëritë në tranzicion. Megjithëse është teorikisht i papërfunduar (i parrumbullaksuar), koncepti i reformimit të sektorit të sigurisë është i një rëndësie të madhe praktike, sepse përdoret si një tregues i suksesit të procesit të transformimit shoqëror³.

Reforma e sistemit të sigurisë nënkupton auditimin e dokumenteve strategjike, reformën e policisë, reformën e gjyqësorit, reformën e burgjeve, reformën e inteligjencës, reformën e mekanizmave të kontrollit dhe reformën e mbrojtjes. Në Maqedoni nuk ka përparim të rëndësishëm në lidhje me hierarkinë e strategjive - në kulm gjendet një koncept i ri për sigurinë dhe mbrojtjen kombëtare, kurse në nivelin më të ulët janë reformat e policisë dhe strategjia për menaxhimin e integruar të kufirit. Është etabluar një sistem i ri i menaxhimin të krizave i cili duhet t'i koordinojë operacionet e sigurisë me punën e shërbimeve të inteligjencës. Një avancim po bëhet në fushën e depolitizimit dhe transparencës në funksionimin e sistemit të sigurisë, por kjo nuk mjafton.

Sipas vëzhguesve ndërkombëtarë, situata aktuale po përmirësohet, edhe përkundër incidenteve sporadike me elemente të dhunës ndëretnike dhe politike. Maqedonia përballlet me një sfidë themelore për përmirësimin e efikasitetit të strukturave të sigurisë në kryerjen e detyrave të tyre themelore, qofshin ato gjatë kohës së paqes ose në gjendje lufte. Procesi i reformave është shënuar nga dy tendenca të rëndësishme: rindërtimi post-konfliktuoz pas vitit 2001 (demobilizimi dhe armatimi) dhe proceset e afrimit drejt NATO-s dhe BE-së.

Me reformat në sistemin e sigurisë veçanërisht duhet të arrihet, për shembull: të Presidenti i Republikës paraqiten kompetenca të mëdha në fushën e mbrojtjes. Roli i tij si komandant suprem i forcave të armatosura duhet të përcaktohet qartë. Në rastin e Maqedonisë ka një ndjenjë nga shpejtimi i tepërt i rolit të tij si komandant suprem, veçanërisht në kushte paqësore, krahasuar me autoritetet e tjera shtetërore (Kuvendi, Qeveria, Ministria e Mbrojtjes dhe Shtabi i Përgjithshëm i ARM-së) në bazë të udhëheqjes, menaxhimit dhe komandimit me ARM-në. Sëkëndejm, me reformat paraqitet edhe nevoja për sqarimin e rolit të tij si komandant suprem në kushtet paqësore dhe në kushtet e sistemit parlamentar.

³ "Siguria e Ballkanit Perëndimor" - artikull-Koncepti i reformës të sektorit të sigurisë, numër 11, Beograd 2008, fq.4.

Pozita e theksuar e Presidentit si komandant suprem, është më shumë karakteristike e sistemit presidencial dhe në të njëjtën kohë nuk përdoret pozita e tij në krijimin e një politike të sigurisë ku ka kompetenca të drejtpërdrejta. Prandaj, miratimi i dokumenteve strategjike për siguri nga Presidenti duhet t'i transferohet Qeverisë së Republikës së Maqedonisë.

Parlamenti si bartës i pushtetit legjislativ duhet më energjikisht dhe më fortësisht ta zbatojë këtë funksion primar në sigurinë dhe në politikën e sigurisë. Karakteristikë për sistemet parlamentare është ushtrimi i funksionit të kontrollit, dhe prandaj me reformat paraqitet nevoja nga forcimi i funksionit të tij kontrollues në sistemin e sigurisë. Në rastin e Republikës së Maqedonisë, funksioni kontrollues i sistemit të sigurisë dhe politika e saj thjesht nuk ndihet.

Kur është fjala për Qeverinë e Republikës së Maqedonisë, me reformat kërkohet edhe rishqyrtimi, rregullimi normativ dhe realizimi efektiv i të drejtave dhe detyrimeve të përgjithshme në bazë të sigurisë dhe politikës së sigurisë të vendit. Me reformat, me rëndësi të veçantë është të ringjallet funksioni koordinues që duhet të ketë Qeveria në fushën e sigurisë në tërësi, si e drejtë e saj parësore. Në esencë, Qeveria siguron unitetin e institucioneve dhe interesave shtetërore, të cilat, madje, janë thelbësore për sigurinë e Republikës së Maqedonisë. Ky bashkërendim duhet të shprehet maksimalisht në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes, sepse në esencë Qeveria është përgjegjëse për realizimin e një bashkëpunimi të ngushtë midis të gjithë sektorëve të sistemit të sigurisë. Në rastin e Maqedonisë, nuk ndjehet se kush e përcakton politikën e sigurisë dhe kush e koordinon zbatimin e saj.

Shtabi i Përgjithshëm i Armatës nevojitet të aftësohet dhe të orientohet drejt realizimit të detyrave të sigurimit të profesionalizimit të ushtrisë, gatishmërisë luftarake dhe komandimit të ARM-së. Njerëzit të cilët profesionalisht merren me kryerjen e detyrave të tyre në Armatën duhet të jenë anësh nga trazirat e përditshme politike dhe jashtë partive politike. Për më tepër, reformat duhet të përqëndrohen drejtë intensifikimit të procesit të profesionalizimit, ngritjen e standardeve konform standardeve të NATO-s dhe përgatitjen e Armatës për anëtarësimin e plotë në NATO. Në këtë pjesë, specifikimin e kërkojnë edhe relacionet: Presidenti-Ministri i Mbrojtjes -Shefi i Shtabit të Përgjithshëm; Presidenti-Qeveria-Shtabi i Përgjithshëm dhe Presidenti-Qeveria-Agjencia e Inteligjencës.

Këshilli i Sigurisë Kombëtare ende nuk e ka zënë vendin e vërtet në realizimin e sistemit të vetëm të sigurisë në vend. Një nga zgjidhjet është miratimi i një ligji të veçantë me të cilin do të zgjidhet pozita dhe kompetencat e këtij Këshilli.

Në Republikën e Maqedonisë mbetet çështja e hapur për realizimin e koordinimit të strukturave të sigurisë, ose të ashtuquajturit komuniteti i sigurisë. Me themelimin e Qendrës për Menaxhimin e Krizave, ndoshta ideja ka qenë të zgjidhet koordinimi kombëtar i komunitetit të sigurisë si shtyllë e arritjes së konceptit të një sistemi të vetëm të sigurisë kombëtare. Por, siç qëndrojnë gjërat, ky organ ende nuk i jep rezultatet e dëshiruara dhe përpjekjet e ardhshme duhet të përqendrohen në atë se çfarë do të thotë operacionalizimi i funksioneve të tij, kurse koordinimi i komunitetit të sigurisë duhet të zgjidhet në një mënyrë tjetër adekuatë kompatibil me vendet e tjera, si për shembull, përmes themelimit të Komitetit për Sigurinë dhe Politikën e Sigurisë.

Përfundim

Një nxitje shtesë për reformat efektive të sigurisë të vendeve të Ballkanit Perëndimor është fokusimi i tyre në integrimin në BE dhe NATO. Nevojiten reforma strategjike në sektorin e sigurisë, me qëllim të përshtatjes ndaj modeleve të vendeve-anëtare. Nga ana tjetër, vendet e Ballkanit nuk mund të zbatojnë në mënyrë të pavarur ndryshimet pa mbështetje dhe ndihmë nga sistemet tjera për sigurinë kolektive. Prandaj, ekziston nevoja t'i kushtohet një vëmendje dominante NATO-s dhe BE-së drejt kësaj pjese të Europës, duke monitoruar vazhdimisht stabilitetin e një zone jostabile siç është Ballkani. Vendeve ballkanike u është e qartë se vetëm duke ndërtuar marrëdhënie të mira fqinjësore dhe bashkëpunim ndërkombëtar në fushën e ndërtimit të sigurisë globale dhe ballafaqimin me risqet dhe rreziqet mund të krijohet gjendje e sigurisë, e ruajtur dhe e avancuar nga një sistem efikas i sigurisë. Qëllimi i reformave është sigurimi i shërbimeve profesionale të mbrojtjes dhe sigurisë që do të mundësojnë ruajtjen e sigurisë, si dhe zbatimin dhe sundimin e ligjit konform legjisllacionit kombëtar, duke marrë parasysh rregullat dhe praktikat e vendeve-anëtare të Bashkimit Europian. Zhvillimi i sistemit të sigurisë varet, mbi të gjitha, nga sfidat dhe kërcënimet e reja, por edhe nga aftësia për të identifikuar bartësit dhe burimet e kërcënimit. Sistemet e sigurisë që do të mbeten të pa reformura ose të pazhvilluara mund të përbëjnë një kërcënim serioz, sikurse për qytetarët e tyre, poashtu edhe për sigurinë dhe imazhin e rajonit që dëshiron të përfaqësohet në botë si i orientuar demokratikisht dhe i ngritur mbi trashëgiminë negative.

Zgjerimi i konceptit të sigurisë së Republikës së Maqedonisë mundëson përfshirjen e kërcënimeve potenciale të reja dhe më të gjera për sigurinë, kryesisht zhvillimin ekonomik, shkatërrimin e mjedisit, shkëlqet e të drejtave të njeriut dhe lëvizjet e migracionit. Duke analizuar unikalitetin dhe unitetin e sektorëve (ushtarak, politik, ekonomik, mjedisor, shoqëror) konform konceptit të gjerë të sigurisë në Republikën e Maqedonisë, konstatimi është se të gjithë sektorët mund të funksionojnë shumëdimensionalisht (të pavarur, të ndërlidhur dhe pjesërisht të pavarur) varësisht nga faktorët të specifikimit dhe kushtet në të cilat krijohen dhe i realizojnë aktivitetet e tyre. Duke folur për sigurinë kombëtare, gjithsesi se elementët që lidhen me politikën e sigurisë, strukturat e sigurisë, kapacitetet e mbrojtjes dhe të tjera, kanë një lidhje logjike me sigurinë, mbijetesën, mbrojtjen, paqen, por në asnjë mënyrë identifikimi i sigurisë kombëtare nuk mund të jetë imperativ vetëm për një nga këto të nënvizuara, konform konceptit të gjerë të kuptimit të sigurisë. Zbatimi i koncepteve përkatëse të sigurisë në Republikën e Maqedonisë është i kushtëzuar nga sfidat e sigurisë me të cilat ballafaqohet shteti, si dhe nga disa faktorë të caktuar të cilit kontribuojnë për zbatimin e suksesshëm të koncepteve themelore në sistemin e sigurisë, është hipoteza e dytë e veçantë e cila, gjithashtu, konfirmohet përmes dokumenteve që e ndërtojnë politikën e sigurisë të vendit. Prandaj, çështje kryesore për reforma të vërteta të sistemit të sigurisë në Maqedoni është çështja e pranimit të modelit për ndryshimet në konceptin e sigurisë kombëtare. Kjo, në të vërtetë, do të thotë të ndërtohet: një qëndrim politik në shtetin dhe institucionet shtetërore; kulturë politike në lidhje me menaxhimin e sektorit të sigurisë; forcimi i konceptit të sigurisë së integruar konform rreziqeve dhe kërcënimeve dhe politikës së sigurisë; dhe ndryshime në legjislacionin dhe politika e sigurisë që do t'i akceptojnë këto qëndrime në Republikën e Maqedonisë. Me propozim-sugjerimet për ndryshimet që duhet të bëhen në organe dhe segmente të caktuara, do të avancohet sistemi i sigurisë dhe zbatimi i politikës së sigurisë.

Koncepti i sigurisë së integruar është çelësi në realizimin e zgjidhjeve sistemore për sfidat e sigurisë, përcaktimin e zhvillimit të sigurisë dhe trasimin e perspektivave të shoqërisë në nivel rajonal dhe ndërkombëtar.

Më i pranueshëm është Koncepti i Sigurisë së Integruar, domethënë, siguri e përgjithshme ose e plotë nga të gjitha format e kërcënimit të armatosur dhe të paarmatosur dhe realizimin e sigurisë së plotë dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet dhe segmentet në jetën dhe veprimet e njeriut dhe të shoqërisë. Segmentet e sigurisë së integruar e cila si koncept duhet të ndërtohen janë, si vijon: së pari, siguria e integruar është gjendje e Republikës së Maqedonisë dhe

komunitetit shoqëror në të cilin nuk ka rreziqe reale për zhvillimin e saj paqësor dhe të pavarur; së dyti, siguria e integruar është veprimtaria e përgjithshme e forcave të organizuara të shoqërisë në lidhje me parandalimin dhe luftën kundër të gjitha formave të veprimit destruktiv të forcave të jashtme ose të brendshme dhe sanimin ose eliminimin e plotë të ndikimeve shkatërruese dhe destabilizuese tashmë të realizuara; së treti, siguria e integruar është një sistem i definuar, organizatë që përbëhet nga elemente ose pjesë individuale nga të cilat secili veçmas e kryen funksionin e tij personal të sigurisë dhe të gjithë së bashku e rregullojnë funksionin e përgjithshëm me të cilin në mënyrë efikase mbrohen vlerat themelore të shtetit dhe të komunitetit shoqëror, dhe së katërti, siguria e integruar, varësisht nga burimi i rrezikimit dhe destabilizimit të Republikës së Maqedonisë, përbëhet nga siguria ndërkombëtare (kolektive, e përbashkët, rajonale, globale dhe kooperative), e cila është e lidhur shumë ngushtë me sigurinë e brendshme (individuale dhe kombëtare). Siguria kombëtare e Republikës së Maqedonisë renditet ndër problemet me të cilat ballafaqohen njerëzit si individë. Në Republikën e Maqedonisë, si një shoqëri bashkëkohore demokratike, ndjehet nevoja për një ekuilibër (balanc) midis (politikës) shtetërore dhe sigurisë.

Siguria e Republikës së Maqedonisë është parakusht për stabilitet të suksesshëm të jashtëm dhe të brendshëm, si dhe zhvillim gjithpërfshirës të jetës shoqërore të institucioneve dhe qytetarëve. Pozita aktuale e sistemit të sigurisë në Republikën e Maqedonisë nuk ofron një përgjigje adekuate të krizave, rreziqeve dhe kërcënimeve. Domosdoshmëria për stabilitet dhe siguri imponon nevojën për të ndërtuar politika përkatëse të sigurisë nëpërmjet strategjive, doktrinave dhe koncepteve të reja.

Komiteti për Sigurinë dhe Politikën e Sigurisë duhet të jetë një organ i ri qeveritar që vetvetiu do të ruhet si një subjekt i unifikuar në fokusimin e vendimeve strategjike politike. Një nga treguesit e këtij uniteti politik është roli i diskutimeve të përgjithshme politike në pushtetin ekzekutiv. Në rastin e qeverisë së koalicionit, për shembull, kredibiliteti i tij do të thotë ndërhyrje në politikën e sigurisë dhe kjo mund të gjendet në rolin e një ndërmjetësi ndërmjet koalicionit të ndarë qeveritar. Në këtë rast, koordinimi më së shpeshti duhet të udhëhiqet nga parimi i përgjegjësisë së detyrueshme, në të cilin të gjithë ministrat qeveritar janë të detyruar të mbështesin vendimin e miratuar. Qeveria duhet të ketë përgjegjësinë kryesore për koordinimin shtetëror të politikës së sigurisë, kështu që një sistem i qartë për marrjen e vendimeve në këtë nivel kolektiv dhe individual është vendimtar. Kur do të arrihet një vendim politik, paraqitet nevoja për përgatitje serioze nga ana e administratës për alternativa dhe implementime të mira. Nevojitet që brenda

Qeverisë të krijohet së pari një bashkëpunim i mirë funksional ndërinstitucional dhe ministritë e tjera kompetente të kenë vendosur një strukturë dhe procedurë për vendimmarrje. Strukturat ekzistuese zakonisht janë ndërtuar rreth nivelit më të lartë të ekzekutivit, por u mungojnë shtresat e koordinimit dhe përgatitjes së politikës së sigurisë. Për tejkalimin e gjendjes të mungesës së koordinimit dhe mospërputhjes në implementimin e politikave të sigurisë duhet të kërkohet një zgjidhje që mund të jetë një supozim për respektimin e parimit për zbatimin e aktiviteteve të sigurisë kombëtare dhe politikës së sigurisë me të gjitha burimet në dispozicion dhe të gjithë faktorët e pushtetit shtetëror për çka nevojitet të miratohet një rregullore e veçantë, gjegjësisht zgjidhje ligjore që së pari do ta rregullojë koordinimin e institucioneve të sigurisë dhe komunitetin e inteligjencës, kurse kjo nuk do të thotë asgjë nëse nuk ka implementimin e plotë të politikës dhe nëse informacionet nuk janë përpunuar dhe sërisht nuk kthehen në sistem që të mund ai të reagojë. Kjo rregullore, që është një akt i veçantë ligjor ose nënligjor, duhet të ndihmojë në pjesët për marrjen e informacioneve, përpunimin dhe projektvendimet. Duhet, gjithashtu, të ekzistojë një organ i veçantë, si për shembull, një Qendër Analitike e përbashkët që do të jetë në pozitën kierarkike nën zëvendës-kryetarin e Qeverisë për sistemin politik dhe do të sigurojë bashkërendimin dhe unitetin e të gjitha kapaciteteve të inteligjencës dhe me këtë në mënyrën më optimale do ta sigurojë vlerësimin e sigurisë të Republikës së Maqedonisë, kurse pas kësaj do t'i qaset përgatitjes së një politike efektive të sigurisë. Me këtë rregullore duhet të përcaktohet detyra e Qendrës Analitike përmes së cilës me vetë informacionet do të monitorohet zbatimi i vendimeve të miratuara nga Presidentit i Republikës dhe nga Kryetari i Qeverisë në fushën e sigurisë; zbatimi i politikës së sigurisë, mbindërtimi i saj, harmonizimi i punës të shërbimeve të inteligjencës dhe përgatitje e seancave të Qeverisë dhe të Këshillit të Sigurimit. Në përgjithësi, Qendra Analitike duhet të ndërlidhet me të ashtuquajturin Komitet i ri për siguri dhe politikë të sigurisë, i cili do të udhëhiqet nga zëvendës-kryetari i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë për sistem politik, i cili duhet të ketë një rol koordinativ me kompetencat e mëposhtme: të japë udhëzime dhe të rivlerësojë organizimin dhe funksionimin e institucioneve të sistemit të sigurisë, vazhdimisht t'i shqyrtojë kërcënimet për sigurinë brenda dhe jashtë vendit dhe të ballafaqohet me ato probleme për të cilat do të jetë përgjegjës. Prandaj, ky Komitet për Sigurinë dhe Politikën e Sigurisë pranë Qeverisë, duhet në mënyrë statutare nëpërmjet një ligji të posaçëm për siguri të integruar të implementohet në fushat e mëposhtme: shkëmbimi i informacioneve, përdorimi i përbashkët i bazave të të dhënave, ndërveprimi në fushën e veprimtarive operative dhe hetuese dhe monitorimi i sigurisë politikë.

Në fund do të theksoja se me rrybullakësimin e reformave në sistemin e sigurisë, duhet të arrijmë në rezultatet e dëshiruara, por për këtë duhet të arrihet marrëveshje politike dhe të intensifikohet ndërtimi i një koncepti të vetëm të sigurisë së integruar, si dhe ndërtimi i të ashtuquajturave relacione të dobishme midis të gjitha llojeve të pushtetit në vetë shtetin.

Literatura e përdorur:

- » Stevo Pendarovski, „Siguria ndërkombëtare“, Shkup, 2009.
- » Jordan Spaseski, „Maqedonia – shtylla e sigurisë dhe paqes në Ballkan“, Shkup, 2005.
- » Bakreski O, Millosheviq M, „Sistemet bashkëkohore të sigurisë – analiza komparative e vendeve të Evropës Juglindore“, Shkup, 2010.
- » Islam Yusufi, “Reform Processes in the Security Sector and their Influence on Security Governance”, artikull i prezantuar në Konferencën e Dytë Vjetore për sigurinë e njeriut, organizuar nga ana e HUMSEC projektit në Sarajevë, 2007.
- » „Strategjia për sigurinë kombëtare të Republikës së Serbisë“, Beograd, 2009.
- » „Përmbledhje vjetore për reformat në sektorin e sigurisë në Serbi“- Qendra për marrëdhënie civile-ushtarake, 2009.
- » „Siguria e Ballkanit Perëndimor“, Numri 11, Beograd, 2008.
- » Strategjia e sigurisë kombëtare e Malit të Zi.
- » Context Analysis & Chronology of the Security Sector Reform in Albania 1991-2009“-INSTITUTE FOR DEMOCRACY AND MEDIATION- ALBANIA.
- » Caparini Marina, “Security and conflicts”, 2003.
- » „Qendra për marrëdhënie civile-ushtarake“, internet faqja: <http://www.ccmrbg.org/Novo/3991/Predstavljene+analize+konteksta+reforme+sektora+bezbednosti+u+zemljama+Zapadnog+Balkana.shtml>.
- » Fittipald Mariangela, “Reformat e sektorit të sigurisë dhe medieve në BeH – rruga drejtë menaxhimit të suksesshëm me sektorin e sigurisë”, fq.5, në veb-faqen <http://www.css.ba/docs/Media&SSReformBOS.pdf>.
- » Veb-faqja zyrtare e Drejtorisë Policore të Malit të Zi <http://www.upravapolicije.com/navigacija.php?IDSP=5>.
- » <https://www.cia.gov/library/publications/the-world-factbook/geos/al.html>.

1.2. REFORMAT NË SEKTORIN E SIGURISË NË REPUBLIKËN E KOSOVËS 2000-2018

Dr.sc. Mensut Ademi

*Kolegji AAB Fakulteti Juridik- Prishtinë
mensut.ademi@universitetiaab.com*

Hyrje

Një ndër sfidat aktuale të shteteve të Ballkanit Perëndimor është bashkëpunimi zyrtar mes shteteve të rajonit dhe përmirësimi i bashkëpunimit mes tyre, e sidomos kur është në pyetje transparencja e sektorëve të sigurisë në gjithë rajonin, ku sipas disa të dhënave statistikore regjionale është mjaft e dobët. Duke u nisur nga ajo që u tha shfaqet një problem thelbësor se si agjencionet e zbatimit të ligjit në sektorët e sigurisë nuk kanë informacione mbi atë se cili sektor i sigurisë është përgjegjës për cilën fushë, cilat janë kompetencat e tij, kush kontrollon secilin sektor.

Mungesa e transparencës nga agjencionet e zbatimit të ligjit dhe sektoreve të sigurisë në përgjithësi është pengesë reale e mundësisë sa më efektive të mbikëqyrjes nacionale ndaj këtyre sektorëve, si pasojë e mos transparencës atëherë vijmë deri te një perceptim që rezulton në qytetarë të humbin besimin ndaj këtyre institucioneve. Disa nga shtetet e Ballkanit Perëndimor në këtë rast edhe Rep. e Kosovës vjen nga një mjedis postkonflikti dhe me këtë rast për sigurinë në përgjithësi dhe sektorët e sigurisë në veçanti diskutohet në masë të madhe me nacionalizëm etnik dhe kjo është një pengesë e madhe e bashkëpunimit ndër sektoriale të shteteve në përgjithësi në Ballkanin Perëndimor në veçanti shtetin më të ri në Ballkan Rep. e Kosovës.

Reformat në sektorin e sigurisë në Rep. e Kosovës janë ndihmur çdo herë nga ndërkombëtarët, kanë filluar që nga viti 1999-2008-2012-2018 por vazhdon ende në harmonizimin e legjislacionit karshi detyrimeve dhe obligimeve kushtetuese të sektorëve të sigurisë në fushën nacionale duke u fokusuar në transparencë, llogaridhënie, monitorim nacional dhe bashkëpunim ndërkombëtarë. Të gjitha institucionet e sigurisë nga themelimi e deri më tani nuk kanë arritur të marrin thauja të gjithë përgjegjësinë sipas mandatit të tyre, duke u thirrur në një fakt se Rep. e Kosovës e ka shpallë pavarësinë në vitin 2008 dhe nga ky vit ka filluar të vendoset kontrolli, monitorimi civil-demokratik ndaj sektorëve të sigurisë në vendin tonë.

Institucionet e sigurisë në Republikën e Kosovës mbrojnë sigurinë publike dhe të drejtat e të gjithëve në vend.

1. Çka kuptojmë me sektor të sigurisë në Rep. e Kosovës

Sektori i sigurisë në Kosovë përbëhet nga një numër institucioneve dhe mekanizmesh të cilët përbëhen nga sektorët e sigurisë dhe nënsektorët përmes së cilave funksionalizohet mandati i tyre.⁴ Kompetencat dhe pushteti i tyre përcaktohen me Kushtetutë, si dhe mbështetet me tutje me ligje e rregullore.

Mes institucioneve apo mekanizmave më të rëndësishëm janë parlamenti, presidenti, qeveria (kryeministri dhe ministratë përkatëse), Këshilli i Sigurisë së Kosovës, Policia e Kosovës, Forca e Sigurisë së Kosovës, bashkë me Agjencinë Kosovare të Inteligjencës. Siç do të shpjegohet më poshtë, jo të gjitha institucionet e sigurisë kanë pushtetin të përdorin forcë apo të marrin mandate ekzekutive. Aktualisht, i vetmi institucion vendës i sigurisë në Kosovë që ka të drejtë të përdorë çfarëdo lloji të forcës fizike është policia, duke e bërë kështu institucionin më të rëndësishëm vendës të sigurisë.

1.1. Cilët janë sektorët e sigurisë në Rep. e Kosovës

Siç është theksuar më lart, qëllimi i sektorit të sigurisë, është kryerja e një studimi gjithëpërfshirës të institucioneve të sektorit të sigurisë përkitazi me nevojat e sigurisë së Kosovës, në një mënyrë transparente, legjitime, të përballeshme dhe llogaridhënëse, dhe duke e parë dinamikën e funksionalizimit të këtyre sektorëve duhet disa nga to të fillojnë ristrukturim.

Si problematikë në secilin vend shfaqet edhe definimi i mandateve dhe detyrave kyçe të secilit sektorë të sigurisë, ndihmon qeverinë të jetë më efikase dhe të rritë (maksimizojë) shërbimet e saj ndaj qytetarëve në një mënyrë legjitime dhe financiarisht të përballeshme, duke mënjanuar shërbimet e dyfishuara dhe të mbivendosura, dhe duke shmangur konkurrencën ndërmjet institucioneve që ofrojnë siguri për qytetarët e Kosovës.⁵

⁴ R.Maslesa, Teorit e sistemit të sigurisë, ligjerata në Universitetin AAB, Prishtinë, 2009, fq.18.
⁵ Secila Ministri ose Agjenci e përfshirë në RSSS kishte për obligim të krijoj grupe punuese në kuadër të institucioneve të tyre. Pastaj institucionet e sigurisë kanë zhvilluar skenarët për të identifikuar kërkesat potenciale të reja dhe mangësitë në kapacitete dhe aftësi të institucioneve të sektorit të sigurisë për të marr përsipër dhe duke reaguar ndaj krizave të mundshme në Kosovë. Përveç kësaj, Termat e Referencës përcaktonin detyrat e grupeve punuese dhe mënyrën e koordinimit të rezultateve të punës së tyre me koordinatorët tjerë nga Ministratë tjera, grupit koordinues ndërministror (GKNM) dhe Komitetit Drejtues.

Nga viti 2012 sektorët e sigurisë në Rep.e Kosovës kanë filluar reformat sipas disa fazave :

Tab.1

| | |
|------------------|---|
| Faza I | Përfshinë krijimin e strukturës së procesit, caktimin e stafit për strukturën/ procesin, përcaktimin e supozimeve planifikuese për procesin. |
| Faza II | Përcaktoi objektivat strategjike të Republikës së Kosovës; politikat e sigurisë dhe mbrojtjes; analizimin e rreziqeve dhe kërcënimeve të mundshme ndaj sigurisë të Republikës së Kosovës. |
| Faza III | Përshkruan arkitekturën e ardhshme të sektorit të sigurisë, gjithashtu edhe të kapaciteteve dhe aftësive (të gjitha institucionet dhe agjencitë të identifikojnë sfidat e sektorit të sigurisë sikurse është përcaktuar .paraprakisht). |
| Faza IV | Përfshinte një analizë të hollësishme të aftësive aktuale të institucioneve dhe agjencive shtetërore të sigurisë, si dhe definimin e kapaciteteve të duhura dhe të panevojshme dhe pasqyrimin e kapaciteteve të nevojshme. |
| Faza V | Përfshinte përcaktimin e roleve dhe misionëve, strukturat, emrat, dhe lokacionin/ vendndodhjen e të gjitha institucioneve dhe agjencive të sektorit të sigurisë. |
| Faza VI | Përfshinte analizimin e ndikimeve dhe përballueshmërisë financiare. |
| Faza VII | Kërkonte prezantimin dhe miratimin e rekomandimeve të RSSS-së. |
| Faza VIII | Kërkon hartimin e Strategjisë së re Kombëtare të Sigurisë të Republikës së Kosovës. |
| Faza IX | Kërkon hartimin e Strategjisë së re Kombëtare të Sigurisë të Republikës së Kosovës. |
| Faza X | Përfshinë vazhdimin e zbatimit të ligjeve të reja dhe sipas nevojës ngritjes apo uljes së kapaciteteve institucionale. |

1.2. Forca e Sigurisë e Kosovës

Forca e Sigurisë e Kosovës (FSK) është forcë e re, profesionale, shumë etnike, lehtë e armatosur dhe e uniformuar e sigurisë e cila i nënshtrohet kontrollit demokratik, civil. Për momentin FSK ka detyrë dhe obligime që të kryej operacionet e reagimit ndaj krizave në Kosovë dhe jashtë saj, operacionet e mbrojtjes civile brenda Kosovës si dhe t'i ndihmoj autoriteteve civile në përgjigje ndaj katastrofave natyrore dhe emergjencave të tjera. FSK-ja do t'i përfaqësojë dhe mbrojë të gjithë njerëzit e Kosovës.⁶

1.2.1. Legjislacioni i FSK⁷

LIGJI Nr.04/L-177 për dërgimin e FSK jashtë vendit; LIGJI Nr. 04/L-084 për pensionet e pjesëtarëve të FSK-së, LIGJI Nr. 04/L-089 për deminim humanitar, LIGJI Nr. 03/L-213 për komponentin rezervë të FSK-së, Ligji Nr. 03/L-082 për shërbimin në FSK-ë , Ligji Nr. 03/L-045 për MFSK, Ligji Nr. 03/L-046 për FSK.

Cilat masa legislative parashihen që kanë të bëjnë me transformimin e FSK-së në Forca të Armatosura të Kosovës:⁸

- a) Amandamentimin e Kushtetutës së Kosovës për misionin e ri të FSK-së, përkatësisht për transformimin në Forca të Armatosura të Kosovës;
- b) Aprovimin e Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me Forcat e Armatosura të Kosovës – qëllimi i të cilit është përcaktimi i misionit të ri të Forcave të Armatosura të Kosovës, në mbrojtje të integritetit dhe sovranitetit të Republikës së Kosovës, ristrukturimi i saj si dhe roli dhe kompetencat e zinxhirit të kontrollit civil demokratik të këtyre forcave;
- c) Ligjin për Komisionerin për Forcat e Armatosura të Kosovës.⁹

⁶ <https://www.mksf-ks.org/?page=1,666#.W9taB5NKjcs>

⁷ <https://www.mksf-ks.org/?page=1,73>, për shkakë faqeve të kufizuara nuk mundemi t'i përmendim edhe rregulloret e FSK.

⁸ Qeveria e Republikës së Kosovës, Programi Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, Mars 2016, http://www.mei-ks.net/repository/docs/1_pkzmsa_miraturar_nga_kuvendi_final_.pdf.

⁹ Ligji për KSF, Art 10.2 , Një numër i vogël i personelit, i armatosur lehtë dhe me armatim të kalibrit të vogël, me objektiva të kufizuara dhe nën mbikëqyrje të pranisë së NATO/KFOR në Kosovë janë indikator që FSK është duke u zhvilluar në strukturë e cila gjeneron siguri në rajon. Në të vërtetë, nuk ka ndonjë pritje që roli i FSK të mund të modifikohet në pesë vitet e ardhshme, duke qenë se Ligji për KSF në mënyrë eksplicite parasheh që, "Një rishikim i plotë i këtyre përkufizimeve do të ndërmerret jo më herët se 5 vite nga data e hyrjes në fuqi e këtij Ligji.

1.2.2. Reformat nga UÇK-TMK-FSK

Pas përfundimit të luftës në vitin 1999, Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara miratoi Rezolutën 1244, e cila finalizoi tërheqjen e trupave Serbo-Jugosllave nga Kosova, po ashtu kërkoi demilitarizimin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) si dhe kthimin e të gjithë të zhvendosurve në Kosovë. Rezoluta 1244 parashihte vendosjen e administratës civile të OKB-së në Kosovë të njohur si UNMIK si dhe misionin ushtarak të NATO-s me qëllim të vendosjes së paqes, rendit dhe sigurisë në Kosovë (KSKB Rezoluta, 1999). Gjatë periudhës së administratës ndërkombëtare, statusi i padefinuar politik i Kosovës bëri që sektori i sigurisë në Kosovë të mbetej prioritet i lartë për akterët ndërkombëtar. Rezoluta 1244 ishte *raison d'être* që Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm (PSSP) të kishte kompetenca të rezervuara për këtë sektor të cilat vazhdoi t'i mbante deri në momentin kur Kosova shpalli pavarësinë më 17 Shkurt 2008.¹⁰

Nga viti 1999 - 2008 gradualisht është filluar me ndërtimin e strukturave të sektorit të sigurisë si :¹¹

- » SHPK, Shërbimi Policor i Kosovës, në këtë institucion deri në vitin 2006 janë edukuar dhe trajnuar rreth 7000 (shtatë mijë), pjesëtarë të policisë.¹²
- » Trupat Mbrojtëse të Kosovës (TMK) që u themeluan si rezultat i demilitarizimit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), e që kishte rol të rëndësishëm posaçërisht në detyrat e mbrojtjes civile.¹³


¹⁰ Përgjegjësia e rezervuar është një përkufizim i përdorur nga UNMIK-u që shënoi autoritetin ekzekutiv të PSSP-së mbi fushat kyçe në Kosovë; KCSS_shqip_final_325152.pdf.

¹¹ Përgjegjësitë e rezervuara të UNMIK-ut mbi sektorin e sigurisë bënë të pamundur implementimin e disa parimeve kyçe të RSS, veçanërisht kontrollin demokratik mbi institucionet e sigurisë. Sipas kornizës ligjore, Institucionet e Përkohshmetë Vetëqeverisjes (PISG) nuk kishin as kompetenca ekzekutive e as mbikëqyrëse në raport me SHPK-në, TMK-në dhe gjyqësorin. Kjo situatë nuk ka mundur as efikasitetin e as transparencën, gjë e cila rezultoi me mungesë të çfarëdo matjeje të volumit të performancës së sektorit të sigurisë. Për më tepër gjatë periudhës së parë, mbikëqyrja parlamentare mbi SHPK-në, TMK-në dhe institucionet tjera të sigurisë nuk ishte funksionale.


¹² Nëse kemi parasysh se fi lloi të punoi në një kohë kur pak institucione të tjera ishin themeluar, lirisht mund të konsiderohet si ndër institucionet më të suksesshme në Kosovën e pasluës. Pa dyshim, ky është një atribut i OSBE-së në përpjekje të ndërtimit dhe forcimit të institucioneve vendore. Gazetë e publikuar nga OSBE-ja Edicioni 5 Nr. 2 Qershor – 2006.

¹³ Teksti do i referohet SHPK-së (Shërbimi Policor i Kosovës), apo PK (Policia e Kosovës) i cili është i njëjti institucion, por ndryshoi emrin nga SHPK-ja në PK-së nga viti 2008.

Tab.3



Që prej shpalljes së deklaratës së pavarësisë më 17 Shkurt 2008, korniza ligjore lejon kompletimin e infrastrukturës së sektorit të sigurisë në përputhje me kërkesat dhe nevojat e Kosovës. Sipas Kushtetutës, “Republika e Kosovës ka pushtet mbi zbatimin e ligjit, sigurinë, drejtësinë, sigurinë publike, inteligjencën, organet civile emergjente dhe mbi kontrollin e kufijve në territorin e saj”.¹⁴



Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) është njëri nga sektorët e themeluar pas pavarësisë së Kosovës, si trashëgimtare e TMK-së, ku deri më tani, në vitin 2018 thuajse ka të njejtin mision civil të ngjashëm me ish Trupat Mbrojtëse të Kosovës, POR nga tetori i vitit 2018 me propozim të MFSK - Ministrisë së Forcës së Sigurisë është proceduar në Kuvendin e Kosovës të ndërrohet legjislacioni për FSK nga misioni civil të ketë mandate edhe mision ushtarak, që do të thotë se FSK të kalojë në Forcat e Armatosura të Kosovës FARK.¹⁵

¹⁴ Kushtetuta 2008: Art. 125; E thënë më thjesht, sektori i sigurisë ishte bërë pjesë e përgjegjësisë për qeverinë e Kosovës. Megjithatë, roli i EULEX-it për sa i përket çështjeve të sigurisë dhe mandati paqe-ruajtës dhe paqendërtues i KFOR-it ishte pranuar gjerësisht. Themelimi i Zyrës Civile Ndërkombëtare (ZCN), në kapacitetet e ‘kujdestarit’ për mbikqyrjen e zbatimit të zgjidhjes së përkohshme të Ahtisaar-it, mban autoritetin për të ndërhyrë në rast të ndryshimeve apo thënë më konkretisht mospërputhjeve në zhvillimin e sektorit të sigurisë. Sektori i drejtësisë mbetet një nga sektorët më të dobët edhe në periudhën e pas-pavarësisë (EULEX, 2009: 4). Pavarësisht përpjekjeve në rritje të bashkësisë ndërkombëtare, deri më sot rezultatet mbeten të limituara, duke e mbajtur publikun të pakënaqur me drejtësinë (BIRN, 2009: 8).

¹⁵ Deputetët e Kuvendit të Kosovës miratuan në parim të enjten tre ligje për transformimin e Forcave të Sigurisë së Kosovës (FSK) në ushtri Për ligjin e Ministrisë së Mbrojtjes votuan 101 deputetë, aq sa ishin të pranishëm nga gjithsej 120 deputetë të Kuvendit. Për projektligjin e FSK-së votuan 98 prej aq sa ishin të pranishëm.

Struktura e FSK-së më shumë konsiderohet unike krahasuar me institucionet e tjera të ngjashme në vendet tjera në rajon, është multietnike, POR mos bashkëpunimi dhe pengimi dinamik nga ana e shtetit serb ka arritur deri te një presion qoftë psikik apo fizik ndaj pjesëtarëve të FSK-së nga nacionaliteti serb.¹⁶ Procesi i ndërtimit të strukturave të FSK-së është ende në zhvillim, Ministria e FSK-së (MFSK) identifikon hapin e parë në drejtim të krijimit të strukturave të saj. Struktura bazë e FSK-së përbëhet nga 2,500 pjesëtarë të rregullt dhe 800 rezervë të cilët mbajnë uniforma, emblemë dhe të armatosur lehtë. Ne vitin 2018 FSK-së i janë dhuruar shumë paisje motoristike ushtarake nga KFOR si ai i kontigjentit gjerman dhe ai amerikan.¹⁷

1.2.3. Besueshmëria e FSK-së në nivel nacional

Sipas një ankete të bërë nga Instituti për Studime të Kriminalistikës, Kriminologjisë dhe studimeve të sigurisë nga viti 2009 deri në 2016 , me 4500 respodentë, përfshirë gjithë regjionin e Kosovës dhe të gjitha nacionaliteteve, në pyetjen se sa besojnë në institucionet e shtetit, FSK dhe Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK) del më e besueshmja për qytetarët e Kosovës, me **65.4%**.¹⁸

2. Policia e Kosovës

Shërbimi Policor i Kosovës është themeluar, më 6 shtator 1999, në kuadër të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Ministria e Punëve të Brendshme është themeluar në kuadër të Rregullores së UNMIK-ut 2005/54. Themelimi i saj është miratuar, më 20 dhjetor 2005 (de facto e themeluar në mars 2006). Policia e Kosovës e Kushtetutës së Kosovës, 15 qershor 2008. Policia e Republikës së Kosovës mbanë përgjegjësinë për ruajtjen e rendit dhe sigurisë publike në tërë territorin e Republikës së Kosovës.

¹⁶ <https://telegrafi.com/policia-serbe-arreston-nje-pjesetar-serb-te-fsk-se-;> [http://abc-news.al/arrestohen-5-serbe-u-benin-presion-anetareve-te-forcave-te-sigurise/.](http://abc-news.al/arrestohen-5-serbe-u-benin-presion-anetareve-te-forcave-te-sigurise/)

¹⁷ Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës (MFSK) ka bërë të ditur se organizon aktivitetin e pranim-dorëzimit të donacionit të KFOR-it gjerman dhënë Forcës së Sigurisë së Kosovës në vlerë prej 329.281.78 euro.

Donacioni gjerman i cili mbahet sot në kazermën 'Adem Jashari' në Prishtinë i siguron FSK-së 44 automjete dhe pajisje të tjera

¹⁸ M.Admi, M.Budimlic, Frika nga kriminaliteti, 2009-2016, Prishtinë.

2.1. Reformat dhe kontrolla e Policisë së Kosovës PK nga 1999 deri më 2018

Tab.4

| Управи | Сектори |
|---|---------------------------------------|
| Drejtoria Rajonale e Policisë – PRISHTINË | Departamenti i Operacioneve |
| Drejtoria Rajonale e Policisë - MITROVICË-JUGU | Departamenti i Hetimeve |
| Drejtoria Rajonale e Policisë - MITROVICË-VERIU | Departamenti për Kufijë |
| Drejtoria Rajonale e Policisë - GJILAN | Departamenti i Shërbimeve mbështetëse |
| Drejtoria Rajonale e Policisë - FERIZAJ | Departamenti i Burimeve njerzore |
| Drejtoria Rajonale e Policisë - PRIZREN | |
| Drejtoria Rajonale e Policisë - PEJË | |
| Drejtoria Rajonale e Policisë - GJAKOVË | |

Pas përfundimit të luftës, më 1999 ka qenë e nevojshme dhe e domosdoshme formimi i një sektori të sigurisë siç është sot Policia e Kosovës dhe është zhvilluar dukshëm deri më tani në vitin 2018.

Organizata policore dhe udhëheqja me polici në kushtet e reja shoqërore kërkon transformimin e gjithë modelit piramidial në një model të ri të organizatës policore. Ky transformim, në marrëdhëniet shoqërore gjithnjë më të hapura dhe të ndërlikuara, me hartim të mirë të politikës dhe strategjisë policore, do të mundësojë që edhe udhëheqja me polici të bazohet në premisat shkencore, gjë që do të kontribuojë kualitetit të udhëheqësve, gjë që ka rëndësi të posaçme për këtë strukturë në të gjitha nivelet. Në këtë kuptim, na nevojitet që në pika të shkurta të kthehemi në ato parakushte të cilat janë të domosdoshme për udhëheqje të suksesshme dhe realizim të qëllimeve të organizatës policore, me tendenca themelore që me aftësitë a veta, punëtorët udhëheqës tek policia të forcojnë bindjen për detyrën fundamentale në ruajtjen e sigurisë së brendshme.¹⁹

Policia e Kosovës duhet të udhëhiqet sipas njohurive të duhura dhe me raporte profesionale të ndërtuara, me moral fisnik dhe sensibilitet njerëzor ku përmes

¹⁹ <http://www.kosovopolic.com/>.

këtyre karakteristikave paraqesin shtyllë të fortë dhe lidhë indin e brendshëm organizativ të strukturës policore. Policia e Kosovës PK i ka premiset e lartëcekura ku përmes tyre mund të flasim për udhëheqësinë në polici i cili ka aftësi të parandalojë dhe luftojë në mënyrë të përgjegjshme dhe kreative dukuritë negative dhe devijante në shoqërinë tonë në Rep. e Kosovës.

Policia e Kosoves gjatë këtyre viteve ne tranzicion është specializuar dhe pajisur me paisje bashkëkohore për parandalimin dhe luftimin e kriminalitetit në përgjithësi nga shumë shtete mike të Rep. e Kosovës dhe njëkohesisht e ndihmuar për strukturimin e saj sa më adekaut duke mbrojtur lirinë dhe të drejtat e njeriut.²⁰

Njëri nga faktorët kyç “ Korrupsioni”, është shumë i ulët në departamentet e PK-së, por dallon duke përjashtuar individë të caktuar të cilët kanë depertuar si pjesëtarë të PK-së nga viti 2000 deri te dy gjeneratat e fundit të vitit 2018 në PK , të cilët kanë qenë pjeëstarë të grupeve paramilitare apo militare të cilët kanë kryer krime gjatë luftës së fundit në Kosovë 1998-99, individë të cilët vijnë nga grupet e krimit të organizuar si nga vitet e 90-të ashtu dhe ato pas 1999, të cilët shpeshë herë ua humbin imazhin PK-së. Gjithë kjo ka ndodhur si pasojë e verifikimit të pa mjaftueshëm të organeve kompetente ndërkombëtare ndaj këtyre personave.²¹

Inspektorati i Policisë së Kosovës (IPK), është një mekanizëm i pavarur për të monitoruar policinë dhe ka dy funksione kryesore:

- » *Inspektimin e mënyrës së kryerjes së detyrave nga SHPK dhe një fushë të kufizuar të funksioneve të menaxhimit në kontekst të përshtatjes, efektivitetit dhe zbatimit të ligjeve të aplikueshme,*
- » *të kryej rishqyrtimin e të gjitha ankesave për sjellje të pahijshme nga zyrtarët policorë të PK pa marr parasysh gradat e tyre.*
- » Funksioni i inspektoratit funksionon në tri nivele:
- » *Raportet lidhur me incidentet specifike,*
- » *Raportet tematike lidhur me temat dinamike dhe statike,*
- » *Inspektimi i zakonshëm.*

Organizimi policor dhe udhëheqja me polici në kushtet e reja shoqërore kërkon transformimin e gjithë modelit piramidial në një model të ri të organizatës policore. Ky transformim, në marrëdhëniet shoqërore gjithnjë më të hapura dhe të ndërlikuara, me hartim të mirë të politikës dhe strategjisë policore, do

²⁰ R.Maslesa, Teorit e sistemit të sigurisë, FKKN, Sarajevo, BiH.

²¹ <http://klankosova.tv/njeri-nga-perdhunesit-e-vasfije-krasnqiq-ithe-polic-i-kosoves-per-16-vjet/>.

të mundësojë që edhe udhëheqja me polici të bazohet në premisat shkencore, gjë që do të kontribuojë kualitetit të udhëheqësve, gjë që ka rëndësi të posaçme për këtë strukturë në të gjitha nivelet. Në këtë kuptim, na nevojitet që në pika të shkurta të kthehemi në ato parakushte të cilat janë të domosdoshme për udhëheqje të suksesshme dhe realizim të qëllimeve të organizatës policore, me tendenca themelore që me aftësitë a veta, punëtorët udhëheqës tek policia të forcojnë bindjen për detyrën fundamentale në ruajtjen e sigurisë së brendshme.

2.2. Bashkëpunimi rajonal i PK

Bashkëpunimi rajonal në mes sektorëve të sigurisë në përgjithësi e në veçanti Policia Rajonale duhet të kenë bashkëpunim sepse konsiderohet pikë kyçe e integritit të Ballkanit Perëndimor në Bashkimin Europian. Në shumë nisma dhe organizime në fushën e sigurisë ,PK, është treguar bashkëpunuese, por në të shumtën e rasteve nuk ka qenë përfituese aq sa kanë qenë vendet e rajonit, janë disa projekte ndërkombëtare, të cilat janë krijuar nga Bashkimi Europian, me qëllim të thellimit të integritit të institucioneve të zbatimit të ligjit me vendet e rajonit.

Si pengesë e arritjes së qëllimeve të PK është edhe mos antarsimi në “INTERPOL” dhe “EUROPOLL”, si organizata ndërkombëtare që kanë për mandate parandalimin dhe luftimin e kriminalitetit.

PK duhet të i ofrohet pjesëmarrjes në Iniciativat Rajonale të Policisë – ku do të identifikohen mënyrat e përfshirjes së Kosovës në iniciativat rajonale të sigurisë, këtu mendohet në iniciativat kyçe siç janë:


- » *Konventa e Policisë, SELEC,*
- » *Iniciativa e Shefave të Policisë së Europës Juglindore dhe forume të ndryshme ndërkombëtare.*
- » *Promovimin e bashkëpunimit bilateral policor – ku do të identifikohen mundësitë e bashkëpunimeve bilaterale policore duke u fokusuar kryesisht në bashkëpunimin e Policinë e Serbisë. Qëllimi më konkret është avokimi për bashkëpunime bilaterale policore me qëllim të luftimit të sfidave dhe rreziqeve ndërkufitare.²²*

²² <http://www.qkss.org/sq/Projektet-aktuale/Kosova-ne-Kontekstin-e-Bashkepunimit-Rajonal-Policor-677>.

2.3. Besueshmëria e PK në nivel nacional

Qytetarët e anketuar në vitin 1. 2016, 2.2015, 3.2014, 4. 2014, përmes hulumtimit shkencor, frika nga kriminaliteti tek banorët e Kosovës, kemi arritur deri të dhënat se deri në cilën masë qytetarët kanë besim tek Policia e Kosovës, PK janë si në tabelë, Tab.5.

Tab.5.



3. Agjencia e Kosovës për Inteligjencë

Agjencia e Kosovës për Inteligjencë, AKI, u themelua nga Kuvendi i Kosovës, më 21 maj 2008.²³AKI është themeluar si agjenci për siguri dhe inteligjencë në Kosovë. AKI është person juridik dhe ka mandat të veprojë në tërë territorin e Kosovës. AKI mbledhë informacion në lidhje me kërcënimet ndaj sigurisë së Kosovës. Si kërcënim konsiderohet kërcënimi ndaj integritetit territorial, integritetit të institucioneve, rendit kushtetues, stabilitetit dhe zhvillimit ekonomik, si dhe kërcënimet ndaj sigurisë globale. AKI nuk ka funksione ekzekutive.

Nisur nga fakti se Agjencia Kosovare për Inteligjencë është njëra ndër agjencitë e inteligjencës së brendshme me nivelin më të ulët të transparencës së vendeve të Ballkanit Perëndimor, dhe që, në anën tjetër, është edhe institucioni i sigurisë me nivelin më të ulët të besimit të qytetarëve të Kosovës, është e domosdoshme të ndërmerren hapa të shpejtë drejt rritjes së transparencës dhe llogari-dhënies publike të këtij institucioni.

²³ Ligjit Nr. 03/L-063.

Për të arritur këtë qëllim, kemi një rekomandim ndërmarrjen e këtyre veprimeve për plotësimin e përmbajtjes së ueb-faqes zyrtare të AKI-së: a) *Paraqitja e buxhetit, në format të njëjtë me atë të paraqitur në Ligjin për Buxhetin e Kosovës*; b) *Paraqitja e të dhënave të prokurimit publik*; c) *Paraqitja e opinionit të deklasifikuar të përgjithshëm të auditimit të financave të AKI-së nga Inspektori i Përgjithshëm*; d) *Paraqitja e strukturës organizative*; dhe e) *Paraqitja e Raporteve Vjetore Publike*.²⁴

3.1. Kontrolli i Agjencionit Informativ të Kosovës AKI Policisë së Kosovës PK

Kontrollimi dhe verifikimi është një nga çështjet më të ndjeshme të kredibilitetit dhe funksionimit të sektorit të sigurisë në Kosovë, dhe ky në aspektin ligjor është i rregulluar përmes Ligjit për Klasifikimin e Informatave dhe Verifikimin e Sigurisë, si dhe Ligjit për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë. Mirëpo, zbatimi në praktikë i kësaj kornize ligjore ka shkaktuar shqetësime jo të pakta të aktorëve politikë dhe institucionalë, përfshirë këtu Kuvendin e Kosovës, por edhe Komisionin Europian.²⁵

Sistemi i këtij verifikimi mbështetet në dy ligje: Ligji Nr 03/L- 178 2010 për Klasifikimin e Informatave dhe Verifikimin e Sigurisë, dhe Ligji Nr 03/L- 063 2008 për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë.²⁶

Mirëpo këtu shfaqet një problem se kush e kontrollon dhe mbikëqyrë punën e AKI, këtë veprim e ushtron Komisioni Parlamentar për Mbikëqyrje të AKI-së, mandati i të cilit është përcaktuar nga Ligji Nr. 03/L-063 të vitit 2008 për AKI-në, përfshirë këtu edhe trajtimin e rasteve të dyshimit lidhur me ligjshmërinë e sjelljes së punonjësve të AKI-së.

3.2. Transparenca e AKI-së

Është brengosës fakti që në mesin e qytetarëve të Kosovës AKI e ka besimin më të ulët nga të gjitha institucionet e sigurisë. Edhe pse arsyet e këtij besimi kaq të ulët të qytetarëve mundën vetëm të presupozohen, nuk mund të mohohet fakti që rritja e transparencës publike të AKI-së, nga njëra anë, do të mund të ndikonte

²⁴ Bashkëpunimi brenda-qeveritar është edhe obligim ligjor, Neni 8, Ligji Nr. 03/L-063, Ligji për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë, http://www.aki-rks.org/2008_03-L063_al.pdf, 2008.

²⁵ http://www.kipred.org/repository/docs/OBSERVERI_-_VOL_I_-_N03._Shqip_-_Final_147110.pdf.

²⁶ Ligji për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë, http://www.aki-rks.org/2008_03-L063_al.pdf.

në rritjen e këtij besimi, dhe, nga tjetra, do ta mundësonte edhe rritjen e llogari-dhënies publike, me të cilën do të rritej edhe niveli i qeverisjes demokratike të sektorit të sigurisë në përgjithësi.²⁷

Një nga hapat që duhet ndjekur AKI në rritjen e besushmërisë, do të ndikonte në rritjen e transparencës dhe llogari-dhënies publike të AKI-së dhe publikimi i Raportit Vjetor, ashtu siç është rasti në praktikat e Kroacisë, të vendeve të Europës Qendrore dhe të atyre Baltike. Edhe përkundrejt faktit që këto raporte kanë përmbajtje të ndryshme, ato, në përgjithësi, paraqesin rreziqet dhe kërcënimet e sigurisë ndaj vendeve të tyre, rezultatet e aktiviteteve të paraqitura me shifra dhe në mënyrë narrative për trajtimin e këtyre rreziqeve, bashkëpunimin me institucionet e tjera vendore të sigurisë dhe të inteligjencës, bashkëpunimin ndërkombëtar, mbikëqyrjen e jashtme dhe të brendshme, menaxhimin e personelit, si dhe buxhetin.²⁸

3.3. Besushmëria e AKI-së në nivel nacional

Qytetarët e anketuar në vitin 1. 2016- 25%; 2.2015- 21%, 3.2014-26%, 5. 2013-28%, përmes hulumtimit shkencor, frika nga kriminaliteti tek banorët e Kosovës, kemi arritur deri te të dhënat se deri në cilën masë qytetarët kanë besim tek AKI-Agjencioni i Kosovës për Inteligjencë .

4. Sektori privat i sigurisë në Rep. e Kosovës

Siguria Private SP-ja në Rep. e Kosovës ka filluar të veprojë pothuajse para një dekade, shumë më vonë se në pjesët e tjera të ish-Jugosllavisë. Periudha e gjatë e marrëdhënieve të tensionuara me regjimin e Millosheviqit dhe situata e vështirë politike i vështirësuan zhvillimet e përgjithshme shoqërore. Fundi i luftës në Kosovë më 1999 solli ekonominë e tregut dhe demokracinë pluraliste, si dhe praktikat bashkëkohore të sigurisë njerëzore. Me shpejtësi filluan të krijohen iniciativa të sigurisë private në kohën kur strukturat e sapo lindura të policisë po përpiqeshin të siguronin rendin dhe ligjin. Shumica e SP u themelua nga ish-luftëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ish-oficerët e

²⁷ Shih seksionin: Shqyrtim Analitik i Hulumtimit të Opinioneve Publik, në Observerët e Sektorit të Sigurisë Nr. 1, 2, si dhe 3.

²⁸ Neni 2, Ligji Nr. 03/L-063, Ligji për Agjencinë e Kosovës për Inteligjencë, http://www.aki-rks.org/2008_03-L063_al.pdf, 2008.

Armatës Popullore të Jugosllavisë dhe individë që kishin punuar edhe përpara në çështje të sigurisë.²⁹

Duke u nisur nga një faktor se në Rep.e Kosovës dominon mosha e re dhe gara për të u punësuar në njërin nga sektorët e sigurisë në Rep.e Kosovës është shumë e madhe atëherë është vërejtur se sektori privat i sigurisë është zhvilluar shumë në vendin tonë edhe pse në nuk e kemi harmonizuar plotësisht legjislacionin tonë me atë të Bashkimit Europian-BE. Shërbimet sot që ofrohen nga Siguria Private -SP, fillon nga mbrojtja fizike klasike e pronave private dhe publike, mbrojtja e afërt e VIP-ave, ruajtja e “pronave me rëndësi strategjike” dhe sigurimi i manifestimeve kulturore dhe muzikore.

Duke parë zhvillimin e SP-së është duke u zgjeruar po kontribuon në krijimin e një mjedisi më të sigurtë në Kosovë, dhe në duhet këtu të kemi shumë kujdes sepse nëse nuk marrim disa masa adekuate në ndryshimin e legjislacionit të tanishëm do të kemi aktivitet jashtëligjor nga vetë sektori privat i sigurisë apo individ të specializuar në fusha specifike si ekspertë të sigurisë.

Prania e SP-së në terren në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë i ndihmon autoritetet për zbatimin e ligjit në ruajtjen e qetësisë dhe sigurisë.³⁰

4.1. Kontrollin, reformat dhe legjislacioni i sektorit privat të sigurisë

Sipas të dhënave zyrtare janë 3750 roje të regjistruar të sigurisë. Megjithatë, as personat përgjegjës nuk e mohojnë faktin se ky numër është më i madh. Në bazë të informatave të marra nga SP, nga shënimet zyrtare dhe po ashtu duke llogaritur praktikat e mundshme (që duhet të sqarohen në pjesët e tjera përkatëse) në vlerësojmë se mund të ketë rreth 4000 – 4.500 individë të punësuar nga SP. Është pothuajse e pamundur të gjendet numri i saktë i personave të punësuar për një varg arsyesh.³¹ Privatizimi i sektorit të sigurisë u zhvillua me shpejtësi në periudhën menjëherë pas luftës prandaj, nga vitin 2000

²⁹ SSPIU, (Njësia Hetimore e Ofruesve të Shërbimeve të Sigurisë) Njësi e Policisë së Kosovës për inspektimin e KPS-ve, dhjetor 2008. Megjithatë vlerësohet se 10 kompani nuk janë duke ushtruar veprimtarinë edhe pse i kanë marrë licencat. Ndoshta nuk mund të përballojnë konkurrencën e hapur.

³⁰ http://www.qkss.org/repository/docs/Vler%C3%ABsimi_i_kompanive_private_t%C3%AB_siguris%C3%AB_641794.pdf.

³¹ Rishikimi i Sektorit të Sigurisë së Brendshme në Kosovë, Botimi: Kompanitë private të sigurisë, fq. 112, 2016.

administrata e UNMIK-ut mori masa dhe miratoi aktin e parë për rregullimin e këtij sektori në Kosovë.³²

Proceset e licencimit të Sp-ve, kontrollimin e biografisë (verifikimin) së çdo individi të përfshirë në SP dhe, që konsiderohet më me rëndësi – ndalimin e posedimit të armëve nga SP vendore si dhe nga kompanitë rajonale, siç janë ato nga vendet e ish-Jugosllavisë dhe vendet fqinje.³³

Në fillim të vitit 2007, MPB-ja themeloi një grup punues për hartimin e Projektligjit për sigurinë private, të kryesuar nga përfaqësuesi i MPB-së, pjesë e të cilit ishin edhe përfaqësuesit e Kuvendit të Kosovës – Komisionit për Siguri, përfaqësuesi i OSBE-së dhe po ashtu edhe përfaqësuesit nga shoqatat e KPS-ve.³⁴

Është sygjieruar që ky ligj të jetë në pajtim me legjislacionin e shteteve anëtare të BE-së, dhe ky grup punues është fokusuar në modelin slloven si vend anëtar i BE-së dhe si shtet i ish-Jugosllavisë, i cili mund të ketë gjendjen në këtë fushë shumë të ngjashme me atë të Kosovës.

Ky projektligj i është nënshtruar ndryshimeve të mëdha duke filluar që nga titulli i tij. Për ta thjeshtuar, titulli “Projektligji për Sigurinë Private” është modifikuar në “Projektligji për Kompanitë Private të Sigurisë” dhe është pasuar me modifikime në dispozitat e përgjithshme duke zvogëluar kështu grupin e synuar për të rregulluar vetëm KPS-të dhe duke përjashtuar ofruesit e tjerë të sigurisë jashtë fushëveprimit të këtyre kompanive.²⁹ Këto modifikime themelore dhe mospajtimet në lidhje me çështjen e posedimit të armëve bën që drafti t’i kthehet sponsorit të ligjit (MPB) për rihartimin e tij.³⁵

Në Kosovë, Komisioni i Kuvendit që është përgjegjës për mbikëqyrjen e SP-së është Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri. Përveç rolit të tij si mbikëqyrës i institucioneve të sigurisë, ky Komision duhet të ushtrojë kontroll dhe të kërkojë llogari për aktivitetet e SP-së. Ka pasur disa përpjekje nga një pjesë e anëtarëve të

³² Rregullorja e UNMIK-ut 2000/33.

³³ Neni 2 i Rregullores së UNMIK-ut.

³⁴ Rregullorja e UNMIK-ut 2000/33 për licencimin e ofruesve të shërbimeve të sigurisë në Kosovë dhe rregullimin e personelit të tyre, neni 1.


³⁵ Intervistë me Emrush Xhemajlin, deputet i Kuvendit të Kosovës, Komisioni për çështje të brendshme dhe siguri, 16.01.2009; Duke marrë parasysh se edhe emri i ligjit është modifikuar bashkë me dispozitat e përgjithshme projektligji duhet t’i kthehet prapa sponsorit. http://www.qkss.org/repository/docs/Vler%C3%ABsimi_i_kompanive_private_t%C3%AB_siguris%C3%AB_641794.pdf.

këtij komisioni që të jenë pjesë e hartimit të ligjit dhe të dëgjojnë zërin e SP-ve. Në të vërtetë kjo konsiderohet si hapi i parë drejtë kontrollit të hollësishëm të sektorit privat të sigurisë.³⁶

Reformat në sektorin privat të sigurisë duhet të ketë me urgjencë duke filluar nga ndryshimi dhe harmonizimi i legjislacionit për SP-në me BE-në, vlerësimi dhe monitorimi i Kompanive të SP-së, monitorimi i të punësuarve në SP. Duke u nisur nga kjo vijmë deri te të dhënat se kompanitë e SP-së e kanë të rrgulluar mandatin e tyre sipas legjislacioneve në vendin e tyre në këto kategori si: Sketori Privat i Sigurisë Statike, Sektori Privat i Sigurisë Dinamike, Sektori Privat i Sigurisë Badigard (truproje), Sektori Privat i Sigurisë Hetuese (Detektiv), Sektori Privat i Sigurisë Kooperative dhe Sektori Privat i Sigurisë Forenzike.³⁷

4.2. Besueshmëria e sektorit të sigurisë private në nivel nacional

Qytetarët e anketuar në vitin 1. 2016- 45%, 2.2015-40%, 3.2014-44.2%, 5. 2013-41.6%, përmes hulumtimit shkencor, frika nga kriminaliteti tek banorët e Kosovës, kemi arritur deri te të dhënat se deri në cilën masë qytetarët kanë besim te Kompanitë e Sigurisë Private të Kosovës.



³⁶ http://www.qkss.org/repository/docs/Vler%C3%ABsimi_i_kompanive_private_t%C3%AB_siguris%C3%AB_641794.pdf.

³⁷ M.Ademi, Sektori privat i siguris ne R.Kosoves sipas legjislacionit regjional dhe ati European, ASKK, 2010, Prishtinë.

Mundësitë

Përmes këtij punimi kemi identifikuar mundësitë reale të reformave emergjente ne sektorët e sigurisë qoftë ato publike dhe ato private, kur kemi të bëjmë me rreziqet e shumta të brendshme, përfshirë ekstremizmin etnik dhe fetar, katastrofat natyrore, municione të pashpërthyer/mjete të improvizuara shpërthyes, shpërndarja e armëve të vogla, krimi i organizuar, zhvillimi i pa mjaftueshëm ekonomik, papunësia, institucione të zbehta të sigurisë/drejtësisë, korrupsioni, kufi të kontestuar/të pazgjdhur, dhe keqpërdorim i burimeve natyrore. Të gjitha këto rreziqe mund të kërcënojnë sigurinë, sundimin e ligjit dhe dëmtojnë imazhin e vendit jashtë, duke u bazuar në të dhënat e lartshënuara ne mendojmë se duhet të:

- » Të ofrohen metodologjitë adekuate shkencore për vlerësimin e punës se sektorëve të sigurisë.
- » Rritja e kapacitetit dhe përkushtimit të aktorëve nga shoqëria civile në përforsim të mbikëqyrjes demokratike mbi sektorin e sigurisë.
- » Fuqizimi i sektorit të sigurisë private.

Përparësitë e sektorëve të sigurisë në Rep. e Kosovës

- » Mbrojtja e qytetarëve dhe integritetit territorial të Kosovës.
- » Përpilimi dhe fuqizimi i legjislacionit në fuqi dhe implemetimi i tyre dhe zbatimi i ligjeve.
- » Harmonizimi dhe përpilimi i strategjive nacionale në sektorët e sigurisë.
- » Konsolidimi dhe zhvillimi i mëtejshëm i institucioneve dhe instrumenteve të sigurisë dhe mbrojtjes.
- » Harmonizimi i legjislacionit në pajtim me standardet e BE-së dhe NATO-s.
- » Zhvillimi, krijimi dhe fuqizimi i shërbimeve të inteligjencës në interes të sigurisë, luftimit të terrorizmit, krimit të organizuar dhe korrupsionit.
- » Investimi në edukim dhe shkollim profesional në sektorët e sigurisë.
- » Inkuraimi i zhvillimit të hulumtimeve shkencore dhe zhvillimi e përdorimi i teknologjive të reja në fushën e sigurisë.
- » Zhvillimi dhe aftësimi i sektorit privatë të sigurisë.
- » Identifikimi i studentëve të zgjuar dhe të kualifikuar në sektorin e sigurisë duke filluar me punët praktike.

Rekomandime

- » Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe legjislacioni përkatës duhet të rishikohen për të reflektuar në Rekomandimet e Rishikimit Strategjik të Sektorit të Sigurisë.
- » Për të lehtësuar zbatimin e rekomandimeve të përfshira në RSSS, duhet të ofrohen profesionistët nga Këshilli i Sigurisë, dhe të gjithë së bashku të udhëheqin procesin e rishikimit të Strategjisë Kombëtare të Sigurisë aktuale dhe harton një Strategji të Re Kombëtare të Sigurisë dhe të jetë grupi punues për monitorim të zbatimit të kësaj strategjie.
- » Rishikimi dhe publikimi i Planit të Reagimit Kombëtar duhet të bëhet jo më vonë se viti kalendarik paraparak.
- » Të harton dokumentin e Strategjisë Kombëtare të Mbrojtjes, dokumenti do të përshkruaj se si Ministria e Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura të Kosovës do të mbështesin zbatimin e interesave kombëtare dhe objektivave të përcaktuara në Strategjinë Kombëtare të Sigurisë.
- » Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes të përshkruaj mjedisin e ardhshëm të sigurisë se si do të ndikonte në planifikimin e Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcat e Armatosura të Kosovës, për më tepër, duhet të qartësohet struktura organizative e Ministrisë, mënyrën se si vepron për zbatimin e mbikëqyrjes së Ministrit, menaxhimin, administrimin dhe drejtimin e politikave për forcën e ardhshme ushtarake.

Shprehjet

MFSK – Ministria për Forcën e Sigurisë së Kosovës; **FSK** – Forca e Sigurisë së Kosovës; **KFT** – Komanda e Forcave Tokësore; **BCU** – Bashkëpunimi Civilo – Ushtarak; **BXH** – Batalioni i Xhenios; **OJQ** – Organizata Joqeveritare ; **NALT** – Ekipi Këshillues dhe ndërlidhës i NATO-së; **LMT** – Ekipet ndërlidhëse të KFOR-it; **JRD** – Ekipet e Përbashkëta Reaguese të KFOR-it; **G9 KFT** – Departamenti për Bashkëpunim Civil – Ushtarak në Komandën e Forcave Tokësore; **UÇK** – Ushtria Çlirimtare e Kosovës; **TMK** – Trupat e Mbrojtjes së Kosovës, **AKRPNS** Agjencia e Kosovës për Mbrojtje nga Rrezatimi dhe Siguri Nukleare, **ANSP** – Ofruesi i Shërbimeve të Navigacionit Ajror, **AAC** – Autoritetit i Aviacionit Civil **AME** Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave, **SHME** – Shërbimet Mjekësore Emergjente, **BERZH** – Banka Evropian për rindërtim dhe Zhvillim, **EULEX** – Misioni i Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit **PSBE** Përfaqësuesi Special i Bashkimit Evropian, **NJIF** – Njësia për Inteligjencë Financiare, **GKNM** – Grupi Koordinues Ndërministror, **PCN** – Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar në Kosovë, **GDN** – Grupi Drejtues Ndërkombëtar

për Kosovën, **ZCN** – Zyra Civile Ndërkombëtare, **AKSP** – Akademia e Kosovës për Siguri Publike, **AKI** – Agjencia e Kosovës për Inteligjencë, **KSK** – Këshilli i Sigurisë së Kosovës, **MEF** – Ministria e Ekonomisë dhe Financave – tash Ministria e Financave PK Policia e Kosovës, **MASHT** – Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë **MMPH** – Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor **MPJ** – Ministria e Punëve të Jashtme **MPB** – Ministria e punëve të Brendshme **MF** – Ministria e Financave **MSH** – Ministria e Shëndetësisë **MI** Ministria e Infrastrukturës **MD** – Ministria e Drejtësisë **PfP** – Partneritetit për Paqe, **AKKVK** – Asociacioni i Kriminologëve Kriminalistëve dhe Viktimologëve të Kosovës.

Literatura

- » Ahtisaari, M., 2007, Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, http://www.unosek.org/docref/Comprehensive_proposal-english.pdf.
- » Bryden, A. & Hanggi, H., 2004, Reformimi dhe Rindërtimi i Sektorit të Sigurisë.
- » Dagand, S., 2008, Perspektivat për të Ardhmen e Kosovës: Roli i Reformës së Sektorit të Sigurisë, Rishikimi i Sigurisë Evropiane, ISIS Europë, 38.
- » DCAF & UNDP, 2008, Mbikëqyrja Publike e Sektorit të Sigurisë, Doracak për Organizata të Shoqërisë Civile.
- » J.Ahic, Sistemi i siguris Private, ligjerat e autorizuar, Universiteti AAB, Prishtinë.
- » Kai Aide K, Raporti për Kosovë, 2005.
- » N. Germann dhe Timo thy Edmunds (eds.) Drejt reformës së sektorit të sigurisë në Evropën e pasluftës së ftohtë: Korniza për vlerësim (DCAF / BICC), pp 161-174.
- » N.Korailic, D.Muharremi, Kriminalistika, FKKN, BiH.
- » N.Korajlic, D.Muharremi, Kriminalistika, Prishtinë.
- » R.Halili, Kriminologjia, Prishtinë.
- » V.Latifi, Politika e luftimit të kriminalitetit, Prishtinë.
- » R.Maslesa, Policia dhe shoqëria, Universiteti AAB, Prishtinë.
- » R.Maslesa, teorit e sistemit të sigurise, FKN, Sarajevo, BiH.
- » V.Latifi, Politka e luftimit të Kriminaliteti, Prishtinë.
- » V.Vula, M.Ademi, Krimi kompjuterik, Prishtinë.
- » Von Bredow, Wilfried dhe Germann, Wilhelm N. (2003). 'Vlerësimi i suksesit dhe dështimit: nevojat praktike dhe përgjigjet teorike.


Publikime dhe legjislacioni

- » ASKKVK, Asociacioni i Kriminologëve dhe Kriminalistëve të Kosovës.
- » Draft Ligji mbi Sigurinë Private, 2008.
- » EULEX, Raport i Programit, Korrik 2009, <http://www.eulex-kosovo.eu/en/front/>.
- » FRIDOM, Rishikimi Funkcional i Policisë së Kosovës, DFID Kosova.
- » Grupi Ndërkombëtar i Krizave, 2000, Çfarë ndodhi me UCK? Europe Report.
- » Grupi Ndërkombëtar i Krizave, 2005, Bashkimi i Ndarjes së Mitrovicës, Europe Report No. 165.
- » Grupi Ndërkombëtar i Krizave, Prill 2004, Kolapsi në Kosovë, ICG Europe Report No. 155.
- » Human Rights Watch, Dështimi i Parandalimit të Dhunës Kundër-Etnike në Kosovë, Vol 16, No. 6.
- » Intervistat me fokus grupe Intervistë me Abedin Hasani, Drejtor i "Besa Security".
- » Intervistë me Agim Musliu, "South East Europe Security".
- » Intervistë me Agron Isufi, Drejtor i "WDG" and udhëheqës i Asociacionit të Kompanive Private të Sigurisë, Interviste me Bahri Arifi, Drejtor i "Delta Security".
- » Intervistë me Grant Cambridge, Menaxher në "Henderson".
- » Intervistë me Heinz Schnaider, Shef i Sektorit të Zhvillimi të Sigurisë Publike.
- » ISSR, 2006, Rishikimi Ndërkombëtar i Sektorit të Sigurisë, UNDP dhe Qeveria e Kosovës.
- » Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara, Rezoluta 1244, 10 Qershor 1999.
- » KIPRED, Mapping out the current parliamentary oversight of the security sector in Kosovo, 2008.
- » Korniza Kushtetuese e Kosovës, UNMIK, Gazeta Zyrtare, 2001.
- » Kosova Press 2009, Draft Ligji mbi Kompanitë Private të Sigurisë në Kosovë, 2008.
- » Kushtetuta e Republikës së Kosovës.
- » Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Kuvendi i Kosovës, Gazeta Zyrtare, 15 Qershor 2008.
- » Ligji mbi Forcën e Sigurisë së Kosovës, Kuvendi i Kosovës, Gazeta Zyrtare, 15 Qershor 2008.
- » Ligji mbi Policinë e Kosovës, Kuvendi i Kosovës, Gazeta Zyrtare, 15 Qershor 2008.
- » Ligji për Policinë, Kuvendi i Kosovës, 2008.
- » Ligji për Shërbim në Forcën e Sigurisë së Kosovës, Kuvendi i Kosovës, 2008.

- » MOLA, Strategjia e Kosovës për Menaxhimin e Integruar të Kufijve, Prill 2009.
- » OSBE, Interviste me Nuredin Ibishi, ekspert i sigurisë.
- » Raportet dhe Revistat.
- » Rregullorja e UNMIK-ut 2000/33 mbi licensimin dhe rregullimin e kompanive, private të sigurisë, Rregullorja e UNMIK-ut 2001/7 për Autorizimin e Posedimit të Armëve.
- » Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese, Monitorimi i Gjykatave të Kosovës. Qershor 2009, Prishtinë.



PJESA E DYTË



**KËRCËNIME NGA
TERRORIZMI DHE
LUFTËTARËT E
HUAJ, KUNDRUALL
RISOCIALIZIMIT DHE
DERADIKALIZIMIT**

2.1. EKSTREMIZMI I DHUNSHËM SI MJET PËR KRYERJEN E TERRORIZMIT

Prof. Dr. Zllate Dimovski

*Fakulteti i Sigurisë - Shkup
zdimovski@fb.uklo.edu.mk*

Hyrje

Institucionet kompetente, në bashkëpunim me BFI-në, duhet të fillojnë me aktivitete për krijimin e një strategjie të veçantë dhe një plan për monitorimin e aktiviteteve nga pozicionet e radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm në internet, si dhe ndërmarrjen e masave kundërshtuese për çrrënjosjen e këtyre dukurive të dëmshme. Duhet krijuar dhe përditësuar vazhdimisht një listë të literaturës së ndaluar me shkrim dhe elektronikë (faqe interneti), si dhe të sigurohet teknologji adekuate dhe trajnime të nevojshme të personelit të punësuar në institucionet penitenciare për identifikimin e përdorimit të mjeteve të paligjshme për komunikime.

Në funksion të sigurimit të një trajtimi efikas, bashkëpunim më të mirë të brendshëm, detektim, menaxhim dhe çrrënjosje të aktiviteteve nga pozicione të ekstremizmit të dhunshëm, është e nevojshme të krijohet një sistem i organizuar dhe efikas për mbledhjen, analizimin dhe vlerësimin e njohurive brenda institucioneve penitenciare. Gjithashtu, është e nevojshme të krijohen dhe të përdoren skringing mjete dhe instrumente për vlerësimin e rrezikut të recidivizmit, veçanërisht në rastet e braktisjes të Institucioneve penitenciare gjatë shfrytëzimit të ditëve të lira, ose të disa lehtësive të tjera.

Personeli i burgjeve që punon me terroristët e dënuar - "luftëtarë të huaj", duhet të trajnohet në mënyrë adekuate për të zbatuar programin konkret për deradikalizimin, për të njohur, identifikuar dhe çrrënjosur aktivitetet nga pozita e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit.

Me qëllim të vendosjes të koordinimit dhe bashkëpunimit ndërministror efektiv, me detyrimet të rregulluara saktësisht, mënyrën dhe formën për informimin dhe veprimin e ndërsjellë, nevojiten ndryshime përkatëse në planin normativ.

Aktivitetet nga pozicione të ekstremizmit të dhunshëm, në të gjitha format, janë një realitet i shoqërisë bashkëkohore e cila do të ekzistojë edhe në të ardhmen. Procesi i deradikalizimit të "luftëtarëve të huaj" është shumë i vështirë, kurse sukcesi është i pasigurt. Disa ekstremistë kurrë nuk do t'i ndryshojnë qëndrimet e tyre radikale, madje as nuk do të heqin dorë nga dhuna, por kjo në asnjë rast nuk duhet të shpie drejt dekurajimit dhe refuzimit për të punuar me ta në kushte penale. Përkundrazi, shtetet, në kuadër të mundësive të tyre, kapaciteteve dhe fuqisë financiare, duhet të punojnë vazhdimisht në drejtim të përmirësimit të kushteve në institucionet penitenciare dhe gjetjen e zgjidhjeve të reja për rehabilitimin e suksesshëm të "luftëtarëve të huaj", me një qëllim parësor, çrrënjosjen e ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit.

2.3. TERRORIZMI SI KËRCËNIM GLOBAL I SIGURISË

Dr.Sc. Armin KRZHALIQ

*Fakulteti i Drejtësisë Penale, Kriminologji dhe
Studime të Sigurisë në Universitetin e Sarajevës
akrzalic@fkn.unsa.ba*

Dr.Sc. Nexhad KORAJLLIQ

*Fakulteti i Drejtësisë Penale, Kriminologji dhe
Studime të Sigurisë në Universitetin e Sarajevës
dean@fkn.unsa.ba*

Hyrje

Pritjet se globalizimi mund të zvogëlojë hendekun midis të pasurve dhe të varfërve është një premisë e gabuar dhe është e barabartë me shpresën se terrorizmi mund të zhduket në rendin e ri botëror. Prandaj, ne e shohim terrorizmin si një sfidë të madhe për sigurinë globale dhe si kërcënim global për sigurinë. Kur flasim për terrorizmin si një kërcënim global ndaj sigurisë, ne e shohim terrorizmin si një agjent, sepse terrorizmi nuk është as filozofi, as lëvizje. Këtij qëndrimi i bashkohet edhe Shikman, i cili e shikon terrorizmin si një kërcënim global për sigurinë e botës, duke patur parasysh se terrorizmi është një nga format më të rrezikshme të rrezikimit të sigurisë të shtetit, rajonit dhe bashkësisë ndërkombëtare si tërësi, dhe si i tillë paraqet një kërcënim bindës për sigurinë e shteteve të caktuara dhe një kërcënim global për sigurinë e bashkësisë ndërkombëtare.¹

Shikuar nga perspektiva të ndryshme që ne në vazhdim do t'i analizojmë, një akt konsiderohet njëkohësisht edhe terrorizëm dhe çlirim, kështu që ne zgjedhëm që mos ta definojmë terrorizmin. Në këtë punim do ta hulumtojmë historinë e terrorizmit, keqpërdorimin e terrorizmit nga ana e politikave të pandershme, kurse përmes analizave të autorëve botërorë do të spjegojmë se çfarë qëndron pas parullave: "Lufta Kundër Terrorizmit", "Uniteti i Kombit" dhe "Lufta e Drejtë". Ne nuk do t'i analizojmë dhe nënvizojmë të gjitha definicionet për termin e dhënë.

Kuptimi i fjalës “terror”

Fjala “terror” rrjedh nga gjuha latine dhe është baza, ose rrënja e fjalës “terrorizëm”. Megjithatë, ne e gjejmë origjinën e kësaj fjale në rrënjën indo-europiane “tras” që do të thotë dridhje e shkaktuar nga frika. Është e qartë se bëhet fjalë për përdorimin e planifikuar të dhunës apo kërcënimeve të dhunshme për përmbushjen e qëllimeve politike, fetare apo ideologjike. Sipas “Fjalorit të Fjalëve të Huaja” (Klajiq, 1985), “terrori” tregon në shkaktimin e frikës, tmerrit, përdorimit të dhunës fizike për shkatërrimin e armiqve, ndërsa termi “terrorizëm” nënkupton zbatimin e terrorit, sundimit me frikësime, tirani; shkatërrimin e armiqve me përdorimin e mjeteve më të egra (persekutim, eksploatim, vrasje etj.) Modli dhe Korajlliq e shohin terrorizmin si “një akt i frikësimit, dhunës orientuar drejt shikuesve, duke përfshirë edhe ato në jetën politike dhe mediatike”². Sipas tyre, terrorizmi modern është një rrezik për njerëzit e pafajshëm. Thënë thjeshtë, kuptimi konciz i fjalëve të përmendura sipas Abazoviqit është se “terrorizmi është krimi dhe vetëm krimi, terroristët janë kriminelë dhe vetëm kriminelë (ata nuk janë idealistë, as heronj, as luftëtarë të lirisë, as mbrojtës të interesave fetare ose kombëtare, .., as ...)” (Abazoviq, 2012).

Terrori si armë për shtypje dhe luftëra

Terrori si armë për shtypje dhe luftëra është përdorur gjatë gjithë historisë, duke filluar nga Platoni, Aristoteli dhe Ciceroni, i cili e ka festuar vrasjen e sundimtarëve të padrejtë, duke i thirrur Romakët e tjerë që t’i bashkohen në festimin. Romakët besonin se vrasja e sundimtarëve të padrejtë (vrasja e një tirani) është puna më e mirë, veçanërisht nëse vrasësi ishte i afërt me tiranin.³ Shumica e teoricienëve bashkëkohorë e lidhin termin “terror” (terreur, terror) me ngjarjet gjatë Revolucionit Francez (1789 - 1795) për të nxjerrë në pah gjendjen e frikës së përgjithshme të krijuar qëllimisht për qëllime politike. Njerëzit që janë angazhuar për revolucionin, pas realizimit të tij, u quajtën me krenari “terroristë të vërtetë” (vraishommes de terreur). Në këtë periudhë shfaqet termi “terrorizëm”, me të cilin janë shënuar aktivitetet e qeverisë së re. Ky term u transmetua edhe në pjesën tjetër të botës. Filozofi i njohur anglez i shekullit të tetëmbëdhjetë (XVIII), Edmund Burk, i emëron bartësit e Revolucionit Francez si terroristë. Në një kontekst të ngjashëm, terrorizmi i referohet formave të dhunës që qeveria franceze i ka kryer ndaj kundërshtarëve politikë, fisnikëve, familjeve të tyre dhe simpatizantëve, por, gjithashtu, edhe ndaj njerëzve të zakonshëm. Kjo tregon se terrorizmi ka marrë një dimension politik. Një tjetër konfirmim për paraqitjen e dimensionit politik të terrorizmit në periudhën e Revolucionit Francez mund të gjendet te Robespierre Maximilian, autor i Deklaratës për të Drejtat e Njeriut dhe një nga figurat më

të shquara të Revolucionit Francez, i cili, në përpjekje për të justifikuar terrorin revolucionar të Jacobinve, fuqishëm është udhëhequr nga motoja e tij se "Qveria në revolucion është despotizmi i lirisë kundër tiranisë. "Prandaj, në emër të lirisë, ai insiston në despotizmin e sundimtarëve, kurse despotizmi është vetëm një formë e terrorizmit shtetëror, ose terrorizmi i elitës ideologjike ose politike në pushtet, ose oligarkisë⁴.

Terrorizmi, si një formë e luftës, përdoret nga ana e grupeve të caktuara për të arritur qëllime që shpesh nuk janë të identifikueshme. Megjithatë, në shumicën e rasteve, pas aktit terrorist qëndrojnë çështjet politike. Mund të shohim se termi terrorizmi është i njohur gjerësisht dhe përfaqëson një fenomen historik. Si i tillë, ai nuk ka dimension, nuk ka kufij në kohën dhe hapësirën, mund të shfaqet kudo në çdo kohë dhe të përhapet në nivel lokal, rajonal ose global. Terrorizmi e arriti kulmin në mesin e shekullit të XIX në Europën Perëndimore dhe në Rusi. Manifestohet përmes sulmeve të dhunshme, nga atentatet (vrasjet) e personave të rangut të lartë deri në vendosjen e pajisjeve shpërthyesë. Besohet se vetëm në Rusi janë vrarë më shumë se 7,000 zyrtarë dhe trupa të sigurisë, duke përfshirë edhe perandorin⁵. Anarkistët u quajtën terroristë pa asnjë turp dhe haptazi i perceptuan taktikat e tyre si terrorizëm. Në vendin e dytë mund të përmendim vrasjen e arkidukës austro-hungarez Franz Ferdinand, një akt që e filloi ortekun e Luftës së Parë Botërore. Dominique Venner konsideron se ky akt është një largim nga ideja që monarkia duhet të restaurohet në perandori ku Sllovenët, Kroatët dhe Boshnjakët do të bashkohen në një komunitet autonom, ndërsa Serbët e kanë humbur të vetmin person që mundur ta ndalë konfliktin e armatosur midis Austrisë dhe Serbisë⁶.

Deri në fund të shekullit të XX-të, sulmet sistematike terroriste paraqiteshin si një mjet terrori, por në një masë të pakonfirmuar në epokën moderne. Sulmet terroriste sistematike u përdorën gjatë luftës në Bosne dhe Hercegovinë dhe kryesisht ishin drejtuar kundër civilëve. Përvoja e qytetarëve të Sarajevës, Bihaqit dhe Tuzllës tregon se ushtria e Republikës Srpska i ka ekspozuar sulmeve sistematike terroriste, të cilat në aspektin e pasojave ishin një lloj fushate e zgjatuar terroriste⁷. Në vend të bombave terroriste të famshme (si ato të përdorura nga IRA e atëhershme në Londër), shpërthimet u shkaktuan nga predha, kurse snajperët kryenin sulme individuale ndaj civilëve. Në anën psikologjike të këtyre veprave mund të gjejmë elemente të terrorizmit. Veprat e tilla veçanërisht u shprehën në zgjedhjen e vetëdijshme të fëmijëve si objektiva të snajperëve. Arsyeja për këtë nuk ishte se fëmijët do të kishin një rol në luftë, por, përkundrazi, vrasja e fëmijëve konsiderohej për një mënyrë efektive për përhapjen e frikës dhe zhgënjimit në mesin e popullatës. Me dhunën

terroriste janë arritur objektiva më të gjera ushtarake. Si rezultat i kësaj, deri në armëpushimin në fillimin e vitit 1994, një ose dy fëmijë janë vrarë për çdo ditë në Sarajevë nga ushtritë pushtuese (Ushtria e Republikës Srpska, çetnikët, mercenarët dhe vullnetarët). Vlerësimi është se 20-25% prej tyre kanë humbur jetën kryesisht prej snajperistëve. Verdikti final për Dragomir Millosheviqin, gjeneral i Ushtrisë së Republikës Srpska i miratuar nga ana e Tribunalit të Hagës flet për bllokadën katër vjeçare dhe për terrorizimin e Sarajevës. Gjenerali Millosheviq (68) është shpallur fajtor në nëntor të vitit 2009 në pesë pika të akuzës: terrorizim i popullatës së Sarajevës, vrasja e civilëve dhe akte të tjera çnjerëzore gjatë fushatës artilerike dhe snajperiste kundër civilëve në Sarajevë nga pozitat e korparmatës së Sarajevës dhe Romanisë të Ushtrisë së Republikës Srpska nën komandën e tij në periudhën e viteve 1994-1995. Gjithashtu, Tribunali i Hagës e shpalli fajtor Ratko Mlladiqin, komandantin ushtarak të Ushtrisë së Republikës Srpska, në tetë pika të akuzës: për terrorizimin e civilëve, për shkelje të rregullave ushtarake, për sulme ndaj civilëve dhe për marrjen e pengjeve si një shkelje e rregullave ushtarake.

Prandaj, parashtrohet pyetja nëse këto karakteristika të terrorizmit kanë ndryshuar gjatë viteve, si një formë e terrorit dhe nëse është i mundshëm një ndryshim në të ardhmen?

Panta Rhei - gjithçka rrjedhë nëse prisni mjaftueshëm

Terrorizmi nuk ka ndryshuar shumë gjatë shekullit të kaluar, dhe pothuajse në 25 vitet e fundit. Rrëmbimi i parë i një aeroplani u bë në vitin 1931, ndërsa terrorizmi e arriti kulminacionin me rrëmbimin e parë me qëllim zhvatje politike në vitin 1968. Auto-bomba u përdor së pari në vitin 1947 në Palestinë, ndërsa bomba e parë terroriste shpërtheu në vitin 1955. Pikërisht në atë kohë, në Europë u shfaqen grupet e para ultra të majta si Brigada e Kuqe, Fraksioni i Armatës së Kuqe, veprimet e të cilave kanë treguar se terrorizmi është një mjet në politikën e tyre, kurse qëllimi është - shkatërrimi dhe frikësimi i rendit kapitalist. Kjo periudhë përfundoi në fillimin e viteve 1980, kurse hapja e dokumenteve konfidenciale të disa agjencive të inteligjencës dhe kundërzbulimit tregoi se gjatë Luftës së Ftohtë, shumë organizata terroriste ishin nën kontrollin e sistemeve të sigurisë të blloqeve, me qëllim që të arrihen qëllime në llogari të palës tjetër.

Pas përfundimit të Luftës së Ftohtë dhe dobësimit të grupeve të përmendura, ishte e qartë se do të vjen deri në hapjen e një problemi të sigurisë. Izraeli bashkë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Francën si aleat, e sulmuan Libanin

duke shënuar kështu fillimin e luftës civile në Liban. Ishte e qartë se e ka zgjedhur anën e forcave krishtere që e krijuan dhe e intensifikuan mendimin se Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Perëndimi janë armiq të qytetërimit myslimanë. Natyrisht, një situatë e tillë nuk ishte e mjaftueshme, dhe ata vazhduan t'i rrisnin tensionet ndërmjet Indisë dhe Pakistanit në lidhje me Kashmirin dhe Jammun, me qëllim që të krijojnë rrethana të tilla në të cilat bota myslimane nuk është në konflikt vetëm me Perëndimin, por edhe me Hindusët dhe qytetërimin ortodoks. Këto ngjarje sikurse i lanë anash sulmet terroriste të grupeve raciste të djathta në Austri, Gjermani, Suedi dhe vende të tjera, kundër qytetarëve myslimanë, si dhe sulmet nëpër rrugë të bandave në Marsej, Berlin, Oslo dhe Stokholm⁸.

Duke analizuar historinë fetare të sulmeve terroriste në të kaluarën e largët (shumë kohë para Islamit, i cili shpesh shënohet si një nga nxitësit kryesorë të sulmeve të tilla), mësuam se aktivitetet më të hershme terroriste u kryen nga Sikharet (greqisht-sikarioi, "njerëz me thika", si një grup ekstrem i zellotëve hebrej⁹. Ky grup hebrej zhvillonte një fushatë të hapur kundër sundimit romak në Palestinë, kundër të gjithë hebrejve që kanë bashkëpunuar me qeverinë romake dhe kundër Mongolëve. Në Masada, gjatë vitit 73, ata bënë vetëvrasje në vend që t'i dorëzohen ushtrisë romake¹⁰. Në Indi, në shekullin e VII-të, ekzistonte një kult religjioz që përhapte terrorin me vrasje rituale të njerëzve dhe i sakrifikoje për nder të Hindu perëndeshës së frikës, Kali. Rebelët, vrasësit, Hashashini (arabisht-hashshashun, "përdorues të hashashit", "vrasës") ishte një sekt që vepronte nga viti 1090 deri në vitin 1256. Misioni i tyre ishte përmes terrorizmit të përhapin frikën mes armiqve dhe t'i vrasin figurat e tyre kryesore politike. Në të shumtën e rasteve ata janë futur në linjat e armikut dhe kanë pësuar veten gjatë misionit, për çka ishin përgatitur paraprakisht. Një grup me të njëjtin emër filloi të përhapet nga kështjella Alamut, "fole shqiponje" në veri të Persisë, në afërsi të Detit Kaspik, dhe gjeti mbështetjen e parë midis fiseve malore pa ndikim politik. Këta vrasës e kanë themeluar perandorinë e tyre në ideologjinë e Ismailizmit, një grup që u largua nga misioni universal i Islamit dhe mësimet autentik të fesë islame. Midis viktimave ishin myslimanë të rangut të lartë, krishterë, hebrej dhe të tjerë (Veziri i Selxhukut Nizam al-Mulk, kryqtarë, Konradi nga Monferrati - Mbreti i Jerusalemit, ndërsa Salahuddini, një gjeneral islamik, arriti që të mbijetoj)¹¹. Perandoria Hashashin u shkatërrua gjatë pushtimit mongol, por grupi mbijetoi deri më sot. Ata arritën të rivendosin një sistem të qeverisjes dhe e gjetën vendin e tyre në Persi (Siri dhe Iran) dhe me aftësinë e tyre për të bindur, në Indi mes Kogjitëve.

Qysh para Luftës së Dytë Botërore, Izraeli përdorte me sukses taktikat e terrorit për të fituar pavarësinë në kryengritjen palestineze kundër sundimit britanik.

Trazirat i kanë udhëhequr organizatat terroriste hebraike Irgun dhe Stern Gang. Këto organizata gjatë luftës ishin ende aktive dhe u përpoqën që të mos veçohen në aktivitetet e tyre, por gjatë vitit 1944 ndodhën tre shpërthime të njëkohshme, kurse dy vjet më vonë ishte minuar edhe hoteli "Mbreti David", ku ishte vendosur zyra qendrore britanike¹². Veprimet e tilla shkaktuan solidaritetet me grupet që luftuan për liri dhe morën mbështetje dhe ndihmë nga aleatë të fuqishëm. Gjatë vitit 1948, ky proces e çoi në fund sundimit britanik në Palestinë, por hapi bërthamën vullkanike, përkatësisht themelimin e Izraelit. Sulme terroriste të ngjashme i inkurajuan grupet e tjera që të përdorin metoda të ngjashme në të ardhmen. Izraeli modern nuk pushoi me përdorimin e metodave të njejta, madje edhe nga pozita e një shteti (terrorizmi përmes hakmarrjes, agresionit dhe terrorit midis palestinezëve). Gjatë muajit shkurt të vitit 1994, ekstremisti hebre, Brooke Goldstein, ndjekësi i rabinit Kahane, masakroi 29 njerëz në një xhami të mbushur me njerëz në Hebron, kurse një vit më vonë, kryeministri Yitzhak Rabin u vra nga një ekstremist hebre që pretendonte se e realizon urdhërin e Perëndisë. Izraeli, pa dyshim, është një nga liderët në terrorizmin shtetëror. Një situatë e tillë rezultoi me sulme terroriste palestineze ndaj popullatës izraelite, pothuajse çdo ditë, sepse e konsiderojnë Izraelin për armikun e tyre, e jo vetëm një numër i caktuar prej tyre¹³.

Kur flasim për religjionin në Lindjen e Afërt, nevojitet të përmendet edhe kjo, se përveç Izraelit, edhe ndjenja politike arabe është formësuar nga kolonizimi francez dhe britanik, dhe dështimi arab për të parandaluar formimin e Izraelit si shtet. Qëndrimi i Izraelit ndaj palestinezëve, në kohët e mëvonshme, si dhe ndihma e drejtpërdrejtë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, do të ndihmojnë për shfaqjen e Xhihadit arab, i cili më vonë do të bëhet al-Kaeda.

Xhihadi arab luftoi kundër pushtuesve të huaj dhe forcave komuniste në atdheun e tyre dhe e përhap xhihadin prapa në shtëpitë e tyre. Megjithatë, kjo qasje do të ndryshojë pas 23 shkurtit të vitit 1998, pas formimit të Frontit Islamik Botëror, kur Osama bin Laden shpalli luftë kundër Hebrenjve dhe Kryqtarëve. Me këtë veprim, prioritetet u zhvendosën nga "armiku i afërt" tek "armiku i largët". Menjëherë pas këtyre udhëzimeve, objektivat e al-Kaedës u zhvendosën jashtë territorit mysliman. Kështu, më 7 Gusht 1998, bombardimi i dyfishtë i ambasadave amerikane në Nairobi dhe Dar es Salaam shënoi një moment të ri në operacionet e Al-Kaedës. Kjo do të thotë se operacionet defanzive të vendeve myslimane u kthyen në sulme ndaj tokës jomuslimane.

Edhe përkundër asaj që u tha paraprakisht, do të ishte absurde të vendoset një shenjë barazie midis besimit islam dhe terrorizmit të grupeve ekstremiste që

veprojnë në emër të “xihadit arab”. Ne e emërtoam “xihadin arab” me vetëdije, sepse ajo që e bëjnë anëtarët e tij në operacionet e tyre (vrasje e njerëzve të pafajshëm, prishje e paqes në Tokë), krimet e tilla dhe kriminelët nuk e kanë vendin në Islam. Ky është një koncept barbar dhe injorant. Islami ka një mision universal që pasqyrohet në çlirimin e të gjithë njerëzve që të mos i shërbejnë askujt veç Zotit. Me fjalë të tjera, misioni i popullit është që t’u jap fund të gjitha padrejtësive në Tokë me synimin drejt Perëndisë. Kjo përfshinte dhe përfshinë braktisjen e sistemeve politike të dhunshme që i pengojnë njerëzit të zgjedhin besimin e tyre. Islami nuk mund dhe nuk duhet të imponohet, por kjo nuk do të thotë se myslimanët duhet t’i tolerojnë forcat politike dhe materiale që e mohojnë lirinë e njeriut dhe të myslimanëve dhe qytetarëve të tjerë. Islami nuk është trashëgimi e një race apo vendi të caktuar; kjo është feja e Perëndisë dhe është e destinuar për të gjithë botën. Xihadi, i promovuar nga Islami (Xihadi i Madh), është një aspiratë jo e dhunshme për të jetuar një mënyrë jetese normale myslimane, në përputhje me vullnetin dhe jetën e Perëndisë që përfshinë pesë shtyllat e Islamit.¹⁴

Kjo e fundit e përmendur po manifestohet në Shtetet e Bashkuara të Amerikës , ku mediat me ngut konkluduan se pas bombardimeve në Oklahoma qëndron një grup islamik. Situata nuk është më e mirë as në Europë. Raportimi i tillë i njëanshëm siguron një hapësirë të shkëlqyeshme mediatike, edhe pse në shumë raste ato nuk janë as të vërtetuara as të sakta. Këto raporte mund të karakterizohen me deklaratën “nëse diku ndodhë një shpërthim ose bombardim në secilën kohë, prapa tyre qëndrojnë islamistët ose terroristët islamikë”. Një qëndrim i tillë është i dyfytshëm dhe nuk ndihmon në zgjidhjen e çështjeve që lidhen me sulmet terroriste.

Megjithatë, jo të gjithë kanë një qëndrim të tillë. Shumë studiues dhe shkencëtarë në botë kanë tendencë për të hequr prefiksën fetar tek terrorizmi. Në bashkohemi këtij grup, dhe me këtë punim dëshirojmë të japim kontributin tonë në këtë hipotezë.

Dy autorë kryesorë në botë, Lloyd Petford dhe David Harding, në librin “Terrorizmi - Lufta e Re Botërore”, përpiqen, dhe sipas mendimit tonë me sukses, ta heqin prefiksën “islamik” nga fjala terrorizëm. Ata konsiderojnë se nuk ka vend për një kualifikim të tillë pranë fjalës terrorizëm. Ata nuk kundërshtojnë se Islami, përmes keqpërdorimit, përdoret si lëndë djegëse për rekrutimin e sulmuesve me bomba - vetëvrasës në territoret e okupuara palestineze, por, në të njëjtën kohë, ata pretendojnë se grupet terroriste hebre shpesh “ushqehen” nga doktrinat e

judaizmit.¹⁵ Një spektër i mësimëve të së majtës, doktrinës krishtere, të së djathtës dhe radhëve të majta në Amerikën Latine, “mori pjesë” në krijimin e profileve të ndryshme ideologjike të terrorizmit, veçanërisht gjatë shekullit të XX-të. Prandaj, sipas autorëve, çdo theksim i komponentit islamik në terrorizëm nuk është i drejtë.

Fakti se terrorizmi, veçanërisht gjatë dekadave të fundit, më shpesh ndodhë në vende ku myslimanët janë shumicë, ose se autorët e akteve terroriste janë kryesisht myslimanë, tregon më shumë për kushtet e vështira në atë pjesë të botës, tregon më shumë për lirinë pothuajse inekzistente të zgjedhjes, dhe për ndjenjën e thellë të padrejtësisë tek popullata që ndjehet e tradhtuar nga regjimet në vendet e tyre, por, gjithashtu, edhe nga pjesa e botës që dëshiron të quhet e lirë apo demokratike, duke pasur parasysh në mendje kryesisht Shtetet e Bashkura të Amerikës.

Noam Chomsky, një nga kundërshtarët e politikës së jashtme të SHBA-ve, e theksoi politikën e pandershme të qeverisë amerikane ndaj Amerikës Qendrore dhe argumentoi se Shtetet e Bashkuara të Amerikës po udhëheqin në shkeljet e të drejtave të njeriut dhe nxitjen e terrorizmit në botë. Në librin e tij të shkruar gjatë Luftës së Ftohtë, “Kultura e Terrorizmit”, 1988, Chomsky argumenton se “administrata e presidentit Regan ka zhvilluar një rrjet kompleks ndërkombëtar terrorist, pa precedent në histori, aq sa di, dhe e ka përdorur atë për qëllime të ndryshme.”

Lloyd Petford dhe David Harding konsiderojnë se është e nevojshme që të shmanget polarizimi “ne” dhe “ata”. Te terrorizmi nuk ka “vetëm djem të mirë” dhe “vetëm djem të këqinjë”. Kur bëhet fjalë për terrorizëm, arsyet nuk mund të gjenden vetëm në të keqen, as zgjidhja nuk është vetëm në të mirën. ***“Arsyet janë në të keqen e shumëfishtë të politikës botërore. Ndërsa këto çështje nuk i zgjidhin ata që kanë fuqinë, përderisa nuk ka më vepra të mira, terrorizmi do të jetë besimi ynë.”***¹⁶

Nëse e krahasojmë librin “Terrorizmi - Lufta e Re Botërore” me veprën e Noam Chomsky “Piratët dhe perandorët, e vjetër dhe të rinj”, ku Chomsky, përmes deklaratave në lidhje me terrorizmin, tërësisht e kritikon politikën e jashtme amerikane (kurse këtë e bën për shumë vite) nga njëra anë, dhe me esenë e shkurtër të Samuel Huntington, “Epoka e Luftërave Myslimane”, mund të shohim se Lloyd Petford dhe David Harding, përipiqen të vendosen diku midis dy autorëve të përmendur. Gjithsesi, mendimet e tyre janë më të afërta me mendimet e Chomsky-t, sfondi i tyre majtist vjen në shprehje, por jo edhe në mënyrën në të cilën Chomsky e bën atë, veçanërisht jo me kritika të plota, të fokusuar tërësisht në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ndryshe

nga Huntington, ky duet nuk e thekson fajin mbizotërues mysliman në historinë, por i kushtojnë vetëm një pjesë të vogël të deklaratave në lidhje me terrorizmin. Pikërisht këtu dallojnë nga Chomsky, i cili në të gjithë “amerikanizmin” e tij flirton me paragjykimet ndaj myslimanëve dhe botës myslimane. Opinione e dy autorëve janë më afër profesorit Howard Zin, nga Universiteti në Boston, i cili e shkroi librin e famshëm “Historia popullore e SHBA-ve.”

Në librin e tij “Terrorizmi dhe Lufta”, profesori Zin, përmes hulumtimit të çështjeve bashkëkohore politike dhe shoqërore të botës bashkëkohore: globalizimit, militarizimit, demokracisë dhe të drejtave civile, përpiket, si Petitford dhe Harding, të sqarojë çfarë fshihet prapa parullave: “Lufta kundër terrorizmit”; “Uniteti i Kombit” dhe “Lufta e Drejtë”.

Kur e përmendëm Huntingtonin, është e nevojshme të kuptohet se si ai sheh në terrorizmin dhe nëse terrorizmi ka një vend në analizën e tij. Në punimin e tij “Konfliktet e Qytetërimeve” ai beson se: “Konfliktet e drejtpërdrejta midis shteteve të mëdha mund të zhvillojnë një nivel kolosal të dhunës, kurse e njëjta gjë mund të ndodhë edhe me konfliktet për ndarje ku vendet e mëdha të qytetërimeve të ndryshme u ndihmojnë aleatëve të tyre më të vegjël që ta formojnë të njëjtin qytetërim.¹⁷ Opinioni i tillë konfirmon se ndryshimet në terrorizëm mund të ndodhin pothuajse në të njëjtën kohë ose njëherit me çfarëdo forme tjetër të konflikteve të dhunshme politike kudo në botë.

Përveç autorëve të përmendur, ekzistojnë edhe autorë të cilit i mbështesin pikëpamjet se aktet terroriste janë të lidhura me lëvizjet shoqërore dhe politike. Ata konsiderojnë se terrorizmi është produkt i lëvizjeve të tilla, e jo iniciator i lëvizjeve shoqërore dhe politike. Në veçanti, veprimet e tilla terroriste janë treguesi i fundit për ndryshime politike.¹⁸

Përfundim

Me shqyrtimin e implikimeve të sigurisë të këtij realiteti të ri, është e nevojshme në të ardhmen të zhvillohen ligje ndërkombëtare, në kuptimin e përcaktimit të rregullave dhe standardeve të reja në luftën kundër dhunës dhe terrorizmit të motivuar politikisht. Kuptohet, nuk duhet të harrojmë faktin se këto përpjekje do të janë nën ndikimin e globalizimit dhe do të qaset drejt përdorimit të mjeteve të detyrimit. Fakt është se globalizimi praktikisht e ndryshoi terrorizmin në bashkësinë ndërkombëtare dhe do të jetë e vështirë të arrihen rregulla të thjeshta dhe unike.

Shikuar nga perspektiva globale, menaxhimi me përgjigjet shtetërore ose ndërshtetërore në lidhje me terrorizmin nuk mund të përqëndrohet vetëm në “rendin”, sepse dhuna politike është një pasojë e padëshiruar, ndoshta edhe kronike e grupeve të ndryshme të interesit. Burimet e tilla të konflikteve duhet të ngushtohen në një kornizë e cila mundëson dialog.

Ky mendim për terrorizmin, si dhe mendimet e autorëve të lartpërmendur, dhe krahu i majtë i rëndësishëm dhe, nganjëherë, qëndrimi amerikan kur flasin për shkaqet e terrorizmit, mund të jetë diçka me çka të tjerët nuk pajtohen. A i justifikon qëllimi mjetet? A është rreziku i vërtetë? Dhe a ka rrezik të mjaftueshëm real që të justifikohet shpenzimi i 10 miliardë dollarëve që mund të përdoren diku tjetër? Ka shumë arsye për vuajtje, torturë dhe vdekje, të cilat me siguri mund të reduktohen duke investuar në parandalimin dhe zgjidhjen e tyre. Ti marrim si shembull aksidentet e trafikut (42,420 të vdekur në Shtetet e Bashkuara të Amerikës gjatë vitit 1997), sëmundjet (725,790 njerëz vdiqën si rezultat i sëmundjeve të zemrës në vitin 1997 në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe 537,390 njerëz që vdiqën nga kanceri), madje edhe viktima të vrasjeve “të zakonshme” (15,551 persona kanë vdekur në Shtetet e Bashkuara të Amerikës gjatë vitit 1995¹⁹). Bazuar në këto fakte, besojmë se investimi në një nga fushat e lartpërmendura do të shpëtojë shumë më tepër jetë sesa investimi në parandalimin e një rreziku hipotetik nga terrorizmi. Megjithatë, duhet të mirret parasysh edhe ajo se vetë autorët, opinionet e të cilëve i kemi analizuar paraprakisht, e lënë mundësinë se ndoshta kanë gabuar në vlerësime të caktuara dhe se kanë qenë shumë të rreptë ndaj një fenomeni të caktuar në pjesën e botës që ne e quajmë demokratik.

Prandaj, kypunim i kushtuar terrorizmit definitivisht ka për qëllim t’u bëjë të mendoni. Fjalët e Profesorit Howard Zin, të shprehura pas 11 Shtatorit 2001, mund të jenë një ndihmë e madhe: ***“Të përpiqemi që ta sqarojmë dhe ta kuptojmë terrorizmin nuk do të thotë të kërkojmë justifikimin për ekzistimin e tij. Megjithatë, nëse asnjëherë nuk përpiqeni të sqaroni diçka, asgjë nuk do të kuptoni”***.

Fusnotat


1. Shikman, M. 2006. *Terrorizmi □ format aktuale dhe të mundshme*, Banja Llukë: Shkolla e lartë e punëve të brendshme.
2. Dusko Modlli dhe Nexhad Korajlliq, 2002. *Fjalori kriminal*. Teshanj: Qendra për Kulturë dhe Arsim.
3. Romans appreciated the courage of Brutus in that way, which saved them from the arbitrariness of Julius Caesar.

4. The revolutionary court imposed 1380 death sentences during the first 50 days of its activity, and it is believed that during the terror period, which was short-lived (almost two years), about 40.000 people were killed and about 300.000 were imprisoned (France, according to assessments, had about 27 million citizens at that time) – the terror mostly reflected on the citizens and peasants, nobles and priests who were punished amounted to 8.5% and 6.5% - Shiko: Dimitrijeviq, V.: *Terrori*, Beograd: Dosje 1997. fq.117.
5. Vladimir Aniq dhe Ivo Goldstein, 2000. *Fjalori i fjalëve të huaja*. Zagreb: Novi Liber, fq.1473.
6. The anarchists assassinated the emperor Alexander II in 1881, what lead to the dissolution of the organisation "NarodnayaVolya".
7. Dominique Venner, 2005. *Historia e terrorizmit*. Zagreb: Alfa. fq. 34.
8. Max. Taylor i John Horgan, 2003. *Terrorizmi në ardhmëri*. Zagreb: Golden marketing. fq.89.
9. Muamer Spahiq, 2014. „Rrethimi i Sarajevës 1992-1996“. Zenica: Vrijeme.
10. Tore Bjorgo: *Racist and Right – Wing Violence in Scandinavia* (Oslo: Tano Aschenhong 1997.).
11. This religious sect acted in Rome during 44 B.C.
12. See: Walter Laqueur: *Terrorism* (London: Weidenfeld& Nicolson, 1977.).
13. Paul Wilkinson, 2002. *Terrorizmi kundër demokracisë*, Zagreb: Golden marketing, fq. 77.
14. Isma'ilists – a sect which is considered to belong to the Shia, a branch in Islam- Such classification, however, can be wrong. Its unique feature is rather a metaphysics of Isma'ilism. The group is a manifestation in the Islam of the Persian religious system. Islam gives them their robe, form and vocabulary, but the central idea of Isma'ilism is ancient. It is an Islamic parallel to Gnosticism (an alternative dualistic form of Christianity), and it is connected to the Hellenistic Pagan Gnosticism and Manichaeism. A further parallel to the appearance of Isma'ilism in Islam is the appearance of Manichaeism between the religions in China as a result of the influence transferred by Turks from Central Asia. This developed Ming Chiao (the religion of conscience) which are dualistic forms of Buddhism (the Buddha of Light) and Taoism. What Isma'ilists refer to as Allah (what is the name of God for Muslims), is nothing else but a first emanation or hypostasis. More about the Assassins on :Cyril Glasse, *Enciklopedija Islama*, AltaMira Press, Walnut Creek, CA, USA, 2002. (Përkthimi në boshnjakisht, Sarajevë: Libris, 2006. fq. 271-279.
15. Ibid (x). 54-57.
16. Taken from: Denis Rizhviq: *Terrorizmi*, saw www.novihorizonti.com.

17. Ibid (v). fq.62.
18. Such relationship resulted in the establishment and foundation of two different groups: "Al Jihad Islamiyah" which is often called Egyptian Islamic Jihad – EIJ and JemmahIslamiyah or the Egyptian Islamic Group – EIG. Marc Sageman: Understanding Terror Networks, University of Pennsylvania Press 2004. p.36.
19. Ignorance and the state of barbarism that prevailed on the Arab peninsula before Islam.
20. The five pillars of Islam are: belief that there is no God other than Allah, and that Muhammed is his prophet; Regular prayers – five times per day; to help the poor; fast during the month of Ramadan (the ninth month in the Islamic calendar) and Hajj – every Muslim, if able, should at least one go to Mecca during the time of the Hajj
21. Vidi: Lloyd Pettifrod i David Harding: Terrorism – new world war Arcturus Publishing Limited , London, 2003.
22. Ibid (xvii).
23. Samuel Huntington: „The Clash of Civilizations?“, Foreign Affairs, 1993., p.217-218.
24. Sidney Tarrow: Pover in Movement, New York –Cambridge University Press, 1994., p. 110–112.
25. As a solution for security threats towards the UNSA, the Clinton administration that 28% of the 10 billion Dollars from the budget intended for the fight against terrorism, during 1999-2000, is to be directed towards the fight against chemical, biological and information terrorism... See: Max. Taylor i John Horgan: Terorizam u budućnosti, Golden marketing, Zagreb 2003., str.138.
26. The New York Times World Almanac and Book of Facts, 1999., p. 876.
27. Ibid (xxii).
28. Ibid (xxii) p.880.



PJESA E TRETË



**DILEMA E SIGURISË:
NDRYSHIME TË KUFIVE
PËR KRIJIMIN E SHTETEVE
ETNIKISHT TË "PASTRA"
OSE MENAXHIMI ME TË
DREJTAT E PAKICAVE**

3.1. DILEMA E SIGURISË: NDRYSHIMI I KUFIVE PËR ARRITJEN E SHTETEVE ETNIKE “TË PASTRA” OSE MENAXHIMI ME TË DREJTAT E PAKICAVE

Prof. Dr. Zhidas Daskalovski

*Fakulteti i sigurisë – Shkup
daskalovski@outlook.com*

Hyrje

Zgjerimi i Bashkimit Europian (BE) është nën kërcënim. Midis shteteve-anëtare të Bashkimit Europian ekziston entuziazëm i vogël në lidhje me zgjerimin e mëtejshëm të Unionit. Ngadalësimi i procesit të integritetit të Ballkanit Perëndimor në BE u pasua me një ngadalësim të investimeve të vendeve-anëtare të BE-së në rajon. Shtetet europiane po përballen me probleme të ndryshme. Qytetarët në të gjithë kontinentin ndjehen më pak të lidhur me institucionet transnacionale europiane dhe proceset e globalizimit. Përparimi ekonomik stagnon, kurse udhëheqësit popullit i eksploatojnë ndjenjat anti-elitiste. Liderët e Ballkanit i imitojnë dhe i përmirësojnë strategjitë populiste. Fuqitë e reja rajonale, si Turqia, Rusia dhe Kina, kërcënohen se do ta shfrytëzojnë qorrsohakun në procesin e zgjerimit të BE-së.

Interesi i BE-së është që të nxitet një rajon i sigurtë dhe i avancuar. Një nga shqetësimet kryesore të Brukselit është raporti midis Beogradit dhe Prishtinës. Normalizimi i marrëdhënieve mes Serbisë dhe Kosovës do të ndihmonte procesin e europizimit. Në dialogun midis dy qeverive, me ndërmjetësimin e BE-së, para pak kohësh është dhënë një propozim për ndryshimin e kufive që të arrihet një shtet etnikisht (më) “i pastër” kosovar dhe serb. Kjo ide në parim është në kundërshtim me konceptin e vendosjes së të drejtave të pakicave dhe të përshtatjes të dallimeve përmes aranzhimeve të ndryshme politike, siç janë: konsensusi, federalizmi apo qasja integruese e Donald Horowitz. Ky punim e diskuton idenë për ndryshimin e kufive midis Kosovës dhe Serbisë dhe pohon se është një propozim negativ dhe i rrezikshëm për rajonin, duke e mbështetur qëndrimin për zbatimin konsistent dhe të përmirësuar i të drejtave të pakicave. Edhe Maqedonia edhe Kosova duhet të vazhdojnë me zbatimin e politikave kombëtare të drejtave etnike për forcimin e të drejtave minoritare.

Marrëdhëniet ndërmjet Serbisë dhe Kosovës

Serbia po përpiqet të mbajë politikën e saj për Kosovën të ndarë nga aspiratat për aderimin e saj në BE. Megjithatë, BE bëri të qartë se përparimi i Serbisë drejt aderimit varet nga përmirësimi i marrëdhënieve me Kosovën. Megjithatë, njohja e pavarësisë së Kosovës mund të dëshmohej si një pengesë e pakapërcyeshme. Përkundër ndryshimit të qeverive në Serbi, politika dhe diskursi për Kosovën mbeten të njëjta. Duket se asnjë qeveri në Beograd nuk është e gatshme në të ardhmen e afërt të njohë pavarësinë e Kosovës. Ekziston rreziku që Serbia të braktisë procesin e aderimit. Nëse pat pozita vazhdon, ekziston rreziku që besueshmëria e procesit të zgjerimit të sfidohej. Ekziston rreziku që procesi i zgjerimit të mbetet nën pikëpyetje, për derisa "shtetet-anëtare vazhdojnë ta bëjnë procesin e pranimit peng të ankesave dypalëshe, me çka minohet elementi i drejtësisë në parimin e kushtëzimit". (Fuere, 2014: 8) Për këto arsye, diplomacia e BE-së është shumë aktive në përmirësimin e marrëdhënieve mes Serbisë dhe Kosovës. BE arriti përparim, përmes përpjekjeve diplomatike, në ndërmjetësimin për normalizimin e marrëdhënieve midis Beogradit dhe Prishtinës, duke përfshirë edhe nënshkrimin e Marrëveshjes së Brukselit në Prill, 2013. Prej atëherë është bërë një përparim i vogël. Presidenti Aleksandar Vuçiq u përpoq më 2018 që të ofroj një mundësi të re për një marrëveshje përfundimtare ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës, e cila do të hapë rrugën për aderimin e Serbisë në BE.

Nuk ka tregues të qartë se saktësisht cilat fusha do të mbulohen me ndryshimet e kufijve dhe cilat linja të shënimit do t'i ndjekin kufitë e rinj. Ende nuk është e qartë se si do të shënohen kufijtë, kush do të vendosë për demarkacionin dhe nëse do të ftohet ndonjë organ ose ekspert ndërkombëtarë të marrin pjesë në këtë projekt për demarkacionin. Supozimi është se marrëveshja që e propozuan Vuçiqi dhe presidenti Hashim Thaçi, do t'i "japin" Serbisë të gjithë territorin ose një pjesë të Veriut të Kosovës, në këmbim për të gjitha ose një pjesë të territoreve tjera me pakicën shqiptare në Serbi që kufizohen me Kosovën në Luginën e Preshevës. Shkëmbimi i supozuar i Kosovës sillet rreth tri komunave në jug të Serbisë (Preshevë, Bujanoc dhe Medvexhë) me popullatë të konsiderueshme shqiptare dhe tri ose katër komunat në veri të Kosovës në afërsi të drejtpërdrejt të Serbisë (Lipjan, Albanik (Leposaviq), Zubin Potok dhe pjesë të Mitrovicës). Paralelisht, Serbia do të pranojë pavarësinë e Kosovës dhe do të hapë rrugën për njohje të plotë ndërkombëtare.

Të dy vendet synojnë drejtë anëtarësimin në BE, por me siguri asnjëra nuk do të aderojë nëse Serbia dhe Kosova nuk i normalizojnë marrëdhëniet e tyre. BE-ja

mund të pranojë vetëm një shtet që është njohur nga të gjitha vendet-anëtare; kurse Kosova nuk është njohur nga pesë vende-anëtare të BE-së: Sllovakia, Greqia, Qipro, Rumania dhe Spanja, para se gjithash sepse Serbia nuk e njeh atë. Nëse Serbia e njeh Kosovën, këto pesë shtete, me siguri, do ta ndjekin shembullin. Negociatat po zhvillohen me ndërmjetësimin e përfaqësuesit të Lartë të BE-së për Punë të Jashtme, zonja Federica Mogherini. Ky shkëmbim i territoreve do të rezultojë me më pak serbë që jetojnë në Kosovë dhe me më pak shqiptarë në Serbi. Të dy vendet do të bëhen "etnikisht më të pastra".

Reagimi i bashkësisë ndërkombëtare është i përzier. Nga njëra anë, John Bolton, Këshilltar për Siguri Kombëtare të SHBA-ve, komentoi në Gusht më 2018 se "ne nuk i përjashtojmë adaptimet territoriale ... mendojmë se ata duhet vetë ta zgjidhin atë". Nga ana tjetër, duke folur për bisedimet për shkëmbime territoriale midis Serbisë dhe Kosovës, Angela Merkel tha se: "Integriteti territorial i vendeve të Ballkanit Perëndimor është i vendosur dhe i pacënueshëm". Në mënyrë të ngjashme, Michael Roth, Ministri Gjerman i Shtetit për Europën, paralajmëroi se hapet kutia e Pandorës, ndërsa Sabine Stoere, Shef i Departamentit për Ballkanin Perëndimor në Ministrinë e Jashtme Federale në Berlin, në "Forumin e Sigurisë në Beograd, 2018 ", deklaroi se: "Ne jemi me të vërtetë dhe seriozisht të shqetësuar për atë se si është futur në kornizë objektimi i dialogut, se ky territor është zgjidhja e vetme për diçka, ne nuk besojmë se kjo do të çojë në një zgjidhje të qëndrueshme. Fokusimi mbi territorin do ta çojë dialogun në një qorrsoak."

Disa komentatorë politikë dhe figura ndërkombëtare e mbështesin shkëmbimin potencial territorial. Charles Kupchan, ish- Këshilltar i Presidentit Barack Obama, kurse tani Profesor në Universitetin Georgetown, e përshkroi pilot planin si "pastrim etnik paqësor." Duke mbështetur idenë për shkëmbimin e tokës, ai beson se "Pragmatizmi duhet ta mbisundoj parimin". (New York Times 2018) Duke komentuar për "Politiko", Marko Prelec, Profesor në Universitetin e Europës Qendrore, deklaroi se: "Nuk ka zgjidhje për misterin e Kosovës pa një marrëveshje që të dyja palët vërtetë do ta mbështesin, kurse shkëmbimi tokësor është çelësi për një marrëveshje të tillë". (Politico 2018) Wolfgang Petriç, Kryenegociatori i BE-së në bisedimet paqësore të Kosovës, gjithashtu, e mbështeti idenë për shkëmbimin territorial serbo-kosovar. (N1 2018) Bordi editorial i "Financial Times" mbështeti me kujdes marrëveshjen e propozuar, duke argumentuar se: " Prej se do të vendoset lëvizja e të dy vendeve drejt anëtarësimit në BE, do t'i forcojë reformat demokratike dhe ekonomike dhe do të dërgojë një sinjal më të gjerë se integrimi i Ballkanit në institucionet euroatlantike, sado që është i ngadalshëm, vazhdon"(2018).

Nga ana tjetër, kishte shumë zëra me influencë kundër ndryshimit të propozuar të kufijve. Edward Joseph në Politikën e Jashtme komentoi se: «Nuk mund të ketë marrëveshje për shkëmbimin e territorit të Kosovës derisa sërish nuk rihapen dhe përfundojnë negociatat për Marrëveshjen e Dejtonit mbi Bosnjën» dhe se “Perëndimi nuk mund të lejoj një marrëveshje të pamenduar mirë për Kosovën për të destabilizuar vendin që i pa luftërat më të përgjakshme». (2018) Tim Judah, shpjegon në “The Economist” se: «Nëse Kosova dhe Serbia fillojnë bisedime serioze për ri-vizatimin e kufijve të tyre, ndikimi në komunitetet ballkanike, përveç atyre në pjesët e prekura të Kosovës dhe Serbisë, mund të jetë i thellë (2018)”. Pedi Eshdaun dhe ish-përfaqësuesit e lartë të BE, Carl Bildt dhe Christian Schwarz-Schilling, dërguan një letër të hapur duke e thirrur Federika Mogherinin të mos mbështes shkëmbimin e territoreve – “Nëse doni të shkoni përreth dhe të krijoni xhepa mono-etnike në Ballkan, atëherë me të vërtetë duhet të rivizatoni shumë kufij dhe në fund të përfundoni me shtete etnikisht të pastra (Radio Europa e Lirë, 2018)”. Carl Bildt paralajmëroi se: «Loja me kufinj dhe me ndarje në Ballkan ishte e rrezikshme në fillimin e viteve 1990 dhe mbetet e tillë». (Washington Post 20186)

Kompleksiteti i Maqedonisë

Ndryshimi i regjimit në Maqedoni ndodhi në vitin 2017 pas zgjedhjeve parlamentare në 2016, kur partia e atëhershme qeveritare konservatore VMRO-DPMNE e humbi shumicën e vendeve në Kuvend në llogari të Social Demokratëve, LSDM. Historia kryesore pas rezultatit të përmirësuar të LSDM-së që kontribuoi në formimin e një qeverie, koalicioni në vitin 2017 ishte marrja e votave të shqiptarëve etnik, suksesi i parë i rëndësishëm i një partie jo-shqiptare për të fituar një numër kaq të madh votash të shqiptarëve, nga pavarësia deri më sot. Për ta arritur këtë, LSDM-ja në platformën e vet zgjedhore e përfshiu dhe e përmirësoi axhendën kombëtare shqiptare në Maqedoni. Kryeministri Zoran Zaev në zgjedhjet më 2016 ofroi ridefinimin e marrëdhënieve ndër etnike në Maqedoni, të përcaktuara me Marrëveshjen Kornizë të Ohrit më 2001.

LSDM në zgjedhje e zhvilloi fushatën e quajtur «Plani për Jetë në Maqedoni». Premtimet e përgjithshme të Zaevit ishin paga më të larta, demokratizimi, punë të denjë dhe drejtësi për të gjithë. Megjithatë, LSDM kishte një fushatë të veçantë për tërheqjen e votuesve «shqiptarë», një premtim se do ta ndryshojë balancën e pushtetit dhe të drejtave të shqiptarëve etnik të kontraktuara në Ohër. Një numër i konsiderueshëm i shqiptarëve në Maqedoni besuan në këtë angazhim zgjedhor dhe LSDM-ja fitoi 38,162 vota shqiptare nga gjithsej 435,079. (Studimi i CRPM 2017) Këto

8.8% të numrit të përgjithshëm të votave ishin një faktor i rëndësishëm për fitimin e vendeve të deputetëve dhe më pas për formimin e Qeverisë së Re. Megjithatë, LSDM i luhati planet e partive të shqiptarëve etnik. Ata reagues me radikalizimin ose me licitime etnike. Licitimi etnik në shkencat politike analizohet si një term kur partitë etnike miratojnë strategji radikale që synojnë maksimizimin e mbështetjes të votuesve nga një grup etnik i caktuar për t'u përfaqësuar si luftëtarë të vërtetë për kauzën dhe për të dobësuar legjitimitetin, duke i delegitimuar rivalët politikë që e përfaqësojnë atë komunitet. (Gormley-Hinan, McGinty, 2008: 44)

Teoria për licitime etnike thekson se çon deri në një konkurrencë ekstreme, ofron më shumë opsione radikale për politikën publike që çojnë deri te rrezikimi nga shkatërrimi i vetë sistemit politik. Licitimi etnik ndodh kur politikanët garojnë për të marrë mbështetjen e një komuniteti të caktuar etnik dhe të parashtrajnë kërkesa në dobi të atij komuniteti në kurriz të të tjerëve. Ky është një proces kur në një komunitet etnik konkurrenca politike reduktohet në argumentimin se cila parti është mbrojtësi më i madh i interesave të komunitetit (Coquley, 2008). Pavarësisht nga politika apo rrethanat që çojnë në licitime etnike, negociatat etnike janë pothuajse të pamundura, sepse edhe elitat e moderuara etnike janë radikalizuar dhe diskursi publik i ndjek veprimet e tyre. Licitimi etnik në shoqëritë e ndara mund të ketë pasojë serioze politike dhe madje mund të çojë në konflikte dhe përfundimisht në luftë.

Siç theksojnë Ginter dhe Diamond: «Logjika zgjedhore e partive etnike është që të mobilizohet baza me deklarata të polarizuara, duke i theksuar mundësitë që komuniteti duhet t'i përdorë, me kërcënime ... ekskluziviteti etnik i mesazheve të tyre politike dhe efekti i tyre polarizues kanë efektin dezintegruës dhe ndarjen e shoqërisë»(2001: 23-4). Politikologë të tjerë të shquar politik si Samuel Huntington besojnë se partitë etnike janë të rrezikshme për demokratizimin e një vendi. Ai madje thekson se shumë vende e të ashtuquajturës «Bota e Tretë» nuk arritën të mbajnë demokracinë për shkak të ndikimit të fortë të partive etnike. (1991) Një nga ekspertët kryesorë për minoritetet dhe konfliktet, Ted Gur, shkon aq larg dhe thotë se pothuajse të gjitha rastet e luftës civile në vitet e fundit janë rezultat i marrjes së pushtetit nga ana e partive etnike dhe promovimin e agjendës së tyre ekskluzive politike.

Ku është licitimi etnik në kontekstin maqedonas? Pas zgjedhjeve në vitin 2016, BDI, Aleanca për shqiptarët dhe BESA negocuan për një axhendë të re politike në Tiranë, një platformë politike që synon të zgjerojë reformat e dakorduara në Ohër në vitin 2001. Ajo u publikua më 6 janar të vitit 2017, si e ashtuquajtura, «Platforma

e Tiranës», dhe kërkon realizimin e qëllimeve, «në mandatin e ardhshëm të qeverisë dhe / ose në çdo mandat të ardhshëm», të rritet fuqia e subjekteve politike shqiptare në vend. De facto ka për qëllim të ndryshojë Marrëveshjen Kornizë të Ohrit të vitit 2001 dhe ta ridefinojë Republikën e Maqedonisë si një federatë jo-territoriale.

Platforma, gjithashtu, parashikon promovimin e statusit të Shqiptarëve, ndër të tjera, përmes realizimit të së drejtës të «Zbatimit të drejtë të parimit multietnik në Kushtetutën e Maqedonisë, ku Shqiptarët duhet të konsiderohen si një popull-shtetformues ...» arritjen e barazisë së plotë gjuhësore, përdorimin e gjuhës shqipe në të gjitha nivelet e qeverisjes dhe garancinë se do të zbatohet si një e drejtë fundamentale dhe kushtetuese. Parashikohet që në Kushtetutë të definohet «Gjuha maqedonase dhe alfabeti i saj cirilik dhe gjuha shqipe dhe alfabeti i saj shqiptar si gjuhë zyrtare në Republikën e Maqedonisë», të hapet një debat gjithëpërfshirës mbi flamurin, himnin dhe stemën» me qëllim që simbolet shtetërore të pasqyrojnë multi-etnicitetin shoqëror dhe barazinë etnike. Në suaza të idesë për arritjen e barazisë ekonomike dhe mirëqenies sociale, Platforma kërkon krijimin e një Ministrie për Sistem Politik dhe Marrëdhënie Ndëretnike si një Institucion i autorizuar për njohjen e të drejtave të komuniteteve dhe për stimulimin e zhvillimit ekonomik dhe social në zonat jo mjaft të zhvilluara», si dhe «Arritjen e barazisë në forcat e sigurisë, në ushtri, prokurori dhe gjykatat», marrjen e masave afirmative për sigurimin e fondeve për institucionet kulturore shqiptare në nivel qendror dhe vendor», si dhe «arritjen e barazisë në të gjitha nivelet e pushtetit qendror dhe shërbimeve publike apo palëve të interesuara». Në politikën e jashtme kërkohet përfshirja e «Shqiptarëve në grupin e punës për negociatën e drejtpërdrejta me Greqinë dhe Bullgarinë», «Bashkëpunimi me Kosovën dhe Shqipërinë për menaxhimin e integruar të kufijve», si dhe «Hapjen e pikave të reja kufitare». Përveç kërkesave të tjera në një nivel më të ulët simbolik, insiston edhe në miratimin e «Rezolutës së Republikës së Maqedonisë që e dënon gjenocidin kundër popullit shqiptar në Maqedoni në periudhën e viteve 1912-1956».

Pas shpalljes së platformës, VMRO-DPMNE nuk arriti të formojë një qeveri koalicioni me BDI-në; kurse këtë e bëri LSDM-ja, duke e bashkuar edhe Aleancën për Shqiptarët. Nga ana tjetër, si pasojë e radikalizimit në kërkesat e partive politike shqiptare, u formua një lëvizje e re protestuese maqedonase, duke përfshirë edhe komunitetet tjera më të vogla etnike. Lëvizjen e udhëhoqën artistët si Boris Damovski, Bogdan Ilievski dhe Igor Durlovski, të bashkuar nën moton «Për një Maqedoni të Përbashkët», me qëllim të ndalimit të zbatimit të Platformës së Tiranës, me kërkesë drejtuar presidentit të Republikës që të mos ia jep mandatin LSDM-së dhe me këtë ta legalizon koalicionin. Protestat tre mujore kulmuan më

27 Prill kur grupet parlamentare të LSDM-së, BDI-së dhe Aleancës për shqiptarët në mënyrë të parregullt e zgjodhën Kryetarin e Kuvendit. Një grup protestues hyn në Parlament dhe e okupuan sallën kuvendore dhe pres-qendrën, kurse disa protestues i sulmuan deputetët nga LSDM-ja dhe Aleanca për Shqiptarët, duke përfshirë liderët e tyre Zaev dhe Sela. Maqedonia ishte shumë pranë skenarit më të keq me vrasje të njerëzve, madje edhe fillimin e një lufte civile. Përkundër përmirësimit të marrëdhënieve maqedonase-shqiptare ato mbeten të tensionuara rreth çështjeve specifike nga fusha e politikës, siç është Ligji për Gjuhët i cili duhet të rregullojë përdorimin e gjuhës shqipe në institucionet publike në të gjithë territorin e vendit, jo vetëm në zonat ku jetojnë në një numër të konsiderueshëm.

Drejtësia në shtete të ndryshme etnike

A duhet Kosova dhe Serbia, si dhe Maqedonia, të krijojnë territore etnike «të pastra» ose të përpiqen të arrijnë një gjendje të drejtë në lidhje me të drejtat e pakicave joshumicë? Në parim, një shtet i lloj-llojshëm etnik është më legjitim nëse të gjithë qytetarët e saj, dhe jo vetëm ata të shumicës, e konsiderojnë territorin e shtetit si atdheun e tyre, e pranojnë sistemin ligjor të shtetit dhe institucionet e tij, dhe i respektojnë simbolet e shtetit si simbole të veta. Këto janë të mirat që duhet të ndahen me të gjithë qytetarët e tjerë. Një shtet i tillë duhet të njohë të gjitha kulturat dhe të gjitha traditat e tyre si të vetat, nuk mund të identifikohet si «një komb i favorizuar, por duhet të marrë parasysh bashkësinë politike e të gjitha grupeve etnike që jetojnë në territorin e saj si konstitutiv.» (Kis 1996, 224-5) Bashkësia politike e një vendi multikulturor do të jetë e drejtë nëse është e formuar nga bashkësia e grupeve etnike që jetojnë së bashku. Simbolet e saj zyrtare, festat, të mirat kulturore që mësohen në shkollë dhe kujtesat historike do të thithin diçka nga tradita e të gjitha grupeve etnike që i përkasin, që të mund të gjithë ta shohin shtetin si të vetin: gjithashtu, secili të mund të sheh se shteti nuk është prona e tyre ekskluzive, por edhe e të gjitha grupeve të tjera etnike që e formojnë.

Nëse jemi të përkushtuar për trajtimin e të gjithë qytetarëve me kujdes dhe respekt të barabartë, duhet në një mënyrë të barabartë dhe të drejtë të merremi me preferencat kulturore të pakicave. Shteti ka për detyrë të mbështesë minoritetet, sepse ata janë në një situatë të padrejtë vis-à-vis (përballë) pjesëtarëve të kombit shumicë. Derisa individët nga kombi shumicë e pranojnë si të kryer që gjuha dhe kultura e tyre të paraqiten në domenin publik, pjesëtarët e kulturës së pakicës nuk mund ta bëjnë këtë. Nëse anëtarët individualë të kulturave të shumicës e

mësojnë gjuhën e tyre përmes sistemit arsimor dhe nëse ka anëtarë të pakicave që do të dëshironin të njëjtën gjë për gjuhën e tyre, atëherë, me qëllim që të ruhet barazia e qytetarëve të tij, shteti duhet të sigurojë edhe mësimin në gjuhën edhe të pakicës. Në përgjithësi, argumenti është se integrimi i përmirësuar i minoriteteve do të thotë marrëdhënie më të mira etnike dhe siguri më e mirë e brendshme e vendit. Virtytet e respektit dhe reciprocitetit janë virtytet themelore për çdo qeverisje liberale-demokratike. Ato janë të lidhur me parimet themelore liberale-demokratike», siç janë liritë e barabarta, respekti dhe kujdesi i barabartë dhe detyrimi përkatës për reciprocitet» (Bader 2007, 181)

Megjithatë, të gjithë jemi të vetëdijshëm se të drejtat e përcaktuara dhe të respektuara mirë të pakicave në fushën e kulturës nuk garantojnë harmoni të plotë etnike. Siç thotë Donald Horowitz: «Të drejtat [do] përfaqësojnë vetëm një pjesë të vogël të zgjidhjes së problemeve të konfliktit etnik» (1997, 1985). Konfliktet etnike ndodhin madje edhe nëse e drejta etno-kulturore është arritur në fushën e kulturës, sepse grupet etnike kërkojnë vetëvendosje dhe drejtësi edhe në sferën politike. Në të vërtetë, në shumicën e shteteve multietnike, minoritetet kërkojnë «ndonjë formë të autonomisë politike ose juridiksion territorial, me qëllim që të sigurohet zhvillimi i plotë dhe i lirë i kulturës së tyre dhe interesave më të mira të popullit të tyre ... me të vërtetë të gjithë shembujt e konflikteve etnike dhe shkëputjet ... i «përfshijnë pakicat kombëtare» (Kimlika 1996: 120). Më e sigurtë është se «Shumica e njerëzve do të duhet të gjejnë teknika politike që të mund të jetojnë së bashku brenda shteteve ekzistuese, përveç nëse nuk janë të gatshëm të kryejnë spastrime të atilla etnike që së shpejti bota të mbetet pa sapun». (Horowitz, 1997: 452) Ka marrëveshje të ndryshme politike lidhur me të drejtat e pakicave, por të gjithë po përpiqen që t'i përmirësojnë marrëdhëniet e drejta etnike në një shtet të ndryshëm.

Njerëzit, nëpërmjet institucioneve të tyre politike, kanë të drejtë të ushtrojnë kompetenca dhe të kontrollojnë burimet dhe migracionin në territorin e tyre, brenda drejtësisë. (Moore 2016: 223) Këtu duhet të theksohet, siç pohoi David Miller, diçka që pranohet pothuajse universalisht, se kur mendojmë në territor, zakonisht mendojmë për marrëdhënie trekëndëshe midis tre elementeve kryesore: (1) një copë toke, (2) një grup të njerëzëve që jetojnë në atë tokë, dhe (3) një grup i institucioneve politike që menaxhojnë me njerëzit brenda domenit gjeografik (territorit). (2012: 255). Me më shumë kombe sesa shtete në botë, është e qartë se kufijtë shtetërorë nuk mund dhe nuk korrespondojnë me natyrën e llojllojshme etnike të komuniteteve politike me të cilët qeverisin. Megjithatë, «Jetojmë në një botë të shteteve territoriale dhe i trajtojmë kufijtë territorial dhe të drejtat

territoriale si, pak a shumë, të pacënueshme, si diçka që thjeshtë vjen nga ide për një sistem të menaxhuar nga shteti» (Moore, 2016: 5) Sa më i drejtë është shteti i lloj-llojshëm, aq më legjitime është qeverisja e tij ndaj një territori të caktuar. Me arritjen e drejtësisë etno-kulturore përmes dhënies së të drejtave kulturore dhe aranzhimeve politike që i aftësojnë pakicat që ta strukturojnë jetën në lokalitete me praninë e tyre të fortë, siç dëshirojnë, kemi të drejtën legjitime për ta ruajtur shtetin si njësi funksionale themelore e shoqërisë moderne dhe për të ruajtur kufijtë ndërkombëtarë siç janë aktualisht.

Një shtet që është vërtet liberal dhe pranon një ndërtim kulturor të ndjeshëm të kombit, përkatësisht i promovon kulturat e pakicave dhe nuk ndjek programe diskriminuese për shpërngulje/ migracion, madje as nuk tërheq kufi administrativë në favor të shumicës etnike, është një shtet i drejtë që duhet të luftojë kundër ndryshimeve territoriale në bazë të parimeve etnike. Alternativat janë moralisht të pasigurta dhe praktikisht të rrezikshme, sepse ndryshimet territoriale dhe shkëputja mund të çojnë në mosmarrëveshje infinite rreth rregullsisë së kufijve dhe në lidhje me çështjen se kur grupet etnike kanë të drejtën e krijimit të shtetit të tyre. Ndarjet etnike dhe shkëputja do të ishte një rrezik që të rritet dhuna etnike globale dhe do të kërcënonte stabilitetin ndërkombëtar si dhe do të shkaktonte një domino-efekt me shumë kërkesa të reja për ndarje. «Ballkanizimi «i botës do të ishte një rezultat i paparashikueshëm. Ndarja territoriale është e vështirë të arrihet në tërësi, sepse gjithmonë do të ketë pakica etnike që do të neglizhohen dhe do të jenë në rrezik nga persekutimi.

Ndërtimi i kombeve të drejta etnike në Kosovë dhe Maqedoni kundruall ndryshimeve kufitare

Edhe Kosova edhe Maqedonia kanë zbatuar politika për përmirësimin e të drejtave të komuniteteve pakicë. Disa nga këto politika me të vërtetë e kanë përmirësuar jetën e anëtarëve të zakonshëm të grupeve minoritare. Politikat e tjera janë kontestuese (Ligji për Gjuhët në Maqedoni dhe Ligji për Asociacionin e Komuniteteve në Veriun e Kosovës) dhe politikisht të orientuara drejt ndarjeve. Strategjia e kundërt për arritjen e drejtësisë në shtetet multi-etnike është që të ndryshojnë kufijtë me vendet fqinje, në mënyrë që pas ndryshimeve të jenë sa më shumë mono-etnike. Rreziku është në atë që ndryshimet e tilla të kufijve në rajonin tonë ose më gjerë shkaktojnë më shumë kërkesa për autonomi politike dhe ndryshime të mëtejshme të kufijve të vështira për t'i kontrolluar dhe për t'i menaxhuar. Duke marrë parasysh historinë turbulente të ndryshimeve të kufijve

të Ballkanit, madje edhe kur janë bërë me pëlqimin e vendeve fqinje, ato janë një rrezik për sigurinë e rajonit. Sidoqoftë, vështirë arrihen shtete etnikisht «të pastra». Pa marrë parasysh se sa janë të vogla, disa pakica do të mbeten brenda kufijve të shteteve që i ndryshojnë kufijtë e tyre. Historia na mëson se presioni mbi këto pakica do të jetë i fuqishëm që të asimilohen ose thjeshtë të largohen.

Është veçanërisht e rrezikshme për rajonin nëse zbatohet shkëmbimi i propozuar i territoreve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Shkëmbimi i propozuar i territoreve e neglizhon faktin se shumica e serbëve të Kosovës, aktualisht jetojnë në enklava të vogla në jug të Kosovës. Duke patur parasysh se sipas marrëveshjes ata nuk do të jetojnë në Serbi, do të ndjehen të braktisur dhe me siguri do të largohen nga shtëpitë e tyre. Kishat dhe manastiret ortodokse serbe nuk do të mund të funksionojnë normalisht pa ndjekës fetarë (besimtarë). Pas shkëmbimit të territoreve, të gjithë shqiptarët e mbetur në Serbinë Jugore, gjithashtu, do të ndjehen të braktisur sepse nuk janë përfshirë në territorin e Kosovës. Përveç këtyre çështjeve dypalëshe, nëse arrihet dhe plotësohet marrëveshja, do të ketë potencial që të derdhet në të gjithë Ballkanin. Nëse Beogradi dhe Prishtina do të shkëmbejnë territore, kjo do t'u tregojë kroatëve dhe serbëve në Bosne se edhe ata mund të gjejnë një mënyrë për shkëputje dhe për bashkim me të afërmit e tyre etnikë në Kroaci dhe Serbi, duke e rrënuar Bosnën në këtë proces. Shqiptarët në Maqedoni dhe Mal të Zi do të kërkojnë të njëjtën gjë. Me siguri pas marrëveshjes, disa njerëz do të duhet ti braktisin shtëpitë e tyre familjare dhe vendlindjen. Shkurtimisht, do të ketë shkëmbim të popullatës, dhe jo vetëm të territoreve.

Kështu, marrëveshja do të hapë «Kutinë e Pandorës» së Ballkanit, me Bosne dhe Hercegovinën dhe Maqedoninë si pika potenciale nevralgjike etnike. Siç pohon Edward Joseph, "Shqiptarët në Maqedoni janë të lidhur ngushtë me të afërmit e tyre në Kosovë" dhe «Pavarësisht nga premtimet e liderëve shqiptarë në Maqedoni se do të mbeten në vend, logjika e shkëputjes do të kthehet, veçanërisht pasi do të bashkohet Kosova e Re, etnikisht homogjene me Shqipërinë». (2018) Ai thekson se procesi i demarkacionit territorial etnik nuk mund të mbahet, sepse «Tërheqja e njejtë atraktive do t'u lejojë njerëzve të palumtur të largohen nga një vend etnikisht i përzier në një vend homogjen, i intrigojnë edhe serbët në Bosne, shqiptarët në Maqedoni dhe pothuajse secilen pakicë me vetëdije në rajon dhe popullatë që është mjaft e koncentruar që të paraqes kërkesë për ndarje territoriale». Kroatët do t'i ndjekin serbët nga Bosna dhe Hercegovina, kurse boshnjakët pastaj do të luftojnë që ta parandalojnë copëtimin e shtetit të tyre të përbashkët. Për më tepër, siç thekson Juda, «Përtej kufirit, Serbia do t'i shtrëngojë nacionalistët boshnjakë në Sanxhak, të cilët ëndërrojnë që ta përfshijnë këtë rajon

në Bosne të Madhe». (2018) Në vetë Shqipërinë, grekët në pjesën jugore mund ta rishikojnë lojalitetin e tyre ndaj Tiranës.

Është i qartë rreziku se procesi nuk do të ndalet vetëm në Ballkan. Do të rritet potenciali për trazira mes pakicave etnike në Europë. Çështjet, siç është pavarësia e Katalonisë, statusi i hungarezëve në Rumani dhe Sllovaki, statusi i rusëve në Letoni dhe Estoni, dhe kështu me radhë, do të flakërojnë përsëri.

Duke marrur parasysh se rreziqet i tejkalojnë përfitimet nuk duhet të shkohet drejt zbatimit të marrëveshjes për shkëmbime territoriale. Siç shkruan Gordi, "Pothuajse me siguri ekzistojnë disa zgjidhje të tjera për kontestin midis Beogradit dhe Prishtinës, me elemente që deri tani nuk kanë hyrë në diskutim: sigurimi i mirëqenies së qytetarëve, përmirësimi i sigurisë dhe liria dhe ndërtimi i besimit ndërmjet dhe brenda komuniteteve. "(2018) Besimi dhe siguria, mirëqenia e të gjithë qytetarëve, pavarësisht përkatësisë etnike të tyre, është koncepti i drejtësisë etno-kulturore që është e nevojshme në Kosovë dhe në Maqedoni, me qëllim që këto dy vende të përparojnë dhe të stabilizohen. Këtu, çështje kryesore është përmirësimi i të drejtave të pakicave të serbëve në Kosovë dhe i shqiptarëve në Maqedoni. Çështjet e veçanta nga fusha e politikës, siç janë Ligji për Gjuhët në Maqedoni dhe Ligji për Asociacionet e Komuniteteve në Veriun e Kosovës, duhet të diskutohen me kujdes dhe të zbatohen me ndihmën e zyrtarëve të BE-së në kuadër të procesit të zgjerimit. Këto dhe çështje të tjera të mundshme kontestuese nuk duhet të trajtohen si lojëra zero, por si mundësi ngadhënjimi për të fituar besimin dhe bashkëpunimin në të ardhmen.

Përfundimi

E analizuar idenë për ndryshimin e kufijve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Maqedonia është një nga vendet që mund të ketë probleme të brendshme nëse arrihet një marrëveshje për shkëmbimin e territoreve midis Beogradit dhe Prishtinës. Më tej, kemi shpjeguar se marrëdhëniet midis maqedonasve dhe shqiptarëve etnik tashmë janë të brishta dhe se ato do të tej-nxehen me marrëveshjen në mes të presidentëve të Serbisë dhe Kosovës për ndryshimin e kufijve. Vendet e tjera në rajon dhe më gjerë i janë ekspozuar rrezikut nëse realizohet marrëveshja. Alternativa e modifikimeve territoriale që në teori çojnë në shtete etnike "të pastra" është koncepti i drejtësisë etno-kulturore në shoqëri të ndryshme arritur përmes sigurimit të së drejtave të minoriteteve, kohezionit ndëretnik dhe përfaqësimit politik të grupeve jo-shumicë. Edhe përkundër

rënive të caktuara, Maqedonia ka bërë shumë në këtë drejtim, Kosova e ndjek shembullin. Ekzistojnë çështje kontestuese në lidhje me të drejtat e pakicave në të dy vendet, por zgjidhja e tyre do të ishte shumë më e favorshme sesa të luhet me zjarr me ndryshimet e propozuara të kufijve.

Kjo marrëveshje potenciale është një propozim negativ dhe i rrezikshëm për rajonin. Ne avokojmë për qëndrueshmëri dhe përmirësimin e zbatimit dhe menaxhimit me të drejtat e pakicave. Edhe Maqedonia edhe Kosova duhet të vazhdojnë të zbatojnë politika të drejta etnike shtetërore për forcimin e të drejtave të pakicave. Duke pasur parasysh se motivi i presidentit Vuçiq për idenë e shkëmbimit territorial është fakti se BE nuk ka gjasa ta pranojë Serbinë si anëtare nëse nuk vendosë marrëdhënie të mira fqinjësore me Kosovën e pavarur, një zgjidhje për enigmën do të jetë që Serbisë t'i lejohet të ballafaqohet me këtë çështje në vetë fundin e procesit të negociatave. Derisa vazhdojnë negociatat dhe përparon normalizimi i marrëdhënieve midis Beogradit dhe Prishtinës, statusi i pakicës serbe në Kosovë duhet të mbështetet, me një vëmendje të veçantë për komunitatet serbe në Veri. Nëse me kalimin e kohës gjendja e serbëve në Kosovë do të jetë e pranuar mirë nga publiku në Serbi, mund të paraqitet mundësia që Beogradi të njohë pavarësinë e Prishtinës në kohën kur vendi do të aderojë në Bashkimin Europian. Nëse dhe kur Serbia do t'i bashkohet BE-së, duhet të vendoset një mekanizëm i posaçëm kontrollues me qëllim që të sigurohet që Beogradi të mos e bllokojë progresin e Kosovës në aderimin e saj në Bashkimin Europian.

Literatura:

- Bader Veit. 2007. *Secularism or Democracy? Associational Governance of Religious Diversity* Amsterdam: University of Amsterdam Press.
- Coakley, J. 'Ethnic Competition and the Logic of Party System Transformation' *European Journal of Political Research* 47 (2008): 766–793.
- Fouere, E., 'The EU's Enlargement Agenda – Credibility at Stake?', CEPS Policy Brief, No. 324, Centre for European Policy Studies (CEPS), Brussels, 31 October 2014.
- Gormley-Heenan, C & MacGinty, R (2008) 'Ethnic Outbidding and Party Modernization: Understanding the Democratic Unionist Party's Electoral Success in the Post-Agreement Environment.' *Ethnopolitics* Vol. 7, No. 1.
- Gunther, Richard and Diamond, Larry 2001. 'Types and Functions of Parties' in Larry Diamond and Richard Gunther (eds), *Political Parties and Democracy*. Baltimore and London: Johns Hopkins University Press4.

- Gurr, Ted Robert. 2000. *Peoples Versus States: Minorities at Risk in the New Century*, Washington, D.C.: United States Institute of Peace Press.
- Horowitz D., "Self-determination" in Ian Shapiro and Will Kymlicka (eds.) *Ethnicity and Group Rights*, New York and London: New York University Press, 1997.
- Horowitz D., *Ethnic Groups in Conflict* Berkeley: University of California Press, 1985.
- Huntington, Samuel P. 1991. *The Third Wave: Democratization in the Late Twentieth Century*. Norman OH: University of Oklahoma Press.
- Kis Janos. 1996. "Beyond the National State," *Social Research*. 63:1.
- Kymlicka Will, "Social Unity in a Liberal State," *Social Philosophy and Policy*, Winter 1996.
- Miller David, 'Territorial Rights: Concept and Justification', *Political Studies*, vol. 60, no. 1, 2012.
- Moore Margaret, *A Political Theory of Territory*, Oxford, Oxford UP, 2016.
- N1 TV, 11th August 2018, "Petritsch: Changes of Serbia-Kosovo border not a threat"
- New York Times September 13th, 2018, "An Offensive Plan for the Balkans That the U.S. Should Get Behind".
- Politico, 23rd August, 2018, "A Balkan border change the West should welcome".
- Edward Joseph, *Foreign Policy*, 4th September, 2018, "How to Restart War in the Balkans".
- Tim Judah, *The Economist*, February 19th 2018, "The difficulties of exchanging territory in the Balkans".
- Eric Gordy, *Foreign Affairs*, October 10, 2018, "Why Borders Are Not the Problem—or the Solution—for Serbia and Kosovo".
- The editorial board, *The Financial Times*, October 30th, 2018, "A Balkans plan that merits cautious backing: Proposed Kosovo-Serbia agreement has risks but could bring benefits".
- Puls 24, 6th January 2017, "Tiranska Platforma", available at: <http://puls24.mk/mk/vesti/tiranska-platforma-integralen-tekst>.
- Radio Free Europe, 29th August, 2018, "Ashdown, Bildt i Schwarz-Schilling: Trgovina teritorijom Kosova i Srbije ugrožava BiH".
- Smith, A. "The Ethnic Sources of Nationalism" in *Brown Ethnic Conflict and International Security*, Princeton: Princeton UP, 1993.
- Carl Bildt, *The Washington Post* August 9, 2018 "Further Balkanizing the Balkans is a recipe for disaster".

3.2. RE DILEMA E SIGURISË, NDRYSHIMI I KUFIVE PËR TË ARRITUR DERI TE SHTETET E “PASTRA” ETNIKE APO MENAXHIMI ME TË DREJTAT E PAKICAVE

Prof.Ass.Dr. Fatmir Çollakaj
Kolegji AAB Fakulteti Juridik- Prishtinë
fatmir.qollakaj@universitetiaab.com

Hyrje

Në tërë historinë e shkruar të shoqërisë njerëzore nocioni i sigurisë është i shpeshtë dhe në vazhdimësi i padefinuar sa duhet, krejt kjo për shkak të komplikueshmërisë dhe kontekstit relativ të faktorëve dhe rrethanave që interferojnë në sigurinë si fenomen.

Pa sigurinë e nevojshme, pa siguri të qëndrueshme nuk ka as liri e as garantim të të drejtave të njeriut. Në këtë kontekst mundemi lirisht të themi se siguria ka funksion shërbyes dhe qëndron në lidhshmëri të ngushtë me shtetin, meqenëse siguria është edhe kategori kushtetuese. Po ashtu është e njohur e përgjithshme se nuk ka askund siguri absolute e askund as liri absolute për qytetarët. Në këtë kontekst shteti si garantues i rregullimit të avansuar të jetës shoqërore përkujdeset për sigurinë e qytetarëve dhe sigurinë e jashtme, duke reaguar në mënyrë të organizuar ndaj atakimit të sovranitetit teritorial, agresioneve, apo formave të ndryshme të cenimit apo lëndimit të territorit shtetëror.

Shteti për derisa nuk u krijon kushte e siguri të qëndrueshme qytetarëve, nuk mund të flasim as për sigurinë dhe lirinë individuale e as për sigurinë dhe lirinë nacionale, kësaj sfidë për demokracitë e reja dhe shtetet e brishta është ruajtja e barazpeshës në mes të sigurisë dhe lirisë.

Që nga lindja e shteteve e deri më sot çështja e kufive ka qenë mullë shërr dhe objekt i kontesteve e kundërshtimeve të cilat kanë degjeneruar deri te luftërat. Edhe Herodoti në librin e tij “Istoriati sqaron arsyet e luftës dhe kërkesat e persianëve drejtuar mbretit Kir, për t’i zhvendosur ata në një tokë më të begatshme, luftën si mjet për realizimin e synimeve të tyre ekspansioniste për toka më të begatshme.

Historikisht është luftuar për kufi dhe luftërat se fundi në shumicën e rasteve kanë përfunduar me biseda, marrëveshje paqe, rezultat i të cilave ka qenë njohja ndërkombëtare dhe ndërshtetërore e vijës kufitare e cila shumë herë gjithandej në Europë e kontinente tjera ka ndarë popujt, ku një pëqindje e konsideruar etnike ka mbetur matanë kufirit shtetëror duke paraqitur sfiden e radhës për shtetin tjetër nga konteksti i garantimit të të drejtave dhe lirive të pakicave .

1. Dilema e Sigurisë

Koncepti dilemë paraqet paqartësi, mospërcaktim, pa vendosshmëri , hamendje në orientim etj.

Zakonisht dilemat paraqiten në të gjitha segmentet e jetës shoqërore por edhe për tej saj, edhe në botën e ideve , kryesisht si mungesë e koncensusit ,kunderthënshmërisë së situatës apo gjendjes, konfuzitetit struktural e funksional,ambiguidetit apo edhe kundërshtisë së interesave në mes të individëve, palëve, partnerëve, popujve, shteteve.

Dilema e Sigurisë është njëra ndër dilemat më të ndjeshme në segmentin e jetës shoqërore në të gjithë rrathët e sigurisë, duke filluar nga ajo individuale e deri tek ajo globale. Dilema e sigurisë si paradigmë është e determinuar nga një spektër faktorësh, edhe ekonomik, politik, strategjik,nacional, kulturor e religjioz.

Dilema e sigurisë, më shumë si fillim i konsumimit të saj dhe konvertimit në të kundërtën e saj, në pasiguri është prezente më shumë në të ashtuquajturat shtete të dobëta ku bëjnë pjesë në një masë shtetet tona të regjionit. “ Atyre u mungojnë institucionet efikase,monopoli i instrumenteve të dhunes dhe konsensusi mbi idenë e shtetit. Për rrjedhojë si shtete ato perballen me një sërë sfidash ndaj autoritetit të tyre prej aktorëve të brendshëm të fuqishëm”⁴⁹. Dilema e sqaruar e perkufizuar bukur nga autori Collins është mëse aktuale në shtetet tona të regjionit (Kosova Maqedonia, Bosna, Serbia, Shqipëria) ku këto shtete dhe disa tjera të ngjashme kanë humbur konsensusin mbi idenë e shtetit nga ndikimi dhe interferimi i aktorëve të brendshëm e të fuqishëm , bashkë me problemet etnike të pa zgjidhura si duhet ,interferimi i të cilave është edhe në fushën e sundimit të ligjit e natyrisht rrjedhimisht edhe në fushën e sigurisë. “Ndërthurja e dobësive shtetërore me kërcënimet e brendshme krijojnë një sfidë unike për sigurinë e vendeve të dobëta. Ajo është e dallueshme, sepse vjen më tepër nga kërcënime

⁴⁹ Alan Collins, Contemporary security studies.

të brendshme ndaj regjimit në pushtet sesa nga kërcënimet e jashtme kundër ekzistencës së shtetit –komb⁵⁰.

Nëse e analizojmë mirë këtë pasus shohim se autori e vë theksin të kundërthëniet e brendshme si fuqi gjeneruese e rrezikut dhe kërcënimin për sigurinë, kundërthëniet e brendshme si tregues i problemeve të pa zgjidhura sociale dhe atyre nacionale, meqë shtetet në përgjithësi janë multietnike.

2. Ndryshimi i kufive për të arritur deri te shtetet e “ pastra” etnike, sfidë e madhe për sigurinë regjionale e ndërkombëtare

Territori dhe vija kufitare ndërkombëtarisht e njohur janë dy elemente të ndjeshme dhe shumë të rëndësishme për sovranitetin shtetëror të një shteti . Kufijtë nënkuptojnë “ Vija të vërteta ose të imagjinuara,që hiqen në sipërfaqe të tokës ose të ujit, midis pikave të caktuara, e që e ndajnë territorin e një shteti nga shtetet e tjera”⁵¹. Ideja e ndryshimit të kufive ka qenë e kahershme dhe shumë shtete e pushtete kanë pasur pretendime të tilla në periudha të ndryshme kohore për të ndryshuar kufijtë në emër e interes të mbrojtjes së të drejtave të pakicave etnike, qasje kjo paternaliste e hegjemoniste e shtetit amë në raport me shtetin tjetër, kështu duke e atakuar sigurinë ndërshtetërore dhe atë regjionale.

Sa i përket territorit dhe për të kuptuar rëndësinë e tij për shtetin dhe qytetarët mund të shërbehemi me pikëpamjen e autorit M.Abazoviç sipas të cilit: “Territori nuk është vetëm hapësirë dhe kufi i sovranitetit, apo nën përgjegjësinë e shtetit. Ai është ambient shoqëror-ekonomik që ushtron ndikim në histori dhe politikën e një vendi. Njëkohësisht ai ka qenë me rëndësi vendimtare për fatin dhe zhvillimin e popujve të ndryshëm. Në këtë drejtim ai ndikon jo vetëm si vend gjeografik dhe si formë (p.sh. ujdhesa), por edhe në marrëdhëniet politiko-gjeografike.”⁵².

Nga ky këndvështrim ndryshimet e territorit shihen edhe si më pak të qëlluara e të dobishme sepse autori i përmendur territorin e sheh më shumë se sa hapësirë gjeografike, gati si entitet ontologjik për qenësinë shtetërore dhe sigurinë nacionale të një shteti.

50 Po aty.

51 Haxhi Ferati , Gjeopolitika dhe gjeostrategjia, botim shtepia botuese Har,2013.

52 Mirsad Abazoviç, Siguria Nacionale, skripta, ligjerata të autorizuar, Prishtinë, 2006.

Koncepti për shtetet e pastra etnike ishte ide e koncept konservator e djathtist, nacionalist e hegjemonist i dëshmuar gjatë historisë si koncept jo demokratik e imponues me dhunë , pasojë e së cilës dhunë ishin miliona njerëz të vrarë gjatë luftërave të ndryshme.

Multi-etniciteti si koncept e model ka të bëjë shumë me lirinë dhe ngushtë është e lidhur me demokracinë dhe tregun e lirë si dhe avancimin e të drejtave të njeriut, ku, siguria në këtë kontekst ka rol të rëndësishëm ngase, pa siguri të mjaftueshme e të qëndrueshme nuk ka parakushte për respektimin dhe garantimin e të drejtave të njeriut dhe të drejtave të pakicave etnike.

3. Shtetet e “pastra” etnike alternativë apo perspektivë në raport me sigurinë regjionale dhe ndërkombëtare

Pikëpamja për shtetet e “pastra” etnike si zgjidhje afatgjate dhe si garancion i sigurisë së qëndrueshme regjionale e asaj ndërkombëtare është një pikëpamje e diskutueshme ndaj të cilës arsyeshëm ekziston një qasje ambivalente nga radha e teoricientëve, politikologëve e analistëve të profileve të ndryshme nga fusha politike dhe ajo e sigurisë.

Fillimishtë shteti i pastër etnik është një konstrukt ideor dhe një konstatim më shumë teorik se sa një model praktik i organizimit të jetës shoqërore në kuadër të një shteti si subjekt ndërkombëtarisht i njohur. Kur flasim për shtetet e pastra etnike realisht mund të flasim më shumë për një koncentrim të shumicës absolute të një etnie në atë shtet dhe një përqindje shumë të vogël të një etnie tjetër apo të disa etnive, ku prapë siguria dhe liritë e të drejtat të këtyre pakicave etnike janë sfidë për shtetin e caktuar. Siguria siç dihet gjithnjë e më shumë po merr përmasat e një problemi e sfidë regjionale e sidomos ndërkombëtare ,natyrisht kjo bëhet edhe më e qartë duke ditur faktin e tendencave integruese me një anë dhe internacionalizimin e faktorëve kërcënues të sigurisë në anën tjetër.

Nga këndvështrimi i ndërlidhur me atë që u tha më lart rezulton se shtetet e pastra etnike nuk mund të qëndrojnë politikisht e as në planin e sigurisë, së këndejmi ato nuk mund të jenë perspektivë e as alternativë, duke e ditur faktin se aleancat ekzistuese politike e ushtarake po sfidohen seriozisht nga kërcënimet tradicionale serioze të sigurisë, e kohën e fundit edhe nga iniciativat për ndryshim të kufive, si kërcënime jo të matshme e jo lehtë të vërejtshme ,kërcënime këto të reja e të rezultuara nga një koncept dhe filozofi e vjetër.

Autori Abazović lidhur me këto kërcënime konstaton si në vijim: “Kërcënimet të cilat bazohen në supozime, ndoshta edhe nuk paraqesin kërcënime të vërteta. Gjithashtu, mund të jetë shumë vështirë të dallohet ndryshimi mes kërcënimeve dhe sfidave të vërteta që janë karakteristike për skenën shumë kompetitive ndërkombëtare. Mirëpo, një vendim i gabuar mund të ketë pasoja serioze. Në qoftë se diçka klasifikohet si kërcënim, kur nuk është, mund të pasojë çrregullimi i jetës, derisa nga ana tjetër, nëse një problem nuk kualifikohet si kërcënim, ai mund të dobësojë mundësinë e ndërmarrjes së hapave të nevojshëm dhe përgatitjeve për çrregullimet e mundshme⁵³.”

4. Gjendja e Sigurisë në regjionin e Ballkanit Perëndimor dhe çështja e pakicave kombëtare

Ballkani Perëndimor është historikisht zonë e ngjarjeve të mëdha dhe turbulencave të shpeshta me interferime të intensitetit të lartë si në planin politik ashtu edhe në atë të sigurisë.

Trendet integruese socio ekonomike dhe politike në decenien e dytë të këtij shekulli dhe definimi i zonave të interesit të natyrës bipolare nga ana e fuqive të mëdha dhe shteteve me ndikim kanë ndikuar në tensionime të herë pas hershme në baza nacionale e nacionaliste frymë kjo e ndikuar dhe e nxitur pjesërisht nga partitë politike me orientim ideologjik djathtist e me pasoja për sigurinë.

Popullata shumicë vazhdimisht imponon vullnet politik ndaj popullatës pakicë dhe e cila, pra, e para mbanë përgjegjësinë për sigurinë shtetërore të qytetarëve, e rezultuar nga sovraniteti shtetëror. Siguria si shërbim i rëndësishëm obligativ i shtetit ndaj qytetarëve e ka gjenezën te koncepti i Hobsit mbi sovranitetin shtetëror. Siç dihet koncepti i Hobsit mbi legjimitetin e ndërtimit të shtetit mbështetet në “Kontraten e sovranit me individët, në bazë të së ciles i pari u garanton të dytëve siguri nga kanosjet e brendshme, në shkëmbim të bashkëpunimit dhe pranimit nga ana e tyre të faktit që sovrani/ shteti është arbitri legjitim i përdorimit të forcës⁵⁴.”

Këtë siguri të garantuar nga sovrani e paraqitur në kushtetutë, pushtetet, qeveritë nuk e realizojnë plotësisht si obligim të tyre ndaj qytetarëve e sidomos ndaj qytetarëve si pjesëtarë të pakicave etnike, karakteristike kjo e shteteve në regjionin e Ballkanit Perëndimor dhe sidomos shteteve të krijuara pas shpërberjes së Jugosllavisë. “

⁵³ Mirsad Abazović, Siguria Nacionale, skripta, ligjerata të autorizuara, Prishtinë, 2006.

⁵⁴ Alan Collins, Contemporary security studies.

Shpërbërja e kësaj krijese rezultoi me realitete të reja gjeopolitike, ndërroi harta gjeografike të kësaj gjeohapësire, lindën shtete të reja⁵⁵.

Pra siç e thotë autori i lartpërmendur H.Ferati, shtetet e reja të lindura nga ish-Jugosllavia e cila u shpërbë me dhunë të ashpër karakterizoheshin me pushtet dhe qeveri nacionaliste frymë denigruese kjo për qytetarët sidomos ata të pakicave etnike, ku menaxhimi i të drejtave të tyre nga ana e këtyre pushteteve ishte i ulët dhe në kundërshtim me konventa e dokumente tjera ndërkombëtare. Përfundimisht në disa shtete ku ishte prezenca e misioneve ndërkombëtare e cila ndihmonte që ky menaxhim i të drejtave të pakicave të ishte më cilësor.

4.1. Siguria regjionale, garantimi i saj, kërcënimet eventuale dhe çështja e kufive

Siguria tashmë është e njohur e përgjithshme se është kategori variabile dhe shumë lehtë e ndryshueshme, ku kalimi i saj në pasiguri është fare lehtë e mundshme. Këtë gjendje ku siguria mund të atakohet shumë lehtë e ka shkaktuar e ndikuar realiteti i ri shoqëror nacional e regjional dhe së fundmi edhe ai ndërkombëtar i influencuar nga proceset globale dhe trendet tjera përcjellëse komplekse me dozë të konsiderueshme të rrezikut.

Shoqërinë bashkëkohore e sidomos shoqëritë në transicion disa autor i quajnë edhe shoqëri të rrezikut si për shembull autorja H. Sofragjia. Aleanca Veriatlantike dhe UE bashkë me SHBA-në kanë pasur interes permanent dhe interesim koherent për garantimin në kontinuitet të sigurisë për këtë pjesë të Ballkanit, përkatësisht Ballkanin Perëndimor si zonë e rëndësishme gjeostrategjike por edhe si zonë e brishtë dhe me plot kundërtënie dhe me probleme të pa zgjidhura të etnive të caktuara, gjegjësisht mos realizimi i disa të drejtave fundamentale të pakicave në kuadër të rregullimit juridiko- kushtetues të disa shteteve paraqet rrezik permanent, ku pa medëshje në këtë grup të shteteve bëjnë pjesë: Maqedonia, Serbia, Bosna e Kosova.

Por, ndryshimet e reja bashkë me kompleksitetin e vet kontradiktor ku veçoheshin dukuritë si krimi i organizuar, terrorizmi në baza etnike e religjioze paraqisnin sfida të reja për sigurinë meqë tani armiqtë tradicional mungonin e vendin e tyre si kërcënues të modifikuar paraqiten edhe kunderthëniet e brendshme të këtyre shteteve.

⁵⁵ Haxhi Ferati , Gjeopolitika dhe gjeostrategjia, botim shtepia botuese Har, 2013.

Këto rrethana dhe këtë situatë të re të krijuar e paraqet qartë autori Abazoviq: “Në kushtet e reja pa rivalitetin bipolar, parametrat e sigurisë kanë ndryshuar, kështu që siguria e shteteve sovraane nuk paraqet më vetëm mbrojtje të territoreve nga kërcënimet e jashtme që do të vinin nga shtete tjera sovraane, por edhe kontrollim të kërcënimeve subnacionale dhe transnacionale të cilat vijnë nga aktorë të ndryshëm joshtetërorë.

Këto kërcënime, në të vërtetë nuk janë të “reja”, por me humbjen e armiqve tradicional, kanë fituar rëndësi. Mënyra se si qeveritë përballen me këto kërcënime do të pasqyrohet gjithsesi në rregullimin e ri të sigurisë⁵⁶.

Çështja e kufijve edhe pse temë shumë e “nxehtë” si duket u detajizua në kohën e fundit me iniciativat regjionale në kuadër të dialogut në mes të Kosovës dhe Serbisë, si korrigjim të kufive, tani e paraqitur si strategji e re e zgjidhjes së çështjeve të vjetra të pa zgjidhura, një model i ri i integritit të pakicave, apo integritim i tyre në shtetin tjetër me shumicën etnike të njejtë.

Koncepti i tillë u pa nga shumica e europianëve e sidomos nga Gjermania si diçka e rrezikshme dhe shumë e ndjeshme me domino efekt, gjersa amerikanët konformë konceptit të tyre tradicional pragmatist u dakorduan nëse palët dakordohen plotësisht për një zgjidhje të tillë.

Në këto përplasje konceptesh për zgjidhje politike, pa mëdyshje frika e qytetarëve të kësaj zone për destabilizim dhe atakimin e sigurisë është reale edhe pse garancionet për mos konfrontim të dhunshëm dhe luftë eventuale janë të qëndrueshme e të konfirmuara edhe nga amerikanët edhe nga rusët si një kompromis i heshtur i zgjidhjes së një problemi strategjik rajonal me interferime në tërë Ballkanin Perëndimor.

Ndikimi amerikan dhe ai rus në këtë dialog është më i madh se ai European për dy arsye , e para edhe Amerika e edhe Rusia janë shtete që kanë fuqinë si relacion, e dyta, sepse konsistenca në vendim marrje te Amerika dhe Rusia është më efektive se sa procesi i dakordimit koncesual te strukturat vendim marrëse të UE-së. Kur e përmendëm fuqinë si relacion e kemi parasyshë kontekstin e ri të fuqisë që e posedojnë disa shtete. “Fuqia si relacion, pra si marrdhënie, apo si aftësi e shtetit për të ushtruar influencën e tij në relacion me të tjerët⁵⁷.

⁵⁶ Mirsad Abazoviq, Siguria Nacionale, skripta, ligjerata të autorizuar, Prishtinë 2006.

⁵⁷ B.Reka,B.Bashota,Y.Sela,Mardhënjet nderkombetare, Shkup,2016.

Çështja e pakicave etnike në zgjidhjet eventuale me korigjim kufish jo vetëm në relacionin Kosovë-Serbi por edhe në rastet tjera eventuale do të ishte çështje shumë delikate ku me kujdes të shtuar palët ndërmjetësuese do të duhej t'i obligonin palët negociuese në dialog që të mos anashkalohen standardet ndërkombëtare dhe e drejta ndërkombëtare nga aspekti i garantimit dhe mbrojtjes së të drejtave të pakicave etnike, çështje kjo me interferime të mëdha në raportet ndërshtetërore të shteteve si palë në kontest gjegjësisht në dialog si dhe interferime në fushën e sigurisë edhe përtej formatit të dialogut.

5. Menaxhimi i pakicave etnike sfidë e demoratizimit të shteteve multietnike

Menaxhimi i pakicave në një shtet multietnik është sprovë e demokracisë dhe e konsolidimit institucional shtetëror të atij shteti. Vetëm shteti i konsoliduar e stabil ofron siguri të qëndrueshme për qytetarët dhe pakicat etnike. Siguria është nevojë imediate për qytetarin dhe obligim kushtetues e ndërkombëtar për shtetin që t'i ofroj shërbime cilësore qytetarëve në fushën e sigurisë dhe në segmentet e tjera të jetës shoqërore.

Respektimi i të drejtave të njeriut dhe nga ky aspekt edhe të drejtave të pakicave etnike në shtetin multietnik është njëra nga sfidat më serioze dhe obligimi imediat i shteteve kundruall obligimeve për to që dalin nga konventat ndërkombëtare dhe dokumentet tjera të rëndësishme nga ky kontekst. "Shumica e kërcënimeve kundër sigurisë nxjerrin në pah drejtpërdrejtë ose tërthorazi dimensionin e të drejtave të njeriut⁵⁸.

Referuar këtij pasuesi rezulton qartë obligimi i shteteve për garantimin e sigurisë për qytetarët si parakushti themelor i garantimit dhe mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të tyre.

Në lidhshëmeri të ngushtë me atë që u tha më lartë korrespondon pasusi në vijim nga këndvështrimi i relacionit të sigurisë dhe të drejtave të njeriut " Siguria njerëzore në esencë është përpjekje për ndërtimin e shoqërisë globale,ku siguria e individit është në qendër të prioriteteve ndërkombëtare, ku standardet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe sundimi i ligjit janë avancuar dhe janë ngritur në një rrjet koherent për mbrojtjen e individit⁵⁹.

⁵⁸ Kuptimi i të drejtave të njeriut, Qendra Europiane për të drejtat e njeriut, Universiteti i Prishtinës.

⁵⁹ Lloyd Axworthy, ish ministër i Kanadas.

Të drejtat e pakicave etnike po ashtu janë obligim kushtetues dhe ndërkombëtar i shtetit me shumicë etnike tjetër për t'i mbrojtur e avancuar ato të drejta sepse avancimi i mirëfilltë i tyre dhe garantimi i këtyre të drejtave në plan afatgjatë është indeksi real i gjendjes dhe orientimit demokratik apo jo demokratik i shtetit të caktuar.

Përfundim

Nga ajo që u tha më lartë mund të konkludojmë se siguria dhe liria, e të drejtat e njeriut janë në një relacion të ngushtë ndërveprimi, duke e shtuar edhe elementin tjetër shumë të rëndësishëm, sundimin e ligjit. Trendet bashkëkohore dhe tendencat zhvillimore si në ekonomi, politikë, teknologji, kulturë, opinion publik e segmente tjera në planin ndërkombëtar e global karakterizohen me tendencën e dominimit e primatit të dijes fuqi, dhe neo eksploatimit qëllim i kamufluar me trajta të universalizimit si kulturë globale apo teknicizimit dhe përdorimit të rezultateve të tij si mjete kërcënuese (terrorizmi bashkëkohor si e keqe e si frikë e përbashkët) apo nevojë imediate e popujve dhe shteteve të vogla të qenurit nën diktatin e fuqive të mëdha, apo pakicave etnike me etninë shumicë në një shtet të përbashkët si nevojë e domosdoshme e ekzistimit.

Sa i përket çështjes së kufijve dhe sigurisë për pakicat etnike dhe qytetarët në përgjithësi mund të themi se shtetet e pastra etnike janë pa perspektivë, shtetet multietnike janë domosdoshmëri kurse integrimet emancipuese e socializuese duke respektuar me përpikëri liritë dhe të drejtat e njeriut dhe të drejtat e pakicave synim afatgjatë dhe qëllime përfundimtare të demokracive të avancuara.

Të drejtat e njeriut duhet të implementohen në rend të parë në nivel kombëtar, por në praktikën e deri tanishme sidomos në shtetet multietnike që kanë lindur e formuar nga shpërberja e ish- shteteve socialiste pengesat në këtë drejtim janë shumë të mundshme qoftë nga mos qeverisja e mirë, korrupsioni, nepotizmi, interferimet në vendim marrje nga klanet e grupet e interesit, krimi i organizuar. Për këto shtete dhe të tjerat me qeverisje jo efikase ku sundimi i ligjit është i brishtë kërkohet monitorim ndërkombëtar i cili deri tani në praktikë nuk është treguar gjithë herë edhe aq efikas sepse korrupsioni dhe ndikimet tjera në disa raste kanë prekur edhe disa zyrtarë nërkombëtarë.

Krahas monitorimit ndërkombëtarë vetëdijesimi qytetarë i mirëfilltë me edukim intensiv dhe instruksione praktike do të ndihmojë dukshëm në efikasitetin e

shërbyesëve civil dhe cilësinë e shërbimeve të ofruara nga ata si një indikator i fuqishëm i kthimit të besimit të qytetarëve kah shteti i së drejtës dhe besimi i tyre i qëndrueshëm në demokracinë e avancuar ku të drejtat e njeriut, barazia etnike dhe siguria e qëndrueshme për të gjithë qytetarët është imperativ kategorik i shtetit bashkëkohor e demokratik.

Literatura:

- » Alan Collins, Contemporary security studies.
- » Abazović, Mirsad ,Siguria Nacionale, skripta, ligjërata të autorizuara, Prishtinë, 2006.
- » B.Reka,B.Bashota,Y.Sela,Marrëdhëniet Ndërkombëtare, Shkup,2016.
- » Haxhi Ferati , Gjeopolitika dhe Gjeostrategjia, botim Shtëpia Botuese Har,2013.
- » Kuptimi i të drejtave të njeriut, Qendra Europiane për të Drejtat e Njeriut, Universiteti i Prishtinës.

